

Vendimi ACER për ndryshimin e HAR: Shtojca I

**Rregullat e harmonizuara të alokimit të të
Drejtave Afatgjate të Transmisionit**

në përputhje me Nenin 51 të Rregullores së Komisionit (BE)
2016/1719 të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një Udhëzuesi mbi
Alokimin e Kapaciteteve të Ardhshme

29 nëntor 2021

Tabela e përmbajtjes

Meqenëse	5
TITULLI 1 Dispozitat e Përgjithshme	7
<i>Neni 1</i> Lënda dhe fushëveprimi	7
<i>Neni 2</i> Përkufizime dhe interpretime	7
<i>Neni 3</i> Platforma e Vetme e Alokimit.....	10
<i>Neni 4</i> Specifikimet Rajonale	10
<i>Neni 5</i> Data e hyrjes në fuqi dhe aplikimi.....	11
TITULLI 2 Kërkesat dhe procesi i pjesëmarrjes në Ankand dhe Transferim.....	11
<i>Neni 6</i> Dispozitat e Përgjithshme.....	11
<i>Neni 7</i> Lidhja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes.....	12
<i>Neni 8</i> Forma dhe përmbajtja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes.....	12
<i>Neni 9</i> Paraqitja e informacionit	13
<i>Neni 10</i> Garancitë.....	14
<i>Neni 11</i> Deklaratë për pjesëmarrje vetëm në transferim.....	14
<i>Neni 12</i> Llogaria e dedikuar e biznesit.....	15
<i>Neni 13</i> Pranimi i rregullave të sistemit të informacionit	15
<i>Neni 14</i> Shpenzimet që lidhen me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes	15
<i>Neni 15</i> Refuzimi i aplikimit.....	15
<i>Neni 16</i> Qasja në Mjetin e Ankandit.....	16
<i>Neni 17</i> Përfundimi i kushteve financiare shtesë	16
<i>Neni 18</i> Kërkesat rregullative dhe ligjore	16
TITULLI 3 Kolateralet.....	17
<i>Neni 19</i> Dispozitat e Përgjithshme.....	17
<i>Neni 20</i> Forma e depozitimit të parave	17
<i>Neni 21</i> Forma e Garancisë Bankare.....	18
<i>Neni 22</i> Vlefshmëria dhe ripërtëritja e garancisë bankare	19
<i>Neni 23</i> Limiti i kreditit	19
<i>Neni 24</i> Modifikimi i kolateralit	20
<i>Neni 25</i> Incidenti i kolateralit	21
<i>Neni 26</i> Thirrjet në kolateral	21
TITULLI 4 Ankandet.....	21
<i>Neni 27</i> Dispozitat e përgjithshme për Ankande	21
<i>Neni 28</i> Afati kohor i alokimit të kapaciteteve dhe forma e produktit.....	22
<i>Neni 29</i> Specifikimet e Ankandit	22

<i>Neni 30</i>	Periudha e reduktuar e kapacitetit të ofruar	23
<i>Neni 31</i>	Dorëzimi i ofertave.....	24
<i>Neni 32</i>	Regjistrimi i ofertës	25
<i>Neni 33</i>	Oferta e paracaktuar	25
<i>Neni 34</i>	Verifikimi i limitit të kreditit.....	26
<i>Neni 35</i>	Përcaktimi i rezultateve të ankandit	27
<i>Neni 36</i>	Komunikimi i rezultateve të përkohshme të Ankandit.....	28
<i>Neni 37</i>	Kontestimi i rezultateve të Ankandit.....	29
TITULLI 5 Kthimi i drejtave afatgjate të Transmisionit		30
<i>Neni 38</i>	Dispozitat e Përgjithshme.....	30
<i>Neni 39</i>	Procesi i kthimit.....	30
<i>Neni 40</i>	Kompensimi i mbajtësve të së Drejtës Afatgjate të Transmisionit	31
TITULLI 6 Transferimi i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit		32
<i>Neni 41</i>	Dispozitat e Përgjithshme.....	32
<i>Neni 42</i>	Procesi i transferimit	32
<i>Neni 43</i>	Pasojat juridike të transferimit.....	33
<i>Neni 44</i>	Tabela e njoftimeve	33
TITULLI 7 Shfrytëzimi dhe kompensimi i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit		34
<i>Neni 45</i>	Parimet e Përgjithshme.....	34
<i>Neni 46</i>	Nominimi i të Drejtave Fizike të Transmisionit.....	34
<i>Neni 47</i>	Dokumenti i të drejtave	35
<i>Neni 48</i>	Kompensimi i mbajtësve të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit për të Drejtat e panominuara Fizike dhe Financiare të Transmisionit	36
TITULLI 8 Procedurat alternative/rezervë.....		37
<i>Neni 49</i>	Dispozitat e Përgjithshme.....	37
<i>Neni 50</i>	Procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave	38
<i>Neni 51</i>	Procedurat rezervë për Ankand	38
<i>Neni 52</i>	Anulimi i Ankandit.....	39
<i>Neni 53</i>	Procedura rezervë e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit.....	39
<i>Neni 54</i>	Procedura rezervë për transferimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit	40
<i>Neni 55</i>	Procedurat rezervë për njoftimin e personit të kualifikuar	40
TITULLI 9 Shkurtimi		40
<i>Neni 56</i>	Ngjarjet nxitëse dhe pasojat e shkurtimit/kufizimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit.....	40
<i>Neni 57</i>	Procesi dhe njoftimi për shkurtimin	41
<i>Neni 58</i>	Afati i qëndrueshmërisë së një dite përpara.....	42

<i>Neni 59</i>	Kompensimi për shkurtimet për të siguruar që operimi të mbetet brenda kufijve të sigurisë operacionale përpara afatit të qëndrueshmërisë së një dite përpara	42
<i>Neni 60</i>	Rimbursimi për shkurtimet për shkak të Forcës Madhore përpara afatit të qëndrueshmërisë së një dite përpara.....	44
<i>Neni 61</i>	Rimbursimi ose kompensimi për shkurtimet për shkak të Forcës Madhore ose situatës emergjente pas afatit të qëndrueshmërisë së një dite përpara.....	44
TITULLI 10 Faturimi dhe pagesa		44
<i>Neni 62</i>	Parimet e Përgjithshme.....	44
<i>Neni 63</i>	Llogaritja e shumave të detyruara	45
<i>Neni 64</i>	Rritja e shumës për të fituar shumën bruto për qëllime tatimi	45
<i>Neni 65</i>	Kushtet e faturimit dhe pagesës.....	46
<i>Neni 66</i>	Mosmarrëveshjet rreth pagesave	48
<i>Neni 67</i>	Pagesa e vonuar dhe incidenti i pagesës.....	49
TITULLI 11 Të ndryshme.....		50
<i>Neni 68</i>	Kohëzgjatja dhe ndryshimi i Rregullave të Alokimit.....	50
<i>Neni 69</i>	Përgjegjësia	50
<i>Neni 70</i>	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.....	51
<i>Neni 71</i>	Pezullimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes	53
<i>Neni 72</i>	Ndërprerja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes.....	54
<i>Neni 73</i>	Forca Madhore	55
<i>Neni 74</i>	Njoftimet.....	56
<i>Neni 75</i>	Konfidencialiteti	57
<i>Neni 76</i>	Caktimi dhe nënkontraktimi	58
<i>Neni 77</i>	Ligji rregullues	59
<i>Neni 78</i>	Gjuha	59
<i>Neni 79</i>	Prona intelektuale	59
<i>Neni 80</i>	Marrëdhënia e palëve	59
<i>Neni 81</i>	Asnjë e drejtë e palës së tretë	60
<i>Neni 82</i>	Heqja dorë.....	60
<i>Neni 83</i>	Marrëveshje e plotë	60
<i>Neni 84</i>	Mjetet juridike ekskluzive	60
<i>Neni 85</i>	Vlefshmëria e pjesshme.....	61

Meqenëse

- (1) Ky dokument përcakton rregullat e harmonizuara të alokimit për të Drejtat Afatgjate të Transmisionit afatgjatë në nivel të BE-së (në tekstin e mëtejme referuar si “HAR”) në përputhje me Nenin 51 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 për krijimin e një Udhëzuesi mbi Alokimin e Kapaciteteve të Ardhshme (në tekstin në vijim referuar si “Rregullorja FCA-së”), duke ndryshuar kështu HAR-in e miratuar me Vendimin e ACER-it Nr. 14/2019 të datës 29 tetor 2019.
- (2) “HAR” merr parasysh dispozitat mbi parimet e përgjithshme të Rregullores (BE) 2019/943 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 5 qershor 2019 mbi tregun e brendshëm të energjisë elektrike (në tekstin në vijim referuar si “Rregullorja (BE) 2019/943”).
- (3) “HAR” merr parasysh parimet e përgjithshme, qëllimet dhe metodologjitë e tjera të përcaktuara në Rregulloren e FCA-së. Qëllimi i Rregullores së FCA-së është koordinimi dhe harmonizimi i llogaritjes dhe alokimit të kapacitetit të ardhshme në tregjet afatgjate të kapaciteteve dhe përcakton kërkesat për OST-te për të bashkëpunuar në nivel pan-evropian; në nivelin e rajoneve të llogaritjes së kapaciteteve (në tekstin e mëtejme “CCR”) dhe në të gjithë kufijtë e zonave të tenderimit.
- (4) Në pajtim me Nenin 52(2) të Rregullores së FCA, “HAR” duhet të përmbajë të paktën përkufizimet dhe fushëveprimin e harmonizuara të aplikimeve, përshkrimin e procesit/procedurës së alokimit për të Drejtat Afatgjate të Transmisionit , duke përfshirë kërkesat minimale për pjesëmarrje, çështjet financiare, llojin e produkteve të ofruara në ankande eksplicite, rregullat e nominimit, rregullat e shkurtimit dhe kompensimit, rregullat për pjesëmarrësit e tregut në rast se transferojnë të drejtat e tyre afatgjate të Transmisionit , parimin e përdorimit ose të shitjes, rregullat për sa i përket forcës madhore dhe detyrimet. Përveç kësaj, “HAR” duhet të përmbajë një kornizë kontraktuale midis Platformës së Vetme të Alokimit dhe pjesëmarrësve të tregut.
- (5) Në pajtim me Nenin 52(3) të Rregullores së FCA-së, këto HAR gjithashtu përmbajnë kërkesat specifike të kufirit të zonës rajonale ose të ofertave për sa i përket, por pa u kufizuar në, përshkrimin të llojit të të drejtave të Transmisionit afatgjatë që ofrohen në secilën zonë ofertuese brenda kufirit të CCR-së, llojin e regjimit të kompensimit të të Drejtave të Transmisionit Afatgjate që do të zbatohet në secilin kufi të zonës ofertuese brenda CCR-së sipas alokimit në kornizën kohore “një ditë përpara”, zbatimin e zgjidhjeve alternative të koordinuara rajonale rezervë, rregullat rajonale të kompensimit që përcaktojnë regjimet e qëndrueshmërisë rajonale. Këto kërkesa specifike janë të detajuara në shtojcat përkatëse të HAR-së për rajonet përkatëse ose kufijtë e zonave ofertuese, të cilat duhet të miratohen nga autoritetet rregullatore përkatëse. Kërkesat specifike të kufirit rajonal ose zonës ofertuese nuk duhet të përfshijnë asnjë lloj specifike rajonale që devijon ndjeshëm nga HAR-ja apo edhe nga vetë Rregullorja e FCA-së.
- (6) Ky dokument përmban kështu dispozitat e HAR, të zbatueshme për kufijtë e zonave ofertuese në BE, përveç rasteve kur vendoset ndryshe nga autoritetet rregullatore përkatëse në pajtim me me Nenin 30 të Rregullores së FCA-së.
- (7) HAR-ja kryesisht kontribuon në arritjen e objektivave të Nenit 3 të Rregullores së FCA-së. Në veçanti, HAR shërben si objektiv për të nxitur tregtinë afatgjatë efektive ndër-zonale me mundësi mbrojtjeje afatgjatë ndërsektorale për pjesëmarrësit e tregut, pasi harmonizimi i të gjitha rregullave përkatëse do të lehtësojë krijimin e një niveli të luajtur Në të gjithë Evropën.

- (8) Objektivi i optimizimit të alokimit të kapacitetit afatgjatë ndërzonal arrihet me këtë HAR, veçanërisht sepse rregullat e harmonizuara që do të thjeshtojnë aktivitetet tregtare për produktet afatgjata përtej kufijve evropianë.
- (9) Gjithashtu HAR-ja kontribuon në sigurimin e qasjes jodiskriminuese në kapacitetin afatgjatë ndërzonal duke harmonizuar procesin e pjesëmarrjes në ankandet afatgjata (ose duke transferuar atë të drejtë). Për këtë qëllim, HAR detajon marrëveshjen e nevojshme për pjesëmarrje që duhet të nënshkruhet nga të gjitha palët e interesuara. Kjo marrëveshje mundëson gjithashtu qasje në mjetet e ankandit të Platformës së Vetme të Alokimit.
- (10) Për më tepër, HAR-ja siguron trajtim të drejtë dhe jodiskriminues për të gjitha palët e prekura, pasi përcakton rregullat që duhet të zbatohen nga të gjitha palët. Për më tepër, HAR-ja siguron transparencë për informacionin në lidhje me ankandet për të Drejtat Afatgjate të Transmisionit Afatgjatë.
- (11) Për më tepër, HAR parashikon një regjim që respekton nevojën për alokim të drejtë dhe të rregullt të kapaciteteve dhe formimin e rregullt të çmimeve, pasi një grup i harmonizuar i rregullave të alokimit është parashikuar me një algoritëm të vetëm të alokimit të kapaciteteve bazuar në prioritetin e renditjes së meritës në alokim.
- (12) Lidhur me objektivin e transparencës dhe besueshmërisë së informacionit mbi alokimin e kapaciteteve të ardhshme, HAR sqaron se cilat informata duhet të publikohen nga Platforma e Vetme e Alokimit në mënyrë të centralizuar dhe cilat duhet të konsiderohen si konfidenciale.
- (13) Gjithashtu, HAR kontribuon në funksionimin efikas afatgjatë dhe zhvillimin e sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike dhe të sektorit të energjisë elektrike në Union, duke optimizuar alokimin e kapaciteteve afatgjate, duke reflektuar mbingarkesë në të gjithë kufijtë e BE-së në mënyrë efektive.
- (14) Në përfundim, HAR kontribuon në objektivat e përgjithshme të Rregullores të FCA-së në të mirë të të gjithë pjesëmarrësve të tregut dhe të gjithë konsumatorëve fundorë të energjisë elektrike.
- (15) Neni 51 i Rregullores së FCA-së kërkon nga të gjitha OST-të të zhvillojnë HAR-in. OST-të që janë përgjegjëse për zhvillimin e propozimit dhe e kanë dorëzuar atë në ACER janë si më poshtë: APG - Austrian Power Grid AG, VÜEN-Vorarlberger Übertragungsnetz GmbH, Elia - Elia System Operator S.A., ESO – Electroenergien Sistemen Operator EAD, HOPS - Croatian Transmission System Operator Ltd, ČEPS - ČEPS, a.s., Energinet - Energinet, Elering - Elering AS, Fingrid - Fingrid OyJ, Kraftnät Åland Ab, RTE - Réseau de Transport d'Electricité, S.A., Amprion - Amprion GmbH, TransnetBW -TransnetBW GmbH, TenneT GER - TenneT TSO GmbH, 50Hertz - 50Hertz Transmission GmbH, IPTO - Independent Power Transmission Operator S.A., MAVIR ZRt. - MAVIR Magyar Villamosenergia-ipari Átviteli Rendszerirányító Zártkörűen Működő Részvénytársaság ZRt., EirGrid - EirGrid plc, Terna - Terna SpA, Augstsprieguma tīkls - AS Augstsprieguma tīkls, LITGRID - LITGRID AB, CREOS Luxembourg - CREOS Luxembourg S.A., TenneT TSO - TenneT TSO B.V., PSE - PSE S.A., REN - Rede Eléctrica Nacional, S.A., Tranelectrica - C.N. Tranelectrica S.A., SEPS - Slovenská elektrizačná prenosová sústava, a.s., ELES - ELES, d.o.o, REE - Red Eléctrica de España S.A.U, Svenska Kraftnät - Affärsverket Svenska Kraftnät, SONI System Operator for Northern Ireland Ltd.

TITULLI 1

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Lënda dhe fushëveprimi

1. Këto Rregulla të Alokimit, duke përfshirë shtojcat përkatëse rajonale dhe/ose kufitare, përmbajnë termat dhe kushtet për alokimin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë në kufijtë e Zonës Ofertuese në Bashkimin Evropian, duke nënkuptuar që Pjesëmarrësi i Regjistruar do të respektojë këto rregulla nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes. Në veçanti, Rregullat e Alokimit përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e Pjesëmarrësve të Regjistruar, si dhe kërkesat për pjesëmarrje në ankand, ato përshkruajnë procesin e Ankandit, duke përfshirë përcaktimin e Çmimit Margjinal si rezultat i Ankandit, kushtet për transferim dhe kthimin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë, për kompensimin e mbajtësve të këtyre të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë dhe proceset për shkurtimin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë dhe faturimit/pagesën.
2. Ankandet dhe transferimi i të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë i referohen vetëm kapacitetit në zona nderzonale dhe pjesëmarrësit e regjistruar nuk mund të kërkojnë të drejta të tjera në lidhje me të Drejtat Afatgjate të Transmisionit të ndara për to sesa të drejtat në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave të Alokimit.
3. Platforma e vetme e alokimit do të publikojë dhe përditësojë në uebfaqen e saj një listë të kufijve ku ndahen të Drejtat Afatgjate të Transmisionit, së bashku me informacionin mbi llojin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit dhe aplikueshmërinë e një kufiri për kompensimin e shkurtimit sipas Nenit 59, paragrafi 2 ose paragrafi 3.

Neni 2

Përkufizime dhe interpretime

1. Termat e kapitalizuar të përdorura në Rregullat e Alokimit do të kenë kuptimin që u është dhënë në Nenin 2 të Rregullores (BE) 2019/943, Nenin 2 i Rregullores (KE) 2013/543, Nenin 2 i Rregullores (BE) 2015/1222, Nenin 2 i Direktivës 2019/944, dhe në Rregulloren (BE) 2016/1719.
2. Përveç kësaj, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 1. 'Bashkëpunëtor' në lidhje me çdo person, do të thotë çdo person tjetër që kontrollon drejtpërdrejt ose tërthorazi, kontrollohet nga ose është nën kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të përbashkët me atë person, siç përcaktohet në Rregulloren e BE-së (KE) Nr. 139/2004 të datës 20 janar 2004 për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve;
 2. 'Mjeti i Ankandit' nënkupton sistemin e teknologjisë së informacionit të përdorur nga Platforma e Vetme e Alokimit për të kryer ankande dhe për të lehtësuar procedurat e tjera të përshkruara në Rregullat e Alokimit, siç janë transferimi ose kthimi i të drejtave të Transmisionit afatgjatë;
 3. 'Specifikimi i Ankandit' nënkupton nënkupton një listë të karakteristikave specifike të një Ankandi të veçantë, duke përfshirë natyrën e produkteve të ofruara dhe datat përkatëse;
 4. 'Garancia Bankare' nënkupton një letër kredie të pakushtëzuar dhe të parevokueshme, ose letër garancie të lëshuar nga një bankë;

5. 'Ofertë' nënkupton sasinë dhe çmimin e ofertës që aplikohet në ankand nga një Pjesëmarrës i Regjistruar;
6. 'Çmimi i ofertës' nënkupton çmimin që një pjesëmarrës i regjistruar është i gatshëm të paguajë për një (1) MW dhe orë të të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë;
7. 'Sasia e ofertës' nënkupton shumën e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë në MË të kërkuar nga një Pjesëmarrës i Regjistruar;
8. 'Periudha e ofertimit' nënkupton periudhën kohore brenda së cilës Pjesëmarrësit e Regjistruar që dëshirojnë të marrin pjesë në Ankand mund të dorëzojnë ofertat e tyre;
9. 'Llogaria e Biznesit' nënkupton një llogari të dedikuar të depozitave të hapur në institucionin financiar të zgjedhur nga platforma e alokimit në emër të platformës së alokimit ose në diskrecionin e platformës së alokimit të hapur nga pjesëmarrësi i regjistruar, por me platformën e alokimit si përfitues të depozitës së parave, të cilat mund të përdoren për pagesat nga pjesëmarrësi i regjistruar;
10. 'Limiti i kreditit' nënkupton shumën e kolateraleve që mund të përdoren për të mbuluar çdo paraqitje të ofertës në ankandet e mëpasshme dhe nuk përdoret për detyrimet e papaguara të pagesës;
11. 'Kodi EIC' nënkupton Skemën e Kodimit të Identifikimit të ENTSO-E për identifikimin e palëve në një tregti ndërkuftare;
12. 'Opsioni i së Drejtës Financiare të Transmisionit' nënkupton një të drejtë që i jepet • mbajtësit për të marrë një shpërblim financiar bazuar në rezultatet e shpërndarjes së ditës përpara në mes të dy zonave ofertuese gjatë një periudhe të caktuar kohe në një drejtim të caktuar;
13. 'Detyrimi i së Drejtës Financiare të Transmisionit' do të thotë e drejtë që i jep të drejtën mbajtësit të saj të marrë kompensim financiar ose që detyron mbajtësin e saj të sigurojë kompensim financiar bazuar në rezultatet e alokimit të ditës përpara ndërmjet dy zonave ofertuese gjatë një periudhe të caktuar kohore në një drejtim të caktuar;
14. 'Forca Madhore' nënkupton nënkupton çdo situatë të paparashikueshme përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale dhe / ose të OST-ve përkatëse, jo për shkak të një defekti të palës dhe / ose të OST-ve përkatëse, por janë defekte të pashmangshme dhe e pazgjydhshme nga pikepamja teknike, financiare ose ekonomike midis paleve. Ky fenomen ka ndodhur dhe është objektivisht e verifikueshme dhe që e bën të pamundur që Pala dhe / ose OST-të përkatëse të përmbushin, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, detyrimet e saj;
15. 'Rregullat e Sistemit të Informacionit' nënkuptojnë termat dhe kushtet për qasje dhe përdorimin e mekanizmave të ankandit nga pjesëmarrësit e regjistruar siç është publikuar në faqen e internetit të Platformës së Vetme të Alokimit;
16. 'Interkonektori' nënkupton interkonektorin siç përcaktohet në Nenin 2 të Rregullores (BE) 2019/943;
17. 'Çmimi Margjinal' nënkupton çmimin e përcaktuar në një ankand të caktuar që duhet të paguhet nga të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar për çdo MË dhe orë të blerë të së drejtës afatgjate të Transmisionit ;
18. 'Marrëveshja e Pjesëmarrjes' do të thotë marrëveshja me të cilën palët marrin përmbushjen e kushteve për ndarjen e kapaciteteve ndërzonale siç përcaktohet në Rregullat e Alokimit;
19. 'Pala/Palët' do të thotë Platforma e Vetme e Alokimit dhe/ose një Pjesëmarrës i Regjistruar i referuar individualisht si Pala ose kolektivisht si Palët;

20. 'E drejta Fizike e Transmisionit ' i jep të drejtën mbajtësit të saj të transferojë fizikisht një vëllim të caktuar të energjisë elektrike në një periudhë të caktuar kohe midis dy zonave të tenderit në një drejtim të caktuar;
 21. 'Periudha e Produktit' nënkupton kohën dhe datën në të cilën fillon afati për të përdorur e Drejta e Transmisionit Afatgjatë dhe kohën dhe datën në të cilën përfundon afati për të përdorur të Drejtën e Transmisionit Afatgjatë;
 22. 'Periudha e reduktimit' nënkupton një periudhë kohore, ditë dhe / ose orë të veçanta kalendarike, brenda periudhës së produktit në të cilën ofrohen kapacitete ndërsektoriale me një sasi të reduktuar të MË duke marrë parasysh një situatë të caktuar të rrjetit të parashikuar (p.sh. mirëmbajtjen e planifikuar, afatgjatë Ndërprerjet, problemet e parashikuara të balancimit);
 23. 'Pjesëmarrës i Regjistruar' nënkupton një pjesëmarrës tregu i cili ka lidhur marrëveshje pjesëmarrjeje me Platformën e Vetme të Alokimit;
 24. 'Dokument i të Drejtave' nënkupton dokumentin i cili përmban informacionin e shumës maksimale të të Drejtave të Transmisionit Fizik që mund të caktohen nga pjesëmarrësi i tregut për kufirin e Zonës Ofertuese për ditë, për orë dhe për drejtim ose shumën maksimale të të Drejtave të Transmisionit Financiar që do të merren parasysh për kompensim financiar, duke marrë parasysh vëllimin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë të fituara fillimisht, transferimet dhe kthimet e mëvonshme dhe çdo reduktim të mundshëm që ka ndodhur përpara lëshimit të Dokumentit të të Drejtave;
 25. 'Ditë pune' nënkupton ditët kalendarike nga e hëna deri të premten, me përjashtim të festave zyrtare siç specifikohet në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit;
 26. 'Orari i punës' nënkupton orët në ditët e punës të specifikuara në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes;
3. Në këto Rregulla të Alokimit, duke përfshirë shtojcat e saj, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti:
- (a) çdo referencë në fjalën kufiri i Zonës Ofertuese mund të mbulojë të gjithë interkonektorët në mënyrë kolektive ose, për qëllimin e aplikimit të kufirit për kompensimet me kuptimin e Nenit 59(2) ose 59(3) të Rregullave të Alokimit, vetëm një ose një nëngrup të interkonektorit(-ëve) në këtë kufi të Zonës Ofertuese;
 - (b) njëjësi tregon shumësin ose anasjelltas;
 - (c) referuar një gjinie duke përfshirë të gjitha gjinitë e tjera;
 - (d) tabela e përmbajtjes, titujt dhe shembujt janë futur vetëm për çështje lehtësie dhe nuk ndikojnë në interpretimin e Rregullave të Alokimit;
 - (e) fjala “duke përfshirë” dhe variacionet e saj duhet të interpretohen pa kufizim;
 - (f) çdo referencë në legjisllacion, rregullore, direktiva, urdhresa, instrumente, kode ose ndonjë akti tjetër do të përfshijë çdo modifikim, zgjerim ose rimiratim të tij në fuqi në atë kohë;
 - (g) çdo referencë në marrëveshje ose dokument tjetër, ose ndonjë akt ose instrument tjetër duhet të interpretohet si referencë ndaj asaj marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti, akti ose instrumenti tjetër të ndryshuar, plotësuar, zëvendësuar ose rinovuar herë pas here;

- (h) referimi në kohë është një referim në kohën CET/CEST përveç nëse specifikohet ndryshe;
- (i) në rastet kur Platforma e Vetme e Alokimit kërkohet të publikojë ndnjë informacion sipas Rregullave të Alokimit, ajo do ta bëjë këtë duke e vënë informacionin ose të dhënat në dispozicion në uebfaqen e saj dhe/ose nëpërmjet Mjetit të Ankandit; dhe
- (j) çdo referencë financiare e të Drejtave të Transmisionit duhet të mbulojë si opsionet e FTR-së ashtu edhe detyrimet e FTR-së.

Neni 3

Platforma e Vetme e Alokimit

1. Platforma e Vetme e Alokimit ndërmerr funksionet e alokimit në përputhje me Rregullat e Alokimit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të Bashkimit Evropian.
2. Për qëllimet e Rregullave të Alokimit, Platforma e Vetme e Alokimit do të jetë pala e cila nënshkruan Marrëveshjen e Pjesëmarrjes me Pjesëmarrësin e Regjistruar.
3. Për qëllimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes me Pjesëmarrësit e Regjistruar, Platforma e Vetme e Alokimit duhet të publikojë versionin e konsoliduar të Rregullave të Alokimit duke përfshirë shtojcat e saj kur ato të hyjnë në fuqi në përputhje me regjimet rregullatore kombëtare të zbatueshme. Në rast të konfliktit midis versionit të konsoliduar nga Platforma e Vetme e Alokimit dhe Rregullave të Alokimit, duke përfshirë shtojcat që kanë hyrë në fuqi në përputhje me regjimet rregullatore kombëtare në fuqi, kjo e fundit do të mbizotërojë.

Neni 4

Specifikimet Rajonale

1. Specifikimet rajonale ose kufitare mund të paraqiten për një ose më shumë kufij të Zonës së Ofertimit. Këto specifikime rajonale ose kufitare do të hyjnë në fuqi në përputhje me regjimin rregullator kombëtar të zbatueshëm dhe do t'i bashkëngjiten si shtojca Rregullave të Alokimit. Në rast se këto shtojca duhet të ndryshohen në bazë të vendimit të Autoriteteve Kombëtare Rregullative përkatëse, atëherë zbatohet Neni 68.
2. Nëse ka mospërputhje midis ndonjë prej dispozitave në pjesën kryesore të Rregullave të Alokimit dhe shtojcave specifike rajonale ose kufitare, prevalojnë dispozitat në shtojca.
3. OST-të mund të propozojnë specifikime të tilla rajonale ose të kufirit të zonës ofertuese në veçanti për, por pa kufizime në:
4. përshkrimin e llojit të të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë që do të aplikohen në çdo kufi të Zonës Ofertuese brenda rajonit të llogaritjes së kapacitetit;
5. lloji i regjimit të kompensimit të të Drejtave Afatgjatë të Transmisionit që do të zbatohet në çdo kufi të Zonës Ofertuese sipas alokimit në afatin kohor të ditës në vijim, duke përfshirë rregullat e TITULLIT 7 të Rregullave të Alokimit;
6. në implementimin e zgjidhjeve alternative të koordinuara rajonale të emergjencave ose si shtesë e rregullave të TITULLIT 8 të Rregullave të Alokimit; dhe

7. rregullat e kompensimit që përcaktojnë regjimet specifike rajonale ose kufitare të qëndrueshmërisë në përputhje me Nenin 55 të Rregullores së FCA-së.

Neni 5

Data e hyrjes në fuqi dhe aplikimi

1. Këto Rregulla të Alokimit hyjnë në fuqi në përputhje me regjimet rregullative kombëtare të zbatueshme dhe në datën e shpallur nga Platforma e Vetme e Alokimit.
2. Këto Rregulla të Alokimit zbatohen për Alokimin e Kapaciteteve për të Drejtat Afatgjate të Transmisionit atë me periudhën e shpërndarjes që do të përcaktohen nga Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqen e saj pas hyrjes në fuqi të këtyre Rregullave të Alokimit, duke kuptuar se periudha e dorëzimit në fjalë do të jetë nga 1 janari i vitit pasues pas miratimit të Rregullave të Alokimit në përputhje me Nenin 4 të Rregullores së FCA-së.
3. Përveç nëse përcaktohet shprehimisht ndryshe nga shtojca specifike rajonale ose kufitare ose kërkohet ndryshe nga ligji i zbatueshëm ligjor, këto Rregulla të Alokimit do të qeverisin të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me të Drejtat Afatgjate të Transmisionit të fituara para hyrjes në fuqi të këtyre Rregullave të Alokimit, por pas dates 1 Janar duhet të jete publikuar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni.

TITULLI 2

Kërkesat dhe procesi i pjesëmarrjes në Ankand dhe Transferim

Neni 6

Dispozitat e Përgjithshme

1. Pjesëmarrësit e tregut mund të fitojnë të drejtën e Transmisionit afatgjatë vetëm nga pjesëmarrja në ankande dhe/ose nëpërmjet transferimit.
2. Pjesëmarrja si në ankande ashtu edhe në transferime kërkon që pjesëmarrësi i tregut:
 - (a) të lidh marrëveshje pjesëmarrjeje të vlefshme dhe efektive në përputhje me Nenin 7 deri në Nenin 15; dhe
 - (b) të ketë qasje në Mjetin e Ankandit në përputhje me Nenin 16.
3. Pjesëmarrja në ankande kërkon që pjesëmarrësit e tregut, përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin paraprak, të plotësojnë edhe kushtet e mëposhtme:
 - (a) t'i plotësojnë kërkesat për sigurimin e kolateraleve siç specifikohet në TITULLIN 3; dhe
 - (b) t'i pranojnë kushtet financiare shtesë sipas nevojës në përputhje me Nenin 17.
4. Në çdo rast, pjesëmarrësit e tregut duhet të përmbushin detyrimet e përcaktuara në Kapitujt përkatës të këtyre Rregullave të Alokimit.

Neni 7

Lidhja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes

1. Të paktën nëntë (9) ditë pune para pjesëmarrjes së parë në ankand, çdo pjesëmarrës i tregut mund të aplikojë për të qenë palë në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes duke dorëzuar në Platformën e Vetme të Alokimit dy (2) kopje të nënshkruara të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në rast të nënshkrimeve të shkruara me dorë, siç janë publikuar në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit, së bashku me të gjitha informacionet dhe dokumentet e plotësuara të kërkuara sipas Neneve 0 deri në 16. Marrëveshja e Pjesëmarrjes nënshkruhet me nënshkrim(e) të shkruara me dorë ose nënshkrim(-e) elektronike të kualifikuara (QES). Platforma e Vetme e Alokimit vlerëson plotësinë e informacionit të dorëzuar në përputhje me nenet 0 deri në 13 brenda shtatë (7) ditëve të punës nga marrja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes të përfunduar dhe të nënshkruar.
2. Platforma e Vetme e Alokimit, para skadimit të afatit prej shtatë (7) ditëve të punës kërkon nga pjesëmarrësi i tregut të sigurojë informacione të mbetura që pjesëmarrësi i tregut nuk i paraqet me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes. Pas marrjes së informacionit të mbetur, Platforma e Vetme e Alokimit shqyrton informacionin brenda shtatë (7) ditëve të tjera pune dhe informon pjesëmarrësin e tregut nëse kërkohet ndonjë informacion i mëtejshëm.
3. Pasi Platforma e Vetme e Alokimit të ketë marrë të gjitha informacionet e nevojshme, ajo do t'i kthejë një kopje të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes të nënshkruar prej saj pjesëmarrësit të tregut pa vonesa të panevojshme. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes nga Platforma e Vetme e Alokimit nuk duhet të tregojë në vetvete pajtueshmërinë me ndonjë kusht tjetër të vendosur në Rregullat e Alokimit për pjesëmarrjen në Ankande. Marrëveshja e Pjesëmarrjes hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Platforma e Vetme e Alokimit.
4. Platforma e vetme e alokimit publikon listën e pjesëmarrësve të regjistruar që kualifikohen për të transferuar të drejtat afatgjate të Transmisionit .

Neni 8

Forma dhe përmbajtja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes

1. Forma e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes dhe kërkesat për plotësimin e saj do të publikohen nga Platforma e Vetme e Alokimit dhe mund të ndryshohen herë pas here nga Platforma e Vetme e Alokimit pa ndryshuar asnjë term dhe kusht të specifikuar në Rregullat e Alokimit, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këto Rregulla të Alokimit.
2. Si minimum, Marrëveshja e Pjesëmarrjes kërkon nga pjesëmarrësit e tregut të:
 - (a) ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm në përputhje me Nenet nga 0 deri në 13; dhe
 - (b) pranojnë të jenë të detyruar dhe në pajtueshmëri me Rregullat e Alokimit.
3. Asgjë në këto Rregulla Alokimi nuk do të parandalojnë Platformën e Vetme të Alokimit dhe Pjesëmarrësin e Regjistruar që të bien dakord në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes për rregulla shtesë, jashtë fushëveprimit të këtyre Rregullave të Alokimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar, pjesëmarrjen në alokimin eksplicit të ditës përpara apo ndonjë tjetër procesi të kthimit për alokimin e nënkuptuar të ditëve të ardhshme.
4. Në rast të vështirësive në interpretim, kontradiktës ose paqartësisë midis këtyre Rregullave të Alokimit dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, do të prevalojë teksti i Rregullave të Alokimit.

Neni 9

Paraqitja e informacionit

1. Pjesëmarrësi i tregut duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm me Marrëveshjen e tij të Pjesëmarrjes të plotësuar dhe të nënshkruar:
 - (a) emri dhe adresa e regjistruar e pjesëmarrësit të tregut duke përfshirë e-mailin e përgjithshëm dhe numrin e telefonit të pjesëmarrësit në treg për njoftimet në përputhje me Nenin 74.
 - (b) nëse pjesëmarrësi i tregut është person juridik, ekstrakti i regjistrimit të pjesëmarrësit në treg në regjistrin tregtar të autoritetit kompetent;
 - (c) detajet në lidhje me pronësinë përfituese siç përcaktohet në dispozitat ligjore përkatëse që transpozojnë Nenin 3(6) të Direktivës (BE) 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 20 maj 2015 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;
 - (d) detajet e kontaktit dhe emrat e personave të autorizuar për të përfaqësuar pjesëmarrësin në treg dhe funksionin e tyre;
 - (e) numrin e regjistrimit të TVSH-së së BE-së ose informacionin e ngjashëm të identifikimit tatimor ku TVSH-ja e BE-së nuk zbatohet;
 - (f) taksat dhe tatimet që duhet të merren parasysh për llogaritjen e faturave dhe kolateralit;
 - (g) Kodin unik i Identifikimit të Energjisë (EIC) i cili është regjistruar në Regjistrin e Centralizuar Evropian të Pjesëmarrësve në Tregun e Energjisë (CEREMP). Fakti se a është unik do të verifikohet në CEREMP;
 - (h) informacionin e llogarisë bankare të evidentuar nga një dokument identifikimi i llogarisë bankare për të gjitha pagesat ndaj aplikuesit që do të përdoren nga Platforma e Vetme e Alokimit;
 - (i) personi i kontaktit financiar për kolateralet, faturimin dhe pagesën, si dhe detajet e kontaktit të tyre (e-mail dhe numri i telefonit) për njoftimet kur kërkohet në Rregullat e Alokimit në përputhje me Nenin 74;
 - (j) personi i kontaktit komercial dhe detajet e kontaktit të tyre (e-mail dhe numri i telefonit) për njoftimet kur kërkohet në Rregullat e Alokimit në përputhje me Nenin 74; dhe
 - (k) personi i kontaktit operacional dhe detajet e kontaktit të tyre (e-mail dhe numri i telefonit) për njoftimet kur kërkohet në Rregullat e Alokimit në përputhje me Nenin 74.
 - (l) Kodi i Regjistrimit ACER (Kodi ACER) i caktuar nga Agjencia Evropiane për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) gjatë procesit të regjistrimit të pjesëmarrësit në treg me autoritetin e tij rregullator përkatës, dhe siç raportohet në CEREMP.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar siguron që të gjitha të dhënat dhe informacionet e tjera që i jep Platformës së Vetme të Alokimit në përputhje me Rregullat e Alokimit (përfshirë informacionin në Marrëveshjen e tij të Pjesëmarrjes) të jenë dhe të mbeten të sakta dhe të plota në të gjitha aspektet materiale dhe duhet të njoftojë menjëherë Platformën e Vetme të Alokimit në lidhje me çdo ndryshim.

3. Pjesëmarrësi i Regjistruar njofton Platformën e Vetme të Alokimit nëse ka ndonjë ndryshim në informacionin e paraqitur në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, së paku nëntë (9) ditë pune para hyrjes në fuqi të ndryshimit dhe, kur kjo nuk është e mundur, pa vonesë pasi pjesëmarrësi i regjistruar të vihet në dijeni të ndryshimit.
4. Platforma e Vetme e Alokimit do të konfirmojë regjistrimin e ndryshimit ose do t'i dërgojë pjesëmarrësit të regjistruar njoftimin e refuzimit lidhur me regjistrimin e ndryshimit, më së voni shtatë (7) ditë pune pas marrjes së njoftimit përkatës të ndryshimit. Njoftimi i konfirmimit ose refuzimit do të dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në webfaqen e saj. Nëse Platforma e Vetme e Alokimit refuzon të regjistrojë ndryshimin, arsyeja do të jepet në njoftimin e refuzimit.
5. Ndryshimi bëhet i vlefshëm në ditën e dorëzimit të konfirmimit tek pjesëmarrësi i regjistruar.
6. Nëse kërkohet informacion shtesë nga një pjesëmarrës i regjistruar si pasojë e ndryshimit në Rregullat e Alokimit, atëherë pjesëmarrësi i regjistruar do të paraqesë informacionin shtesë në Platformën e Vetme të Alokimit brenda dymbëdhjetë (12) ditëve të punës pas kërkesës për një dorëzim të tillë nga ana e Platformës së Vetme të Alokimit.

Neni 10

Garancitë

1. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, pjesëmarrësi i tregut garanton që:

- (a) nuk ka filluar ndonjë procedurë që kërkon gjykimin e paaftësisë paguese ose të falimentimit ose çfarëdo lehtësie tjetër sipas ndonjë ligji paaftësie paguese ose falimentimi ose ndonjë ligji tjetër të ngjashëm që ndikon në të drejtat e kreditorëve;
- (b) asnjë paaftësi paguese, falimentim ose procedurë tjetër e ngjashme ligjore që prek të drejtat e kreditorëve nuk ka filluar në lidhje me aplikantin;
- (c) nuk ka filluar procedurat e mbylljes ose likuidimit në lidhje me aplikantin; dhe
- (d) nuk ka detyrime të vonuara të pagesës ndaj ndonjë Platforme të Alokimit të tanishëm, të mëparshëm ose të ardhshëm.

Neni 11

Deklaratë për pjesëmarrje vetëm në transferim

Si pjesë e paraqitjes së informacionit në përputhje me Nenin 7 dhe Nenin 0, pjesëmarrësi i tregut duhet të deklarojë në Platformën e Vetme të Alokimit nëse ai synon të marrë pjesë vetëm në transferimin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë. Në një rast të tillë, ai nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ndonjë ankand.

Neni 12

Llogaria e dedikuar e biznesit

Si pjesë e paraqitjes së informacionit në përputhje me Nenin 7 dhe Nenin 0, llogaria e dedikuar e biznesit vihet në dispozicion të pjesëmarrësit të tregut me qëllim të depozitimit të kolateralit të parasë së gatshme dhe/ose me qëllim të realizimit të pagesave mbi bazën e Nenit 65(8).

Neni 13

Pranimi i rregullave të sistemit të informacionit

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, pjesëmarrësi i tregut pranon rregullat e aplikueshme të Sistemit të Informacionit, të ndryshuara herë pas here dhe të publikuara në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit.

Neni 14

Shpenzimet që lidhen me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes

Të gjitha aplikacionet për t'u bërë Pjesëmarrës i Regjistruar dhe çdo pjesëmarrje e mëpasshme në ankand dhe/ose njoftimi për transferimin ose kthimin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë do të jetë në koston, shpenzimet dhe rrezikun e Pjesëmarrësve të Regjistruar. Platforma e Vetme e Alokimit nuk do t'i përgjigjet asnjë personi për ndonjë kosto, dëm, apo shpenzim në lidhje me Pjesëmarrësin e Regjistruar që merr pjesë në Ankand dhe/ose transferimin ose kthimin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë përveç nëse nuk shprehet ndryshe në këto Rregulla të Alokimit.

Neni 15

Refuzimi i aplikimit

1. Platforma e Vetme e Alokimit mund të refuzojë të lidhë Marrëveshje të Pjesëmarrjes me një pjesëmarrës të tregut në rrethanat e mëposhtme:
 - (a) kur aplikanti nuk ka dorëzuar një Marrëveshje Pjesëmarrje të plotësuar dhe të nënshkruar në përputhje me Nenin 7, Nenin 0 dhe Nenin 0; ose
 - (b) Platforma e Vetme e Alokimit ka ndërprerë më herët një Marrëveshje të Pjesëmarrjes me aplikantin si rezultat i shkeljes së Marrëveshjes së Pjesëmarrjes nga Pjesëmarrësi i Regjistruar në përputhje me Nenin 72(3) dhe (4) dhe nëse rrethanat që çojnë në ndërprerje nuk kanë përfunduar të ekzistojnë ose Platforma e Vetme e Alokimit është përmbushur në mënyrë të arsyeshme se shkelja nuk do të ndodhë përsëri; ose
 - (c) nëse lidhja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes me aplikantin do të shkaktonte që Platforma e Vetme e Alokimit të shkelë ndonjë kusht të ndonjë kërkesë ligjore ose rregullative të detyrueshme; ose
 - (d) nëse ndonjë prej garancive të pjesëmarrësit të regjistruar sipas nenit 0 është gjetur se nuk është e vlefshme ose është e rremë; ose
 - (e) nëse aplikanti është nën sanksione ekonomike dhe tregtare, të cilat mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në platformën e vetme të alokimit.

Neni 16

Qasja në Mjetin e Ankandit

1. Platforma e Vetme e Alokimit do të lejojë qasjen në Mjetin e Ankandit pa pagesë nëse plotësohen kërkesat e mëposhtme:
 - (a) Pjesëmarrësi i Regjistruar ka nënshkruar dhe dorëzuar një formular të plotësuar të përfshirë në Rregullat e Sistemit të Informacionit duke identifikuar personin(-at) për të cilin(-ët) do të krijohet llogaria e përdoruesit në Mjetin e Ankandit, duke përfshirë çdo palë të tretë të autorizuar për të vepruar në emrin e Pjesëmarrësit të Regjistruar për qëllime të kthimit dhe transferimit të të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë në pajtim me Nenin 39 dhe Nenin 42; dhe
 - (b) Pjesëmarrësi i Regjistruar ka përmbushur kërkesat për vërtetimin e përcaktuar në Rregullat e Sistemit të Informacionit të publikuara nga Platforma e Vetme të Alokimit; kërkesat e tilla mund të përfshijnë teknologjinë për qëllime të vërtetimit.
2. Platforma e Vetme e Alokimit do të konfirmojë krijimin e llogarisë së përdoruesit ose mund t'i dërgojë një njoftim refuzimi Pjesëmarrësit të Regjistruar jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas marrjes së formularit përkatës të nënshkruar dhe të plotësuar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar. Njoftimi i i konfirmimit ose refuzimit do të dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqen e saj të internetit.
3. Platforma e Vetme e Alokimit duhet të dërgojë njoftimin e refuzimit të arsyetuar në mënyrë të duhur nëse nuk përmbushen kërkesat e listuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe nuk do të lejohet qasja në Mjetin e Ankandit.

Neni 17

Përfundimi i kushteve financiare shtesë

5. Platforma e Vetme e Alokimit mund të zhvillojë dhe publikojë kushte shtesë financiare standarde për t'u pranuar nga Pjesëmarrësit e Regjistruar. Këto kushte financiare shtesë mund të përfshijnë dispozita për të mundësuar kolateral të përbashkët për proceset afatgjate dhe të tjera të organizuara nga Platforma e Vetme e Alokimit në përputhje me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes, për sa kohë që këto kushte financiare shtesë janë në përputhje me këto Rregulla të Alokimit.

Neni 18

Kërkesat rregullative dhe ligjore

Është përgjegjësi e secilit pjesëmarrës të tregut që të sigurojë pajtueshmërinë me legjislacionin kombëtar dhe europian, duke përfshirë kërkesat e çdo autoriteti përkatës kompetent dhe të marrë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Ankand ose në transferimin dhe përdorimin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë.

TITULLI 3

Kolateralet

Neni 19

Dispozitat e Përgjithshme

1. Pjesëmarrësit e Regjistruar do të ofrojnë kolateralet për të siguruar pagesa në Platformën e Vetme të Alokimit që rrjedhin nga Ankandet e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë dhe, aty ku është e aplikueshme, pagesat potenciale të tjera që bien nën detyrimet financiare shitesë në përputhje me Nenin 17.
2. Do të pranohen vetëm format e mëposhtme të kolateralit:
 - (a) Garancia Bankare;
 - (b) Depozita me paratë gatshme në llogarinë e dedikuar për biznes.
3. Kolateralet mund të sigurohen në një nga format e referuara në paragrafin 2 të këtij neni ose në një kombinim të këtyre formave, me kusht që Platforma e Vetme e Alokimit të kualifikohet si përfitues në kolateralin e plotë.
4. Limiti i kreditit duhet të jetë gjithmonë më i madh ose i barabartë me zero.
5. Kolateralet duhet të sigurohen në monedhën Euro (€).

Neni 20

Forma e depozitimit të parave

1. Për kolateralet që sigurohen në formën e një depozite në para të gatshme në llogarinë e dedikuar për biznes zbatohen kushtet e mëposhtme:
 - (a) paratë duhet të depozitohen në një llogari të dedikuar të biznesit në një institucion financiar të përzgjedhur nga Platforma e Vetme e Alokimit;
 - (b) llogaria e dedikuar e biznesit hapet dhe përdoret në përputhje me afate të tjera financiare që do të lidhen ndërmjet Platformës së Vetme të Alokimit ose kur është e përshtatshme me institucionin financiar dhe Pjesëmarrësin e Regjistruar dhe përdoret vetëm për qëllime të Ankandit;
 - (c) deri në tërheqjen e lejuar nga dispozitat e mëposhtme të Nenit 26, depozita e parave të gatshme në llogarinë e dedikuar për biznes i takon Pjesëmarrësit të Regjistruar, nëse nuk përcaktohet ndryshe në kushtet financiare shitesë në përputhje me Nenin 17;
 - (d) tërheqjet nga llogaria e dedikuar e biznesit sipas Nenit 24 dhe Nenit 26 mund të bëhen vetëm sipas udhëzimit të Platformës së Vetme të Alokimit;
 - (e) Llogaria e dedikuar e biznesit mund të përdoret për shlyerje sipas Nenit 65 të kërkesës së Platformës së Vetme të Alokimit; dhe
 - (f) Interesi për shumën e depozituar në llogarinë e dedikuar për biznes do të rritet në dobi të Pjesëmarrësit të Regjistruar, pas zbritjes së tatimeve dhe pagesave bankare nëse ka.

Neni 21

Forma e Garancisë Bankare

1. Kolaterale të sigurohen në formën e Garancisë Bankare duhet të jenë në përputhje me specifikimet e mëposhtme:
 - (a) Garancia Bankare do të sigurohet në formën e shabllonit që është në dispozicion në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit dhe përditësohet herë pas here, ose në një formë që ndjek në thelb shabllonin;
 - (b) Garancia Bankare duhet të jetë e shkruar në gjuhën angleze;
 - (c) Garancia Bankare i mbulon të gjitha ankandet e organizuara nga Platforma e Vetme e Alokimit që i nënshtrohen këtyre Rregullave të Alokimit;
 - (d) Garancia Bankare do të lejojë tërheqjen e pjesshme dhe të shumëfishtë nga Platforma e Vetme e Alokimit, deri në shumën maksimale të garantuar;
 - (e) Garancia Bankare duhet të sigurojë pagesën sipas kërkesës së parë të Platformës së Vetme të Alokimit. Gjithashtu duhet të sigurojë më tej që, nëse Platforma e Vetme e Alokimit bën thirrje për Garancinë Bankare, banka do të paguajë automatikisht pa ndonjë kusht tjetër marrjen e një kërkesë me shkrim nga letra e regjistruar nga Platforma e Vetme e Alokimit.
 - (f) Garancia Bankare është e pakthyeshme, e pakushtëzuar dhe e pa transferueshme;
 - (g) Garancia bankare mund të përfshijë si alternativë nënshkrimet e bëra me dorë ose nënshkrimet elektronike të kualifikuara (QES) nga banka emetuese. Në rast se Garancia Bankare nënshkruhet me nënshkrim(-e) elektronik të kualifikuar (QES), të gjitha ndryshimet e mëposhtme nënshkruhen me nënshkrim(-e) elektronik të kualifikuar (QES);
 - (h) banka që emeton garancinë bankare do të vendoset në mënyrë të përhershme, duke përfshirë edhe një degë në një shtet anëtar të BE-së, Zonën Ekonomike Evropiane ose Zvicër;
 - (i) banka që lëshon garancinë bankare ose grupi financiar që i takon, duhet të ketë një vlerësim afatgjatë të kredisë jo më pak se BBB + Standard and Poor's Corporation, BBB+ by Fitch or Baa1 by Moody's Investors Service Inc. Nëse kërkesa për vlerësim nuk plotësohet nga vetë banka lëshuese, por nga grupi financiar të cilit i përket, banka lëshuese do t'i sigurojë Platformës së Alokimit një garanci prindërore ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga grupi financiar. Nëse banka lëshuese ose grupi financiar, që lëshon banka, nuk e ka normën e kërkuar afatgjatë të kreditit, pjesëmarrësi i regjistruar brenda pesë (5) ditëve të punës do të dorëzojë në Platformën e Vetme të Alokimit një garanci zëvendësuese të bankës nga një bankë në përputhje me kërkesën e një vlerësimi afatgjatë të kredisë ose do të zëvendësojë Garancionin Bankar me depozitë. Nëse ka rënie në industri për institucionet financiare, Platforma e Alokimit mund të hetojë se cilat janë standardet e reja dhe, nëse konsiderohet e nevojshme, të zvogëlohet vlerësimi i kërkuar për një periudhë të kufizuar kohore, duke informuar OST-të, të cilët pastaj do të informojnë autoritetet rregullatore përkatëse.
 - (j) banka që emeton Garancinë Bankare nuk do të jetë Filial i Pjesëmarrësit të Regjistruar për të cilin është lëshuar Garancia Bankare.
2. Garancia Bankare duhet të përmbajë si në vijim:

- (a) shumën maksimale të garantuar;
 - (b) identifikimin e Platformës së Vetme të Alokimit si përfitues, siç specifikohet në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit;
 - (c) llogarinë bankare të Platformës së Vetme të Alokimit, siç specifikohet në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit;
 - (d) adresën e bankës së Platformës së Vetme të Alokimit, siç specifikohet në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit;
 - (e) identifikimin e plotë të Pjesëmarrësit të Regjistruar, duke përfshirë emrin, adresën, regjistrin tregtar/të kompanisë;
 - (f) identifikimin e plotë të bankës siguroese; dhe
 - (g) kohën e vlefshmërisë.
3. Pjesëmarrësi i Regjistruar dorëzon garancinë bankare së paku katër (4) ditë pune para mbylljes së periudhës së ofertimit të ankandit, për të cilin do të përdoret si kolateral, ose përndryshe do të konsiderohet për ankandet e mëvonshme.
 4. Platforma e Alokimit pranon garancinë bankare të ofruar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar nëse garancia bankare është ofruar në përputhje me specifikimet e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni dhe, në rast se garancia bankare përfshin nënshkrimin(-et) me dorë, nëse kopja origjinale e garancisë bankare është marrë nga Platforma e Vetme e Alokimit.
 5. Platforma e Alokimit konfirmon pranimin e garancisë bankare ose i dërgon një njoftim refuzimi Pjesëmarrësit të Regjistruar më së voni katër (4) ditë pune pas pranimit të kopjes origjinale të garancisë bankare. Njoftimi i konfirmimit ose refuzimit dërgohet përmes mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqen e saj. Njoftimi i refuzimit duhet të përfshijë arsyetimin e refuzimit.

Neni 22

Vlefshmëria dhe ripërtëritja e garancisë bankare

1. Kolateralet në formë të Garancisë Bankare duhet të jenë të vlefshme për periudhat minimale si në vijim:
 - (a) për produkt(-et) me një kohëzgjatje prej më shumë se një muaj, deri në të paktën tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të çdo muaji kalendarik të ardhshëm brenda Periudhës së Produkteve;
 - (b) për produkt(-et) me kohëzgjatje prej një muaji, deri në të paktën tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të Periudhës së Produkteve; dhe
 - (c) për produkt(-et) me një kohëzgjatje më të shkurtër se një muaj, deri në të paktën gjashtëdhjetë (60) ditë pas përfundimit të Periudhës së Produkteve.

Pjesëmarrësi i Regjistruar do të zëvendësojë ose ripërtërijë kolateralet në formë të një garancie bankare për të plotësuar kërkesat e paragrafit 1 e këtij neni të paktën katër (4) Ditë Pune para skadimit të vlefshmërisë së kolateralit.

Neni 23

Limiti i kreditit

1. Platforma e Vetme e Alokimit llogaritë dhe përditëson vazhdimisht Limitin e Kreditit të secilit Pjesëmarrës të Regjistruar në lidhje me çdo ankand të mëpasshëm. . Limiti i kreditit duhet të

Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

jetë i barabartë me shumën e kolateraleve të vendosura, minus detyrimet e pagesave të papaguara. Në rastin e garancisë bankare, kjo garanci bankare do të merret parasysh vetëm nëse plotësohen kërkesat e Nenit 22 në lidhje me vlefshmërinë e saj për ankandin përkatës. Platforma e Vetme e Alokimit do ta vë këtë informacion në disponim të secilit Pjesëmarrës të Regjistruar individualisht përmes Mjetit të Ankandit.

2. Detyrimet e pagesave të papaguara llogariten sipas Nenit 63, duke iu nënshtruar rregullave shtesë në paragrafin 3 dhe 5 të këtij neni dhe në Nenin 34.
3. Me qëllim të llogaritjes së limitit të kreditit, detyrimet e pagesave të papaguara rriten për të përfshirë taksat dhe tatimet në fuqi, sipas Nenit 64.
4. Periudhat e reduktimit merren në konsideratë për llogaritjen e Kufirit të Kredisë siç përcaktohet në Nenin 63.
5. Detyrimet maksimale të pagesës për një Pjesëmarrës të Regjistruar që rezultojnë nga ofertat e tij të regjistruara në mbylljen e periudhës së ofertimit, të llogaritur sipas Nenit 34, do të konsiderohen përkohësisht si detyrime të papaguara. Nga publikimi i rezultateve të ankandit të përkohshëm deri në momentin kur rezultatet e Ankandit bëhen pjese e formës së prerë, shumat e duhur e njoftuar sipas Nenit 36 paragrafi 3(b) dhe (c) do të konsiderohen përkohësisht si detyrime të papaguara për llogaritjen e limitit të kreditit për secilin Ankand. Limiti i kreditit rishikohet në bazë të të Drejtave Afatgjate aktuale të alokuara të Transmisionit kur rezultatet e ankandit të përkohshëm publikohen siç përkohësisht në TITULLIN 4.

Neni 24

Modifikimi i kolateraleve

1. Pjesëmarrësi i Regjistruar mund të kërkojë me shkrim rritjen e kolateraleve në formë të Garancisë Bankare, zvogëlimin e kolateralit në formë të Garancisë Bankare dhe/ose depozitimin e parave ose ndryshimin e formës së kolateralit në çdo kohë në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.
2. Zvogëlimi i kolateraleve të një Pjesëmarrësi të Regjistruar do të lejohet vetëm nëse Limiti i Kreditit pas zbatimit të zvogëlimit të kërkuar të kolateraleve do të ishte më i madh ose i barabartë me zero.
3. Platforma e Vetme e Alokimit do të pranojë modifikimin e kolateraleve nëse kërkesa për modifikim të kolateraleve është në përputhje me kushtin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni në rast të uljes ose me kushtet e përcaktuara në nenin 21 dhe nenin 22 Në rast të rritjes së kolateralit në formën e një Garancie Bankare dhe në rast të një ndryshimi në formën e kolateraleve nga paraja në depozitë në Garancinë Bankare.
4. Modifikimi i kolateraleve bëhet i vlefshëm dhe efektiv vetëm kur Platforma e Vetme e Alokimit ka bërë modifikimin e kërkuar të kolateralit të Pjesëmarrësit të Regjistruar brenda Mjetit të Ankandit.
5. Platforma e Vetme e Alokimit do të vlerësojë kërkesën për modifikimin e kolateraleve dhe do të konfirmojë pranimin ose t'i dërgojë një njoftim të refuzimit pjesëmarrësit të regjistruar, më së voni katër (4) ditë pune pas marrjes së kërkesës. Njoftimi i konfirmimit ose refuzimit do të dërgohet me email për personat e kontaktit tregtar dhe operacional të përcaktuar nga pjesëmarrësi i regjistruar në përputhje me nenin 9. Njoftimi i refuzimit përfshin arsyetimin për refuzim.

Neni 25

Incidenti i kolateralit

1. Incidenti i kolateralit ndodh në rastet e mëposhtme:
 - (a) kolateralet janë të pamjaftueshme për të siguruar shumën e duhur për të Drejtat Afatgjate të Transmisionit të mbajtura nga një Pjesëmarrës i Regjistruar në datën e ardhshme të pagesës siç përcaktohet në Nenin 65, duke marrë parasysh shumën dhe vlefshmërinë e kolateralit; ose
 - (b) kolateralet nuk rinovohen në përputhje me nenin 22 paragrafi 2; ose
 - (c) kolateralet nuk janë rikthyer pas një incidenti pagese në përputhje me Nenin 26 ose është siguruar kolaterali i ri që nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në Nenin 19 (3), Nenin 20 dhe Nenin 21
2. Platforma e Alokimit njofton Pjesëmarrësit e Regjistruar me anë të postës elektronike për incidentin e kolateraleve. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të rrisë kolateralin e tij brenda dy (2) Ditëve të Punës nga dërgimi i njoftimit nëse kjo është bërë gjatë orarit të punës ose dy (2) Ditëve të Punës duke filluar nga Dita e ardhshme e Punës nëse dërgohet pas orarit të punës. Nëse kolateralet e ofruara nga Pjesëmarrësi i Regjistruar mbeten të pamjaftueshme pas kësaj periudhe, Platforma e Alokimit mund të pezullojë ose përfundojë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në përputhje me Nenin 71 dhe Nenin 72.

Neni 26

Thirrjet në kolaterale

1. Platforma e Vetme e Alokimit ka të drejtë të kërkojë kolaterale të një Pjesëmarrësi të Regjistruar në rast të ndonjë incidenti të pagesës së regjistruar në përputhje me Nenin 67.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar rikthen kolateralin e tij pas një incidentit të pagesës ose incidentit të kolateraleve duke respektuar kushtet e përcaktuara në Nenin 19(3), Nenin 20 dhe Nenin 21, përveç nëse Marrëveshja e Pjesëmarrjes pezullohet ose ndërpritet në përputhje me Nenin 71 dhe Nenin 72.

TITULLI 4

Ankandet

Neni 27

Dispozitat e përgjithshme për Ankande

1. Platforma e Vetme e Alokimit i alokon Pjesëmarrësit të Regjistruar të Drejtat Afatgjate të Transmisionit nëpërmjet Alokimit Eksplicit. Para Ankandit, Platforma e Vetme e Alokimit duhet të publikojë Specifikimet e Ankandit në uebfaqen e saj.
2. Ankandet organizohen përmes Mjetit të Ankandit. Secili Pjesëmarrës i Regjistruar që plotëson kriteret për pjesëmarrje në ankand mund të vendosë oferta në Mjetin e Ankandit derisa të skadojë afati përkatës për vendosjen e ofertave në ankand sipas specifikimit përkatës të Ankandit.
3. Pasi të skadojë afati përkatës për vendosjen e ofertave në ankandin specifik, Platforma e

Rregullat e harmonizuara të alokimit të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

Alokimit shqyrton ofertat duke përfshirë edhe limitet përkatëse të kreditit të Pjesëmarrësve të Regjistruar. Rezultatet e Ankandit i komunikohen Pjesëmarrësve të Regjistruar përmes mjetit të ankandit.

4. Platforma e Vetme e Alokimit siguron informimin mbi ankandet e ardhshme duke publikuar në uebfaqen e saj një kalendar të përkohshëm të ankandit me datat e ankandëve në një kohë të arsyeshme përpara zhvillimit të ankandëve. Për afatet kohore standarde të Alokimit të Kapaciteteve të Ardhshme të specifikuar në Nenin 28(1), një kalendar i përkohshëm i ankandit për çdo vit kalendarik publikohet jo më vonë se data 1 dhjetor e vitit parardhës duke përfshirë informacionin e përkohshëm në formën e produktit, periudhës së produktit dhe periudhës së ofertimit.

Neni 28

Afati kohor i alokimit të kapaciteteve dhe forma e produktit

1. Afatet kohore standarde për alokimin e kapaciteteve të ardhshme, në varësi të disponueshmërisë së produktit, përcaktohen si në vijim:
 - (a) afati kohor vjetor: fillon në ditën e parë dhe përfundon në ditën e fundit të një viti kalendarik; dhe
 - (b) afati kohor mujor: fillon në ditën e parë dhe përfundon në ditën e fundit të një muaji kalendarik.
2. Për afatet kohore standarde të renditura në paragrafin 1 dhe në varësi të disponueshmërisë së kapaciteteve ndërzonale, Platforma e Vetme e Alokimit organizon së paku një ankand në vit për afatin kohor vjetor dhe një ankand në muaj për afatin kohor mujor. Për shmangien e dyshimit, kjo nuk duhet të përjashtojë mundësinë për të zhvilluar një ankand të përbashkët të kapaciteteve ndërzonale të kufijve dhe drejtimeve të disa Zonave Ofertuese ose të ndajë kapacitetin ndërzonale në nënkategoritë individuale ose të ndryshme të interkonektorëve të një kufiri të Zonës Ofertuese veçmas.
3. Forma standarde e produktit të Ankandit do të jetë një produkt bazë me të cilin një shumë fikse në MW gjatë gjithë Periudhës së Produktit ndahen sipas periudhave të paralajmëruara të reduktimit.
4. Afatet kohore shtesë dhe/ose një formë shtesë e produkteve të ndryshme nga produktet standarde dhe afatet kohore të përshtatura në paragrafin 1, 2 dhe 3 të këtij neni, mund të ofrohen, siç specifikohet në hartimin rajonal të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë në përputhje me Nenin 31(4).) të Rregullores së FCA-së.

Neni 29

Specifikimet e Ankandit

1. Platforma e Vetme e Alokimit publikon një version të përkohshëm të Specifikimeve të Ankandit dhe një version përfundimtar të Specifikimeve të Ankandit siç përcaktohet në paragrafët 2 deri 3 të këtij Neni.
2. Për Ankandet vjetore, Platforma e Vetme e Alokimit publikon Specifikimet e Përkohshme dhe Përfundimtare të Ankandit jo më vonë se një (1) javë dhe për çdo afat kohor më i shkurtër i Alokimit të Kapaciteteve jo më vonë se dy (2) Ditë Pune para përfundimit të Periudhës së Oferrimit të një Ankandi . Specifikimi i përkohshëm i ankandit duhet të theksojë në veçanti:
 - (a) Kodin që identifikon ankandin në mjetin e ankandit;
 - (b) Llojin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë;

- (c) Afatin kohor të Alokimit të Kapacitetit (p.sh. në vit, në muaj ose tjetër, siç përshkruhet në Nenin 28);
 - (d) Formën e produktit (p.sh. baza, piku, pikut më ulët siç përshkruhet në Nenin 28);
 - (e) Identifikimi i kufirit(-ve) të Zonës Ofertuese ose një nëngrup i interkonektorëve në kufirin dhe drejtimin e zonave ofertuese të mbuluara;
 - (f) Afatin e fundit për kthimin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë të alokuara në ankandet e mëparshme për kufirin(-jtë) përkatës të zonave ofertuese.
 - (g) Periudhën e Produktit;
 - (h) Periudha(-t) e reduktimit që lidhet me periudhën e produktit sipas aplikueshmërisë;
 - (i) Periudhën e Ofertimit;
 - (j) Afatin e fundit për publikimin e rezultateve të përkohshme të ankandit;
 - (k) Periudhën e kontestimit në përputhje me Nenin 37;
 - (l) Kapacitetin e ofertuar të përkohshëm, i cili nuk përfshin Kapacitetin Ndërzonal të lëshuar nëpërmjet kthimit të të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë dhe Kapacitetit Ndërzonal të lëshuar në përputhje me Nenin 71 dhe Nenin 72.
 - (m) Çdo informacion tjetër ose kusht të aplikueshëm për produktin ose ankandin.
3. Jo më herët se katër (4) orë pas publikimit të Specifikimeve të Përkohshme të Ankandit, Platforma e Vetme e Alokimit do të publikojë Specifikimet përfundimtare të Ankandit për atë Ankand ku Përcaktohet Kapaciteti i Ofertuar përfundimtar dhe çdo përditësim tjetër i informacionit apo kushteve përkatëse të aplikueshme për produktin ose Ankandin.
4. Kapaciteti përfundimtar i ofruar do të përbëhet nga:
- (a) Kapaciteti i përkohshëm i ofruar;
 - (b) Kapaciteti i disponueshëm Ndërzonal i alokuar tashmë Pjesëmarrësve të Regjistruar, për të cilët është dorëzuar një kërkesë e vlefshme për kthimin e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë për këtë Ankand në përputhje me Nenin 38 dhe Nenin 39; dhe
 - (c) Kapaciteti i disponueshëm Ndërzonal i alokuar tashmë Pjesëmarrësve të Regjistruar do të rialokohet si rezultat i pezullimit ose ndërprerjes në përputhje me Nenin 71 dhe Nenin 72.
5. Platforma e Vetme e Alokimit duhet të publikojë formatin që do të përdoret për ofertim.

Neni 30

Periudhat e reduktimit të kapacitetit të ofruar

1. Platforma e Vetme e Alokimit mund të shpallë një ose më shumë Periudha Reduktimi në Specifikimin e Ankandit. Në këtë rast, Specifikimi i Ankandit do të përfshijë për secilën periudhë Reduktimi informacionet mbi kohëzgjatjen e periudhës së reduktimit dhe shumën e kapaciteteve të ofruara.

Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

2. Për të shmangur dyshimet, Periudhat e Reduktimit nuk do të zbatohen për të Drejtat e Alokuaara Afatgjate të Transmisionit dhe nuk merren parasysh për asnjë qëllim, duke përfshirë kompensimin si kufizim sipas TITULLIT 9.

Neni 31

Dorëzimi i ofertave

1. Pjesëmarrësi i Regjistruar dorëzon ofertën ose grupin e ofertave në Platformën e Vetme të Alokimit në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - (a) duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike duke përdorur mjetin e ankandit dhe gjatë periudhës së ofertimit siç specifikohet në Specifikimin e Ankandit;
 - (b) duhet të identifikojë Ankandin përmes një kodi identifikimi siç specifikohet në paragrafin 2(a) të Nenit 29;
 - (c) duhet të identifikojë Pjesëmarrësin e Regjistruar që dorëzon ofertën përmes kodit EIC;
 - (d) duhet të identifikojë kufirin dhe drejtimin e Zonave të Ofertimit për të cilin dorëzohet oferta;
 - (e) duhet të theksojë çmimin e ofertës, i cili duhet të jetë i ndryshëm për secilën ofertë të të njëjtit Pjesëmarrës të Regjistruar, pa taksë dhe tatime, në monedhën Euro për MW/h të Periudhës së Produktit, d.m.th. Euro/MW/h e shprehur në maksimumi prej dy (2) presje dhjetore dhe të barabarta ose më të mëdha se zero;
 - (f) duhet të theksojë sasinë e ofertës në MW të plotë, e cila duhet të shprehet pa presje dhjetore, shuma minimale e një oferte të vetme është një (1) MW.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar mund të modifikojë ofertën e tij të regjistruar më parë ose grupin e ofertave në çdo kohë gjatë periudhës së ofertimit, duke përfshirë anulimin e saj. Në rast se oferta është modifikuar, për përcaktimin e rezultateve të ankandit merret parasysh vetëm modifikimi i fundit i vlefshëm i ofertës ose grupit të ofertave.
3. Nëse sasia e ofertës, ose sasia e llogaritur si shumë e sasisë së ofertës për disa oferta të dorëzuara për të njëjtin ankand gjatë periudhës së ofertimit, nga Pjesëmarrësi i Regjistruar tejkalon kapacitetin e ofruar të shpallur në Specifikimin e Ankandit, atëherë kjo ofertë ose këto oferta refuzohen plotësisht. Në rastin kur modifikimi i ofertave të dorëzuara më parë rezultojnë në tejkalimin e kapacitetit të ofruar, modifikimi refuzohet, ndërsa ofertat e regjistruara më parë do të qëndrojnë.
4. Nëse sasia e ofertës ose sasia e llogaritur si shuma e sasisë së ofertave të dorëzuara për të njëjtin ankand, nga një pjesëmarrës i regjistruar, tejkalon kapacitetin e ofruar të shpallur pas dorëzimit të ofertave, ofertat me çmimin më të ulët të ofertës do të refuzohen një (1) nga një (1) derisa shuma totale e lejuar e ofertës është më e ulët ose e barabartë me kapacitetin e ofruar. Në rast se Rregullat e Sistemit të Informacionit lejojnë dorëzimin e ofertave me të njëjtin Çmim të Ofertimit nga një Pjesëmarrës i Regjistruar, Platforma e Vetme e Alokimit mund të aplikojë kritere shtesë ose rregulla për të vendosur se cila ofertë do të refuzohet. Kritere ose rregulla të tilla shtesë do të përfshihen në Rregullat e Sistemit të Informacionit dhe do të jenë një ose më shumë nga këto:
 - (a) Dorëzimi kronologjik (afati kohor); dhe/ose
 - (b) Identifikimi i ofertës i caktuar nga Platforma e Ankandit; dhe/ose
 - (c) Refuzimi i të gjitha ofertave relevante me të njëjtin çmim të ofertës.

5. Procesi i lartpërmendur do të zbatohet për të gjitha format e produktit të Ankandit dhe të gjitha afatet kohore të Alokimit të Kapacitetit të Ardhshtëm.

Neni 32

Regjistrimi i ofertës

1. Platforma e Vetme e Alokimit nuk regjistron ofertën që:
 - (a) nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e Nenit 31; ose
 - (b) është dorëzuar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar i cili është suspenduar në përputhje me Nenin 71.
2. Në rast se oferta ose grupi i ofertave përmbushë kërkesat e përcaktuara në Nenin 28, Platforma e Vetme e Alokimit i konfirmon Pjesëmarrësit të Regjistruar që oferta(-at) e tillë është regjistruar saktë me një konfirmim të pranimit nëpërmjet mjetit të ankandit. Nëse Platforma e Vetme e Alokimit nuk lëshon konfirmimin për pranimin e një oferte, kjo ofertë do të konsiderohet se nuk është regjistruar.
3. Platforma e Vetme e Alokimit njofton Pjesëmarrësin e Regjistruar, oferta e të cilit është refuzuar si e pavlefshme si dhe arsyen e këtij refuzimi, pa vonesa të panevojshme pas refuzimit të ofertës.
4. Platforma e Vetme e Alokimit mbanë një regjistër të të gjitha ofertave të vlefshme të pranuar.
5. Secila ofertë e vlefshme e regjistruar në mbyllje të periudhës së ofertimit përbën ofertë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme nga Pjesëmarrësi i Regjistruar për të blerë të drejtat ditore të Transmisionit deri në sasinë e ofertës dhe me çmime deri në çmimin e ofertës, dhe sipas kushteve dhe termave të këtyre Rregullave të Alokimit dhe Specifikimeve përkatëse të Ankandit.

Neni 33

Oferta e paracaktuar

1. Pjesëmarrësi i regjistruar ka mundësinë të vendosë oferta të paracaktuara për ankande.
2. Oferta e paracaktuar, pasi të identifikohet si e tillë nga Pjesëmarrësi i Regjistruar, zbatohet automatikisht për çdo ankand të mëpasshëm përkatës siç përcaktohet nga Pjesëmarrësi i Regjistruar kur vendos ofertën e paracaktuar. Gjatë hapjes së periudhës përkatëse të ofertimit, oferta e regjistruar e paracaktuar konsiderohet si ofertë e dorëzuar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar për ankandin përkatës. Kjo ofertë konsiderohet si e dorëzuar kur Platforma e Alokimit i dërgon Pjesëmarrësit të Regjistruar konfirmimin e pranimit.
3. Nëse sasia e një oferte, ose sasia e llogaritur si shuma e sasisë së ofertave të dorëzuara për të njëjtin ankand, nga një pjesëmarrës i regjistruar, tejkalon kapacitetin e ofruar të shpallur pas dorëzimit të ofertave, ofertat me çmimin më të ulët të ofertës do të refuzohen një (1) nga një (1) derisa shuma totale e lejuar e ofertës është më e ulët ose e barabartë me kapacitetin e ofruar. Në rast se Rregullat e Sistemit të Informacionit lejojnë dorëzimin e ofertave me të njëjtën Çmim Ofertimi nga një Pjesëmarrës i Regjistruar, Platforma e Alokimit mund të aplikojë kritere shtesë ose rregulla për të vendosur se cila ofertë do të refuzohet. Kritere ose rregulla të tilla shtesë do të përfshihen në Rregullat e Sistemit të Informacionit dhe do të jenë një ose më shumë nga këto:
 - (a) Dorëzimi kronologjik (afati kohor); dhe/ose
 - (b) Identifikimi i ofertës i caktuar nga Platforma e Ankandit; dhe / ose

(c) Refuzimi i të gjitha ofertave relevante me të njëjtin çmim të ofertës.

4. Pjesëmarrësi i Regjistruar që dëshiron të modifikojë ofertën e paracaktuar për një ankand të ardhshëm duhet të ndryshojë sasinë e ofertës dhe çmimin e ofertës së ofertave të tij të paracaktuara përpara hapjes së periudhës së ofertimit të ankandit të aplikueshëm.
5. Pjesëmarrësi i Regjistruar që nuk dëshiron të dorëzojë ofertën e paracaktuar në mjetin e ankandit për ankandet e ardhshme, mund të anulojë ofertat e tij të paracaktuara përpara hapjes së periudhës pasuese të ofertimit të ankandit.

Neni 34

Verifikimi i limitit të kredisë

1. Me rastin e dorëzimit të një oferte ose një grupi ofertash nga Pjesëmarrësi i Regjistruar në mjetin e ankandit, Platforma e Alokimit kontrollon nëse detyrimet maksimale të pagesës (MPO) që lidhen me ofertën(-at) e regjistruara të atij Pjesëmarrësi të Regjistruar të llogaritura sipas paragrafëve 4 dhe 5 të këtij neni në kohën e dorëzimit të ofertave tejkalon limitin e kredisë. Nëse detyrimi maksimal i pagesës në lidhje me ofertat e tilla të regjistruara tejkalon limitin e kredisë, Platforma e Vetme e Alokimit nxjerr automatikisht, nëpërmjet mjetit të ankandit, një paralajmërim për pjesëmarrësin e regjistruar për të modifikuar limitin e kredisë. Ofertat nuk refuzohen automatikisht nëse detyrimi maksimal i pagesës që i atribuohet ofertave të regjistruara tejkalon limitin e kredisë gjatë dorëzimit të ofertës, por vetëm pas procesit të përshkruar në paragrafin 2 të këtij neni.
2. Në mbyllje të periudhës së ofertimit, Platforma e Vetme e Alokimit kontrollon sërish nëse detyrimet maksimale të pagesës lidhur me ofertat e regjistruara të llogaritura sipas paragrafit 5 të këtij neni e kalojnë limitin e kredisë. Nëse detyrimet maksimale të pagesës në lidhje me këto oferta tejkalojnë limitin e kredisë, këto oferta, duke filluar me ofertën me çmimin më të ulët të ofertës, do të përjashtohen një (1) nga një (1) derisa detyrimet maksimale të pagesës të jenë më të ulëta ose barazi me limitin e kredisë. Platforma e Vetme e Alokimit mund të aplikojë kritere shtesë ose rregulla për të vendosur se cila ofertë do të refuzohet. Kriteret ose rregullat e tilla shtesë përfshihen në Rregullat e Sistemit të Informacionit dhe ato do të jenë një ose më shumë nga si në vijim:
 - (a) Dorëzimi kronologjik (afati kohor); dhe/ose
 - (b) Identifikimi i ofertës i caktuar nga Mjeti i Ankandit; dhe/ose
 - (c) Refuzimi i të gjitha ofertave relevante me të njëjtin çmim të ofertës.
3. Platforma e Vetme e Alokimit tregon kolaterale të pamjaftueshme si arsye për përjashtimin e ofertës në njoftimin e rezultateve të ankandit drejtuar Pjesëmarrësit të Regjistruar.
4. Platforma e Vetme e Alokimit vlerëson në mënyrë të vazhdueshme të gjitha ofertat, pavarësisht se në cilin ankand dhe në cilin kufi dhe drejtim të zonës së ofertimit janë dorëzuar ato. Në rast se kemi oferta të lidhura me ankande të ndryshme dhe të mbivendosura, Platforma e Alokimit do marrë në konsideratë të gjitha detyrimet maksimale të llogaritura të pagesës si detyrime të pagesave të papaguara sipas Nenit 23.
5. Për llogaritjen e detyrimeve maksimale të pagesës në lidhje me kufirin dhe drejtimin e një zone të ofertimit, Platforma e Vetme e Alokimit do të rendit ofertat e regjistruara të një Pjesëmarrësi të Regjistruar sipas çmimit të ofertës sipas renditjes zbritëse (renditja sipas meritës). Oferta 1 do të jetë oferta me çmimin e ofertës më të lartë dhe oferta n do të jetë oferta me çmimin e ofertës më të ulët. Platforma e Alokimit do të llogarisë detyrimet maksimale të pagesës sipas ekuacionit të mëposhtëm:

$$MPO = \sum_{hours} MAX \left[BidPrice(1) * BidQuantity(1); BidPrice(2) * \sum_{i=1}^2 BidQuantity(i); \dots \dots; BidPrice(n-1) * \sum_{i=1}^{n-1} BidQuantity(i); BidPrice(n) * \sum_{i=1}^n BidQuantity(i) \right]$$

6. Gjatë llogaritjes së detyrimeve maksimale të pagesës sipas paragrafit 5 të këtij neni, Platforma e Alokimit merr parasysh edhe:
- nëse është e aplikueshme, për secilën orë të periudhës së reduktimit, sasinë maksimale të të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë që mund të Alokoen nga Pjesëmarrësit e Regjistruar gjatë Periudhës së Reduktimit;
 - ritja e detyrimeve maksimale të pagesës me tatimet dhe tatimet në fuqi, sipas nenit 64; dhe
 - për sa i përket të Drejtave Afatgjata të Transmisionit në një Produkt me kohëzgjatje prej një (1) ose më shumë muaj, një (1) ose dy (2) këste mujore respektivisht duhet të sigurohen në përputhje me llogaritjen e shumës së duhur sipas Nenit 63(5).

Neni 35

Përcaktimi i rezultateve të ankandit

- Pas skadimit të periudhës së ofertimit për një ankand dhe verifikimit të limitit të kredisë në bazë të Nenit 34, Platforma e Vetme e Alokimit përcakton rezultatet e ankandit dhe alokon të Drejtat Afatgjate të Transmisionit në përputhje me këtë nen.
- Përcaktimi i rezultateve të Ankandit duhet të përfshijë si në vijim:
 - përcaktimin e sasisë totale të të Drejtave të alokuara të Transmisionit Afatgjatë për kufirin dhe drejtimin e Zonës Ofertuese;
 - identifikimin e ofertave fituese që duhet të përmbushen plotësisht ose pjesërisht; dhe
 - përcaktimin e Çmimit Margjinal sipas kufirit dhe drejtimin të Zonës Ofertuese.
- Platforma e Vetme e Alokimit përcakton rezultatet e ankandit duke përdorur një funksion optimizues me qëllim të maksimizimit të shumës së tepicës së Pjesëmarrësve të Regjistruar dhe të ardhurave të gjeneruara nga ofertat fituese duke respektuar kufizimet e funksionit të optimizimit në formën e kapaciteteve relevante të ofruara. Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqen e saj publikon informacione shpjeguese shtesë mbi funksionin e optimizimit të algoritmit.
- Platforma e Vetme e Alokimit përcakton çmimin marginal për çdo kufi dhe drejtim të Zonës Ofertuese bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - nëse sasia totale e kapacitetit Ndërzonal për të cilën janë paraqitur ofertat e vlefshme është më e ulët ose e barabartë me kapacitetin përkatës të ofruar për ankandin përkatës, atëherë çmimi marginal do të jetë zero;
 - nëse sasia totale e kapacitetit Ndërzonal për të cilën janë paraqitur ofertat e vlefshme tejkalon kapacitetin përkatës të ofruar për ankandin përkatës, çmimi marginal vendoset në çmimin më të ulët të ofertave të alokuara plotësisht ose pjesërisht duke përdorur kapacitetet e ofruara përkatëse.
- Nëse dy (2) ose më shumë Pjesëmarrës të Regjistruar kanë dorëzuar për një kufi dhe drejtim të

Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

Zonës Ofertuese oferta të vlefshme me të njëjtin çmim të ofertës, që nuk mund të pranohen plotësisht për sasinë totale të kërkuar të të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë, Platforma e Vetme e Alokimit përcakton ofertat fituese dhe sasinë e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë për Pjesëmarrësin e Regjistruar si në vijim:

- (a) Kapaciteti Ndërzonal i disponueshëm për oferta, që përcakton çmimin marginal, ndahet në mënyrë të barabartë midis numrit të Pjesëmarrësve të Regjistruar që kanë dorëzuar këto oferta;
 - (b) në rast se sasia e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë i kërkuar nga një Pjesëmarrës i Regjistruar me çmim marginal është më e ulët ose e barabartë me pjesën e llogaritur sipas pikës (a) më sipër, kërkesa e këtij Pjesëmarrësi të Regjistruar do të përmbushet plotësisht;
 - (c) në rast se sasia e kërkuar e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë nga një Pjesëmarrës i Regjistruar me Çmim Margjinal tejkalon pjesën e llogaritur sipas pikës (a) më sipër, kërkesa e këtij Pjesëmarrësi të Regjistruar përmbushet deri në shumën e përqindjes së llogaritur sipas në pikën (a) më sipër;
 - (d) çdo Kapacitet Ndërzonal i mbetur pas alokimit sipas pikave (b) dhe (c) pjesëtohet me numrin e Pjesëmarrësve të Regjistruar, kërkesat e të cilëve nuk janë përmbushur plotësisht dhe u janë alokuar atyre duke aplikuar procesin e përshkruar në pikat (a), (b) dhe (c) më sipër.
6. Kur një periudhë reduktimi Shënohet në Specifikimet Ankandit, Platforma e Alokimit do të përcaktojë Rezultatet e Ankandit në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3 deri 5 të këtij Neni, të ndryshuar si më poshtë:
- (a) Ofertat fituese dhe çmimet margjinale për kufirin dhe drejtimin e zonës përkatëse të ofertave përcaktohen sipas paragrafëve 3 deri 5 të këtij neni;
 - (b) Për çdo Periudhë Reduktimi sasia e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë që do të ndahet cdo Pjesëmarrësi të Regjistruar llogaritet në mënyrë proporcionale duke marrë parasysh sasinë e të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë që korrespondojnë me ofertat fituese përkatëse të secilit Pjesëmarrës të Regjistruar dhe reduktimet Respektive të Kapaciteteve të ofruara. Platforma e Alokimit do të publikojë në faqen e saj të internetit sqarime dhe shembuj në lidhje me llogaritjen e sasisë së të Drejtave të Transmisionit Afatgjatë që do t'u ndahen Pjesëmarrësve të regjistruar në Periudhën e Reduktimit.
7. Sa herë që llogaritja e përcaktuar në paragrafët 3 deri 6 të këtij neni nuk rezulton në një sasi të plotë të MW, në përputhje me Nenin 31, paragrafi 1(f), të Drejtat Afatgjate të Transmisionit do të rumbullakosen në vlerën e plotë të MW më të afërt. Rasti kur të Drejtat të Transmisionit Afatgjatë të alokuara për Pjesëmarrësit e Regjistruar individualë janë të barabarta me zero pas rumbullakimit nuk do të ndikojnë në përcaktimin e Çmimit Margjinal.
8. Të Drejtat Afatgjate të Transmisionit konsiderohen se i janë alokuar Pjesëmarrësit të Regjistruar që nga momenti kur Pjesëmarrësi i Regjistruar është informuar për rezultatet dhe periudha e kontestimit është e mbyllur në përputhje me Nenin 37. Në rast se Ankandi nuk është kryer me sukses, zbatohen procedurat rezervë të përcaktuara në TITULLIN 8.

Neni 36

Komunikimi i rezultateve të përkohshme të Ankandit

1) Platforma e Vetme e Alokimit publikon në uebfaqen e saj rezultatet e përkohshme të Ankandit sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se siç është specifikuar në Specifikimin përfundimtar të Ankandit.

Rregullat e harmonizuara të alokimit të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

2) Publikimi i rezultateve të përkohshme të Ankandit për secilin kufi të Zonës Ofertuese të përfshirë në ankand duhet të përmbajë së paku të dhënat e mëposhtme:

- a) të Drejtat totale të kërkuara Afatgjate të Transmisionit në MW;
- b) të Drejtat totale të alokuara Afatgjate të Transmisionit në MW;
- c) çmimin marginal në Euro/MW/h;
- d) numrin e Pjesëmarrësve të Regjistruar që marrin pjesë në Ankand;
- e) listën e emrave dhe numrin e Pjesëmarrësve të Regjistruar që kanë vendosur të paktën një ofertë fituese në ankand;
- f) listën e ofertave të regjistruara pa identifikimin e Pjesëmarrësve të Regjistruar (Iakorja e ofertës);dhe
- g) të ardhurat nga mbingarkesa për çdo Zonë Ofertimi.

1. Jo më vonë se 30 minuta pas publikimit të rezultateve të Ankandit, Platforma e Vetme e Alokimit nëpërmjet Mjetit të Ankandit i vë në dispozicion të çdo Pjesëmarrësi të Regjistruar që ka dorëzuar ofertë në një ankand specifik për secilin kufi të Zonës së Ofertimit të përfshirë në ankand, së paku të dhënat e mëposhtme:
 - (a) të Drejtat Afatgjate të Transmisionit të alokuara për çdo orë të Periudhës së Ofertës në MW;
 - (b) Çmimin Margjinal në Euro/MW/h; dhe
 - (c) shumën e duhur për të Drejtat Afatgjate të Transmisionit të alokuara në Euro (€), e rrumbullakuar në dy presje dhjetore; dhe
 - (d) shumën e duhur për një këst mujor për të Drejtat Afatgjate të Transmisionit të alokuara në Euro, të rrumbullakuar në dy numra pas presjes dhjetore, në rast se Periudha e Produktit është më e gjatë se një muaj.
2. Në rast se Mjeti i Ankandit nuk është i disponueshëm, Platforma e Vetme e Alokimit informon Pjesëmarrësit e Regjistruar për rezultatet e përkohshme të Ankandit në përputhje me TITULLIN 8.

Neni 37

Kontestimi i Rezultateve të Ankandit

1. Pjesëmarrësit e Regjistruar kontrollojnë rezultatet e ankandit dhe, kur është e arsyeshme, mund të kundërshtojnë rezultatet e ankandit brenda periudhës së kontestimit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni. Platforma e Vetme e Alokimit merr në konsideratë kontestimin e tillë vetëm nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar është në gjendje të demonstrojë gabimin e bërë nga Platforma e Vetme e Alokimit në rezultatet e Ankandit.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar mund të kontestojë rezultatet e Ankandit brenda afatit të përcaktuar në Specifikimet e Ankandit përkatës, por jo më vonë se dy (2) Ditë Pune pasi Pjesëmarrësit e Regjistruar të jenë njoftuar për rezultatet e përkohshme të ankandit.
3. Kontestimi i komunikohet në Platformën e Vetme të Alokimit me cilësimin “kontesim”.
4. Çdo kontestim duhet të përmbajë si në vijim:
 - (a) datën e kontestimit;
 - (b) identifikimin e ankandit të kontestuar;
 - (c) identifikimin e pjesëmarrësit të regjistruar;

- (d) emrin, adresën elektronike dhe numrin e telefonit të Pjesëmarrësit të Regjistruar;
 - (e) përshkrimin e detajuar të fakteve dhe arsyejen e kontestimit; dhe
 - (f) dëshminë për rezultatet e gabuara të Ankandit;
5. Platforma e Vetme e Alokimit duhet të njoftojë Pjesëmarrësin e Regjistruar për vendimin e saj mbi kontestimin jo më vonë se katër (4) Ditë Pune pasi Pjesëmarrësit të Regjistruar të jenë njoftuar për rezultatet e përkohshme të ankandit.
 6. Në fund të ditës së katërt (4) të punës pas publikimit të rezultateve të përkohshme të ankandit dhe nëse ankandi nuk anulohet, rezultatet e përkohshme të ankandit do të konsiderohen si përfundimtare dhe detyruese pa njoftim të mëtejshëm.

TITULLI 5

Kthimi i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

Neni 38

Dispozitat e Përgjithshme

1. Mbajtësi(-t) e së Drejtës Afatgjate të Transmisionit mund të kthejë ndonjë ose të gjitha të drejtat e tyre afatgjate të Transmisionit në platformën e vetme të alokimit për rialokim në ndonjë ankand të mëvonshëm afatgjatë pasi të publikohen rezultatet përfundimtare të ankandit.
2. Të drejtat e kthyera afatgjate të transmisionit do të jenë një brez konstant i MW të plota gjatë periudhës specifike kohore të ankandit pasues. Ankandi në të cilin janë alokuar të drejtat afatgjate të Transmisionit dhe ankandi pasues të cilit do t'i kthehen të drejtat afatgjate të Transmisionit do të jenë për të njëjtën formë të produkteve.
3. Vëllimi minimal për një të Drejtë Afatgjate Transmetimi të kthyer do të jetë një (1) MW gjatë periudhës specifike kohore të ankandit pasues.
4. Platforma e vetme e alokimit do t'i vërë në dispozicion vëllimet e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit të kthyera në Ankandin pasues, duke rritur Kapacitetin e Ofruar të shpallur në Specifikimet e Përkohshme të Ankandit në përputhje me rrethanat dhe në mënyrë të barabartë për çdo orë të Periudhës së Produktit. E njëjta gjë vlen edhe për rastet kur Kapaciteti i Ofruar i shpallur në Specifikimet e Përkohshme të Ankandit për Ankandin pasues afatgjatë përmban një Periudhë Reduktimi.
5. Nëse të drejtat e kthyera afatgjate të transmisionit rumbullakohen në përputhje me procesin e përshkruar në Nenin 35(7), Platforma e vetme e alokimit duhet të kompenzojë Pjesëmarrësin e Tregut për shumën e plotë të të Drejtave Afatgjatë të Transmisionit të kthyera në përputhje me Nenin 40.

Neni 39

Procesi i kthimit

1. Mbajtësi(-t) e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit që dëshirojnë të kthejnë të Drejtat e tyre Afatgjate të Transmisionit duhet të dërgojnë një njoftim, direkt ose indirekt, përmes një pale të tretë të autorizuar, nëpërmjet Mjetit të Ankandit në Platformën e Vetme të Alokimit në përputhje me Rregullat përkatëse të Sistemit Informativ jo më vonë se afati i specifikuar në Specifikimet e Përkohshme të Ankandit për ankandin pasues, në të cilin duhet të kthehen të Drejtat Afatgjate të Transmisionit.

Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

2. Njoftimi i vlefshëm për kthim sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
 - (a) kodin EIC të mbajtësit të së Drejtës Afatgjate të Transmisionit;
 - (b) identifikimin e ankandit pasues në të cilin është kthyer e Drejta Afatgjate e Transmisionit ; dhe
 - (c) vëllimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit për kthim.
3. Për të qenë në gjendje të kthejë të Drejtat Afatgjate të Transmisionit , Pjesëmarrësi i regjistruar duhet të:
 - (a) Të ketë një Marrëveshje të vlefshme dhe efektive për Pjesëmarrjen në Platformën e Vetme të Alokimit;
 - (b) Të ketë fituar të Drejtat Afatgjate të Transmisionit në kohën që bën njoftimin për kthim;
 - (c) Të dërgojë njoftimin përpara afatit të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni; dhe
 - (d) Të sigurojë apo përmbushë detyrimet financiare sipas këtyre Rregullave të Alokimit.
4. Nëse plotësohen kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, Platforma e Vetme e Alokimit do të dërgojë pa vonesë të panevojshme një njoftim për Pjesëmarrësin e Regjistruar nëpërmjet Mjetit të Ankandit që do të përmbajë:
 - (a) një mesazh që konfirmon pranimin e kthimit në përputhje me paragrafin 7 të këtij neni; ose
 - (b) një mesazh që refuzon kthimin duke përfshirë arsyet e refuzimit sipas paragrafit 7.
5. Nëse kthimi pranohet, platforma e vetme e alokimit do të zvogëlojë vëllimin total të të Drejtave të Afatgjate të Transmisionit të mbajtura nga mbajtësi përkatës i së Drejtës Afatgjate të Transmisionit me shumën e kthyer.
6. Mbajtësi(-t) e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit që dëshirojnë të modifikojnë kthimin e tyre të njoftuar në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të dërgojnë një njoftim nëpërmjet Veglave të Ankandit me volumin e rregulluar të të Drejtave Afatgjatë të Transmisionit për t'u kthyer para skadimit të afatit për kthimin e të Drejtave Afatgjatë të Transmisionit në përputhje me paragrafin 1. Kur vëllimi i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit që do të kthehen rregullohet në zero (0) MW, kthimi përkatës do të konsiderohet i anuluar.
7. Nëse Platforma e Alokimit nuk është në gjendje të regjistrojë një kthim siç është përcaktuar në këtë Kapitull, Platforma e Vetme e Alokimit mund të aplikojë një procedurë rezervë për shkëmbimin e të dhënave në përputhje me Nenin 53. Nëse nuk është teknikisht e mundur një procedurë rezervë për kthimin, nuk mund të kërkohet kompensim financiar nga Pjesëmarrësit e regjistruar.

Neni 40

Kompensimi i mbajtësve të së Drejtës Afatgjate të Transmisionit

1. Pjesëmarrësit e Regjistruar që kanë kthyer të Drejtën Afatgjate të Transmisionit kanë të drejtë të marrin një kompensim të barabartë me vlerën e të Drejtave të kthyer të Transmisionit Afatgjatë të vendosura gjatë Ankandit(-eve) përkatëse të mëpasshme të llogaritura për çdo orë si në vijim:

(a) Çmimi Margjinal i Ankandit në të cilin e Drejta e kthyer Afatgjate e Transmisionit është rialokuar në Euro/MW për orë, shumëzuar me:

(b) sasinë e MW e cila është rialokua.

2. Pas kthimit, Pjesëmarrësi i Regjistruar pushon së qeni mbajtës i së Drejtës Afatgjate të Transmisionit për sasinë e kthyer të së Drejtës Afatgjate të Transmisionit . Kjo do të thotë se të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Pjesëmarrësit të Regjistruar lidhen me sasinë e kthyer afatgjate të Transmisionit do të pushojë, përveç atyre që lidhen me detyrimet e saj të pagesave në përputhje me TITULLIN 10 dhe kompensimin e përcaktuar në këtë kapitull 5. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Pjesëmarrësit të Regjistruar në lidhje me pjesën e pakthyer të së Drejtës Afatgjate të Transmisionit do të mbeten të paprekura.

TITULLI 6

Transferimi i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

Neni 41

Dispozitat e Përgjithshme

1. Mbajtësi(-t) e së drejtës afatgjate të transmisionit mund të transferojë disa ose të gjitha të drejtat e tyre afatgjate të Transmisionit tek një pjesëmarrës tjetër i regjistruar pasi rezultatet e ankandit në lidhje me këto të drejta të jenë përfundimtare. Pavarësisht se si është realizuar transferimi, ai do t'i njoftohet Platformës së Vetme të Alokimit pas procesit në përputhje me Nenin 42 dhe nëpërmjet Mjetit të Ankandit sipas një formati të specifikuar në uebfaqen Platformës së Vetme të Alokimit.

Vëllimi minimal i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit që mund të transferohen do të jetë një (1) MW për një (1) orë.

Neni 42

Procesi i transferimit

1. Transferuesi do të dërgojë një njoftim, direkt ose indirekt, nëpërmjet një pale të tretë të autorizuar, për transferimin në Platformën e Vetme të Alokimit nëpërmjet Mjetit të Ankandit me informacionin e mëposhtëm:
- (a) kodet e EIC të transferuesit dhe të marrësit;
 - (b) periudhën kohore të transferimit, duke përfshirë datat dhe orët e fillimit dhe mbarimit; dhe
 - (c) vëllimin (MW) e të Drejtës Afatgjate të Transmisionit, të transferuar në MW të plotë të përcaktuar në orë.
2. Njoftimi i transferimit do t'i dërgohet Platformës së Vetme të Alokimit jo më vonë se në ora 12:00h në ditën e dytë (2) para ditës së dorëzimit.
3. Për të qenë në gjendje të transferohen të Drejtat Afatgjate të Transmisionit, duhet të plotësohen kërkesat e mëposhtme:
- (a) transferuesi dhe marrësi kanë një Marrëveshje pjesëmarrjeje të vlefshme dhe efektive me Platformën e Vetme të Alokimit së paku për transferimin e të drejtave afatgjate të Transmisionit; transferuesi mban të drejtat përkatëse afatgjate të Transmisionit në momentin e njoftimit të transferimit;

- (b) transferuesi ka përmbushur ose siguruar detyrimet e tij financiare në përputhje me këto Rregulla të Alokimit, pavarësisht nëse transferuesi transferon të gjitha ose vetëm një pjesë të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit dhe madje edhe në rastin e transferimeve të shumfishta midis disa pjesëmarrësve të regjistruar; dhe
 - (c) transferuesi e ka dorëzuar njoftimin për transferimin para afatit në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.
4. Platforma e Vetme e Alokimit ia lëshon transferuesit, pa vonesa të panevojshme, një konfirmim për pranimin e njoftimit. Nëse njoftimi plotëson kërkesat në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, Platforma e Vetme e Alokimit informon transferuesin për njoftimin e transferimit.
 5. Në rast se konfirmimi nuk dërgohet nga Platforma e Vetme e Alokimit, njoftimi në fjalë do të konsiderohet se nuk është dorëzuar.
 6. Njoftimi i transferimit do të konfirmohet nga marrësi brenda katër (4) orëve pas marrjes së informacionit të transferimit nga Platforma e Vetme e Alokimit dhe jo më vonë se në ora 12:00h ditën e dytë para ditës së dorëzimit.
 7. Në rast se i transferuari nuk e konfirmon transferimin brenda afatit në përputhje me paragrafin 6, Platforma e Vetme e Alokimit do të anulojë automatikisht procesin e njoftimit të transferimit.
 8. Platforma e Vetme e Alokimit më pas do t'i lëshojë pa vonesë të panevojshme transferuesit dhe marrësit një konfirmim të dytë nëpërmjet Mjetit të Ankandit, ku thuhet:
 - (a) se njoftimi i transferimit është pranuar dhe është efektiv; ose
 - (b) që njoftimi i transferimit është refuzuar duke përfshirë arsyen(-et).
 9. Nëse për ndonjë arsye teknike, njohja nuk dërgohet nga Platforma e vetme e alokimit, transferimi në fjalë konsiderohet se nuk është dorëzuar.
 10. Transferuesi nuk ka të drejtë të tërheqë njoftimin e transferimit pasi marrësi ta ketë pranuar atë. Marrësi mund të iniciojë një transferim tjetër për të transferuar më tej të Drejtat Afatgjate të Transmisionit .
 11. Në rast të dështimit të Mjetit të Ankandit, do të zbatohet një procedurë kthimi në përputhje me TITULLIN 8. Nëse procesi i njoftimit të transferimit nuk mund të përfundojë në përputhje me këtë nen për shkak të një sistemi TI dhe/ose dështimit të procedurës rezervë, Pjesëmarrësit e Regjistruar nuk kanë të drejtë të kërkojnë asnjë kompensim financiar nga Platforma e Vetme e Alokimit.

Neni 43

Pasojat juridike të transferimit

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga këto Rregulla të Alokimit, me përjashtim të detyrimit të pagesës së mbajtësit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit në lidhje me alokimin e të Drejtës Afatgjate të Transmisionit në pajtim me Nenin 62(1), do të transferohen së bashku me të Drejtën Afatgjatë të Transmisionit .

Neni 44

Tabela e njoftimeve

1. Tabela e njoftimeve do të lehtësojë vetëm shkëmbimin e informacionit ndërmjet

Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

Pjesëmarrësve të Regjistruar në lidhje me interesin e tyre për blerjen dhe/ose shitjen e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit. Asnjë marrëveshje nuk mund të lidhet nëpërmjet kësaj tabele të njoftimit. Përdorimi i tabelës së njoftimeve është pa pagesë.

2. Çdo njoftim i publikuar në tabelën e njoftimeve nga Pjesëmarrësit e Regjistruar nuk do të konsiderohet si dëshmi për një kontratë të vlefshme dhe efektive për transferimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit.
3. Platforma e Vetme e Alokimit nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacionit të publikuar nga një Pjesëmarrës i Regjistruar në tabelën e njoftimeve.
4. Platforma e Vetme e Alokimit mund të fshijë nga tabela e njoftimeve çdo informacion që nuk konsideron të rëndësishëm për qëllimet e tabelës së njoftimeve. Në rast të një fshirja të tillë, Platforma e Vetme e Alokimit do të paraqesë arsyet për fshirjen Pjesëmarrësit të Regjistruar përkatës.

TITULLI 7

Shfrytëzimi dhe kompensimi i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

Neni 45

Parimet e Përgjithshme

1. Të Drejtat Fizike të Transmisionit do t'i nënshtrohen parimit Shfrytëzo ose Shite (UIOSI).
2. Mbajtësi i të Drejtave të alokuara Fizike të Transmisionit mund të nominojë të Drejtat Fizike të Transmisionit për përdorimin e tyre fizik në përputhje me Nenin 46. Mbajtësi i të Drejtave të alokuara Fizike të Transmisionit nuk ka të drejtë t'i nominojë ato për dorëzim fizik.
3. Në rast se Pjesëmarrësi i Regjistruar nuk nominon të Drejtat e tij Fizike të Transmisionit, Platforma e Vetme e Alokimit do të vë në dispozicion Kapacitetin Ndërzonal të të Drejtave Fizike të Transmisionit të panominuara për shpërndarjen përkatëse ditore. Bartësit e të Drejtës Fizike të Transmisionit, të cilët nuk i nominojnë të Drejtat e tyre Fize të Transmisionit për përdorim fizik të të drejtave të tyre ose që nuk i kanë rezervuar të Drejtat Fizike të Transmisionit Fizik për shërbimet e balancimit, kanë të drejtë të marrin kompensim në përputhje me Nenin 48.
4. Mbajtësit e të Drejtave Fizike të Transmisionit i nënshtrohen rregullave të kompensimit në përputhje me Nenin 48.
5. Në rast se mbajtësi i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit rezervon të Drejtat e tij Fizike të Transmisionit për shërbimet balancuese, ky Kapacitet Ndërzonal do të përjashtohet nga aplikimi i proceseve të kompensimit siç detajohet në TITULLIN 7. Procesi i njoftimit të një rezervimi të tillë do t'i nënshtrohet rregullave përkatëse të futura në fuqi në përputhje me regjimin rregullator kombëtar në fuqi dhe të publikuara nga Platforma e Vetme përgjegjëse e Alokimit.

Neni 46

Nominimi i të Drejtave Fizike të Transmisionit

1. Personat e kualifikuar për të nominuar të Drejtat Fizike të Transmisionit duhet të përmbushin kërkesat e përshkruara në Rregullat e Nominimit në fuqi. Personat e kualifikuar mund të jenë si në vijim:
 - (a) mbajtësi i të Drejtave Fizike të Transmisionit; ose

- (b) personi i njoftuar nga mbajtësi i të Drejtave Fizike të Transmisionit gjatë procesit të nominimit tek OST-të përkatëse në përputhje me rregullat përkatëse të nominimit; ose
 - (c) personi i autorizuar nga mbajtësi i të Drejtave Fizike të Transmisionit për të nominuar në përputhje me rregullat përkatëse të nominimit dhe i njoftuar në Platformën e Vetme të Alokimit.
2. Platforma e Vetme e Alokimit siguron që në uebfaqen e saj të bëhet një përmbledhje e opsioneve të renditura në paragrafin 1 të këtij neni, të cilat janë të zbatueshme në çdo kufi të Zonës Ofertuese.
 3. Për procesin e njoftimit të personave të kualifikuar në Platformën e Vetme të Alokimit në përputhje me paragrafin 1(c) të këtij neni duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:
 - (a) personi i kualifikuar duhet të ketë një Kod EIC për të lejuar identifikimin e tij në Dokumentin e të Drejtave; dhe
 - (b) mbajtësi i të Drejtave Fizike të Transmisionit njofton personin e kualifikuar në Platformën e Vetme të Alokimit përmes Mjetit të Ankandit në përputhje me Rregullat e Sistemit të Informacionit dhe më së voni një (1) orë para dërgimit të Dokumentit të të Drejtave për një ditë të caktuar.
 4. Platforma e Vetme e Alokimit nuk merr parasysh njoftimet e personave të kualifikuar të cilët nuk i plotësojnë kriteret në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni me rastin e dërgimit të Dokumentit të të Drejtave në lidhje me ditën e distribuimit të energjisë elektrike.
 5. Nominimi bëhet në përputhje me Dokumentin e të Drejtave.
 6. Platforma e Vetme e Alokimit publikon në uebfaqen e saj një listë me rregullat përkatëse të nominimit për kufijtë e Zonës Ofertuese.
 7. Afatet e nominimit afatgjatë për kufijtë përkatës të Zonës Ofertuese përcaktohen në Rregullat përkatëse të Nominimit. Platforma e Vetme e Alokimit publikon në uebfaqen e saj informacionet mbi afatet e nominimit afatgjatë për kufirin e Zonës Ofertuese. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis afateve të publikuara nga Platforma e Vetme të Alokimit dhe atyre të rregullave të vlefshme dhe ligjërish të detyrueshme përkatëse të nominimit, kjo e fundit prevalon dhe Platforma e Vetme e Alokimit nuk do të mbahet përgjegjëse për ndonjë dëmtim për shkak të mospërputhjes së tillë.

Neni 47

Dokumenti i të Drejtave

1. Dokumenti i të Drejtave duhet të përmbajë informacione në lidhje me vëllimin në MW që personat e kualifikuar kanë të drejtë të nominojnë në kufijtë specifikë të Zonës Ofertuese ose nëngrupet e ndërlidhësve të kufijve dhe drejttimeve të Zonës Ofertuese dhe për periudhat në orë në rastin e të Drejtave Fizike të Transmisionit. Në rastin e Opsioneve të të Drejtave Financiare të Transmisionit, Dokumenti i të Drejtave duhet të përmbajë informacione në lidhje me vëllimin në MW në kufijtë specifikë të Zonës Ofertuese ose nëngrupet e ndërlidhësve të kufijve dhe drejttimeve të Zonës Ofertuese dhe për periudhat në orë, për të cilat mbajtësi ka të drejtë në kompensim financiar në përputhje me Nenin 48. Në rast të detyrimeve të të Drejtave Financiare të Transmisionit, Dokumenti i të Drejtave duhet të përmbajë informacione në lidhje me vëllimin në MW në kufijtë dhe drejtimit specifikë të Zonës Ofertuese dhe për periudhat në orë, për të cilat mbajtësi ka të drejtë të marrë ose detyrohet të paguajë një kompensim financiar në përputhje me Nenin 48.
2. Platforma e Vetme e Alokimit dërgon Dokumentin e të Drejtave çdo ditë dhe jo më vonë se ora

Neni 48

Kompensimi i mbajtësve të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit për të Drejtat e panominuara Fizike dhe Financiare të Transmisionit

1. Platforma e Vetme e Alokimit kompenson mbajtësin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit për të Drejtat Afatgjate të Transmisionit të cilat rialokohen në alokimet përkatëse ditore. Platforma e Vetme e Alokimit kompenson mbajtësin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit për çdo MW që nuk është nominuar për periudhën përkatëse në orë në rastin e të Drejtave Fizike të Transmisionit dhe për të gjitha MW e alokuara për periudhën përkatëse në orë në rastin e të Drejtave Financiare të Transmisionit. Kompensimi llogaritet në rastin e të Drejtave Fizike të Transmisionit si dallimi ndërmjet vëllimeve të deklaruara në Dokumentin e të Drejtave dhe vëllimeve përfundimtare të nominuara dhe të pranuar nga OST përkatëse, në rastin e të Drejtave Financiare të Transmisionit si vëllimet e deklaruara në Dokumentin e të Drejtave, shumëzuar me një çmim, në varësi të llojit të alokimit të ditës në vijim, si në vijim:
 - (a) në rast të Alokimit Implicit të një dite më përpara, duke përfshirë në rastin e alokimit të kthimit për alokimin implicite, çmimi do të jetë Përhapja e Tregut në kufirin përkatës të Zonës Ofertuese për periudhën në fjalë për orë vetëm në rast se diferenca e çmimit është pozitive në drejtim të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit të Alokimit Implicit të një dite më përpara në të cilin është rialokuar ai Kapacitet Ndërzonal, dhe 0 €/MWh, përndryshe. Nëse specifikohet në shtojcat përkatëse rajonale ose kufitare, ky çmim mund të rregullohet për të pasqyruar Kufizimet e Alokimit në ndërlidhjet midis Zonave Ofertuese siç përcaktohet në Rregulloren (BE) 2015/1222, Neni 23, paragrafi 3, ku këto Kufizime të Alokimit përfshihen në Procesi i alokimit të Kapacitetit Ndërzonal të një dite më përpara.
 - (b) në rast të Alokimit Eksplicit të një dite më përpara, të ndryshme nga alokimi i kthimit për Alokimin Implicit për të Drejtat e Transmisionit, çmimi do të jetë çmimi marginal i ankandit ditor në të cilin janë alokuar të Drejtat e Transmisionit, për periudhën përkatëse për orë;
 - (c) në rast të shpërndarjes eksplicite të ditës në vijim nga ndarja e përsëritur për shpërndarjen e nënkuptuar për të drejtat e Transmisionit dhe pa çmim që rezulton nga pika (a) (çmimi i ditës përpara nuk është llogaritur të paktën në një nga dy zonat përkatëse të ofertimit), çmimi do të jetë çmimin marginal të ankandit në të cilin të drejtat e Transmisionit u ndanë në mekanizmin e kthimit të një dite përpara, për periudhën përkatëse të orës; dhe
 - (d) në rast të alokimit të kthimit të Alokimit Implicit ose Alokimit Eksplicit ku nuk llogaritet çmimi referues për periudhën kohore të alokimit ditor, çmimi për kompensimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit do të jetë Çmimi Margjinal i Ankandit fillestar.
2. Kur ka të përcaktuara Detyrime për të Drejtat Financiare të Transmisionit, mbajtësi e këtyre të drejtave është i detyruar që t'i sigurojë Platformës së Vetme të Alokimit kompensim nëse diferenca e çmimeve është negative në drejtim të Detyrimeve për të Drejtat Financiare të Transmisionit. Kompensimi llogaritet si vëllim i Detyrimeve për të Drejtat Financiare të Transmisionit të theksuar në Dokumentin e të Drejtave, dhe do të shumëzohet me një çmim, të llogaritur në përputhje me parimet e paragrafit 1, duke pasur parasysh se diferenca e çmimeve është negative.
3. Platforma e Vetme e Alokimit duhet të kompensojë mbajtësin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit për të Drejtat e panominuara Financiare dhe Fizike të Transmisionit të cilat nuk rialokohen në alokimin përkatës ditor në përputhje me TITULLIN 9 në rast të ngjarjes që është listuar në Nenin 56.

4. Platforma e Vetme e Alokimit duhet të kompensojë mbajtësin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit në përputhje me Nenin 59 (1) germa (a) dhe (b) për të Drejtat e panominuara Financiare dhe Fizike të Transmisionit të cilat nuk rialokohen në alokimin përkatës ditor për të tjera arsye nga ato të referuara në paragrafin 2 të këtij neni.

TITULLI 8

Procedurat alternative/rezervë

Neni 49

Dispozitat e Përgjithshme

1. Platforma e Vetme e Alokimit organizon, për aq sa është praktikisht e arsyeshme, një procedurë rezervë në rastet e mëposhtme të dështimit të një procesi standard:
 - (a) nëse teknikisht nuk është e mundur të mbahet një Ankand pas procesit të përcaktuar në TITULLIN 4;
 - (b) nëse teknikisht nuk është e mundur të regjistrohet kthimi i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit pas procesit të përcaktuar në TITULLIN 5;
 - (c) nëse teknikisht nuk është e mundur të regjistrohet njoftimi për transferimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit pas procesit të përcaktuar në TITULLIN 6; dhe
 - (d) nëse teknikisht nuk është e mundur të regjistrohet njoftimi i një personi të kualifikuar në ndjekjen e procesit siç përcaktohet në TITULLIN 7.
2. Platforma e Vetme e Alokimit mund të përdorë një ose të gjitha procedurat e mëposhtme:
 - (a) aplikimi i një procedure rezervë për shkëmbimin e të dhënave sipas Nenit 50;
 - (b) shtyrja e Ankandit për një datë/kohë të mëvonshme;
 - (c) një tjetër procedurë kthimi *ad hoc* nëse konsiderohet e përshtatshme nga Platforma e Vetme e Alokimit për të kapërcyer çdo pengesë teknike.
3. Platforma e Vetme e Alokimit, për aq sa është praktike dhe pa vonesa të panevojshme, do të informojë Pjesëmarrësit e Regjistruar për devijimet e mundshme nga proceset standarde dhe aplikimi i një procedure kthimi nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqen e saj dhe duke përdorur Mjetin e Ankandit.
4. Pjesëmarrësit e Regjistruar informojnë menjëherë Platformën e Vetme të Alokimit për çdo problem të vërejtur me përdorimin e Mjetit të Ankandit dhe të gjitha pasojat e mundshme nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqen e saj. Në rast të ndonjë problemi urgjent, i cili duhet të zgjidhet menjëherë dhe i cili identifikohet gjatë orarit të punës, Pjesëmarrësi i Regjistruar duhet të kontaktojë menjëherë Platformën e Vetme të Alokimit me telefon, në numrin e telefonit të paraqitur në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit, për këtë lloj problemi.

Neni 50

Procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave

1. Në rast të dështimit në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit të proceseve standarde për shkëmbimin e të dhënave nëpërmjet Mjetit të Ankandit, siç përshkruhet në këto Rregulla të Alokimit, Platforma e Vetme e Alokimit mund të informojë Pjesëmarrësit e Regjistruar se procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave mund të përdoret si në vijim:
 - (a) brenda afateve të zbatueshme, përveçse nëse njoftohet ndryshe nga Platforma e Vetme e Alokimit, Pjesëmarrësi i Regjistruar do t'i kërkojë Platformës së Vetme të Alokimit me mjete elektronike siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqe për të futur të dhënat përkatëse në Mjetin e Ankandit duke përdorur këtë procedurë rezervë për shkëmbimin e të dhënave;
 - (b) me kërkesë, Pjesëmarrësi i Regjistruar do t'i sigurojë Platformës së Vetme të Alokimit në formatin e specifikuar në Rregullat e Sistemit të Informacionit të dhënat përkatëse që do të futen në Mjetin e Ankandit;
 - (c) Platforma e Vetme e Alokimit fut të dhënat e paraqitura në Mjetin e Ankandit;
 - (d) Platforma e Vetme e Alokimit mund të rregulloj në Rregullat e Sistemit të Informacionit një proces identifikimi për Pjesëmarrësin e Regjistruar në momentin kur Pjesëmarrësi i Regjistruar dorëzon të dhënat përkatëse operationale ose tregtare dhe i kërkon Platformës së Vetme të Alokimit që t'i fusë këto të dhëna në Mjetin e Ankandit në emër të tij me anë të procedurës rezervë. Nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar ose personi i autorizuar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar për këtë qëllim nuk e identifikon veten qartë, Platforma e Vetme e Alokimit do të ketë të drejtë të mos kryejë futjen e të dhënave;
 - (e) Pjesëmarrësi i Regjistruar i siguron Platformës së Vetme të Alokimit një numër telefoni, i cili mund të përdoret në rast të komunikimit të nevojshëm;
 - (f) pasi Platforma e Vetme e Alokimit të ketë futur të dhënat e ofruara në Mjetin e Ankandit në emër të Pjesëmarrësit të Regjistruar, Platforma e Vetme e Alokimit do të informojë pa vonesë të panevojshme Pjesëmarrësin e Regjistruar me telefon dhe/ose nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqen e saj; dhe
 - (g) Platforma e Vetme e Alokimit në asnjë rrethanë nuk mban përgjegjësi nëse nuk arrin të kontaktojë Pjesëmarrësin e Regjistruar përmes mjeteve të komunikimit të mësipërme.
2. Në rast të aplikimit të procedurës rezervë për shkëmbimin e të dhënave, i gjithë informacioni i nevojshëm i cili vihet në dispozicion nëpërmjet Mjetit të Ankandit gjatë proceseve standarde mund t'u shpërndahet Pjesëmarrësve të Regjistruar nga Platforma e Vetme e Alokimit me mjete elektronike siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqen e saj ose, kur është e përshtatshme, të publikuar në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit.

Neni 51

Procedurat rezervë për Ankand

1. Shtyrja e Ankandit është procedura e paracaktuar rezervë për Ankandet përpara se të hapet Periudha Ofertuese. Platforma e Vetme e Alokimit mund të shtyjë një Ankand duke njoftuar pjesëmarrësit e regjistruar për kohën e rishikuar të Ankandit të ri.
2. Pas hapjes së Periudhës Ofertuese, Platforma e Vetme e Alokimit:

- (a) kur është praktikisht e arsyeshme, shtynë përfundimin e Periudhës Ofertuese duke i njoftuar Pjesëmarrësit e Regjistruar për afatet e rishikuara në Specifikimin e Ankandit; ose
 - (b) anulon Ankandin fillestar sipas Nenit 52 dhe organizon një Ankand të ri për të njëjtën Periudhë të Produktit.
3. Nëse procedura rezervë e përshkruar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni nuk mund të zbatohet për të njëjtën Periudhë të Produktit, kapacitetet përkatëse ndërzonale ofrohen në procesin e mëposhtëm të alokimit të kapacitetit.
 4. Platforma e Vetme e Alokimit i informon të gjithë Pjesëmarrësit e Regjistruar, pa vonesa të panevojshme, për shtyrjen me njoftim të publikuar në Mjetin e Ankandit dhe/ose në uebfaqen e Platformës së Vetme të Alokimit dhe/ose me mjete elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në faqen e saj të internetit.

Neni 52

Anulimi i Ankandit

1. Në rast se Platforma e Vetme e Alokimit anulon një Ankand, të gjitha ofertat e dorëzuara tashmë, të gjitha kthimet e pranuar tashmë dhe çdo rezultat i Ankandit përkatës konsiderohen të pavlefshme.
2. Platforma e Vetme e Alokimit i informon të gjithë Pjesëmarrësit e Regjistruar pa vonesa të panevojshme, për anulimin e Ankandit nëpërmjet njoftimit të publikuar në Mjetin e Ankandit ose në faqen e internetit të Platformës së Vetme të Alokimit dhe me mjete elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqen e saj.
3. Anulimi i Ankandit mund të shpallet në rastet e mëposhtme:
 - (a) para përfundimit të periudhës së kontestimit në rast se Platforma e Vetme e Alokimit përballlet me pengesa teknike gjatë procesit të Ankandit, si dështimi i proceseve standarde dhe procedurave rezervë në rast të rezultateve të gabuara për shkak të llogaritjes së gabuar të çmimit marginal ose në rast të alokimit të gabuar të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit për Pjesëmarrësit e Regjistruar ose për arsye të ngjashme; dhe
 - (b) pas përfundimit të periudhës së kontestimit, në rast të rezultateve të gabuara për shkak të llogaritjes së gabuar të çmimit marginal ose alokimit të gabuar të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit për Pjesëmarrësit e Regjistruar ose për arsye të ngjashme.
4. Në rast të anulimit të Ankandit përpara se të kalojë periudha e kontestimit, Pjesëmarrësve të Regjistruar nuk u paguhet asnjë kompensim.
5. Platforma e Vetme e Alokimit publikon në uebfaqen e saj të internetit, pa vonesë të panevojshme, arsyet e anulimit të Ankandit.

Neni 53

Procedura rezervë e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

1. Në rast dështimi në procesin standard për regjistrimin e kthimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit nëpërmjet Mjetit të Ankandit siç përcaktohet në TITULLIN 5, Platforma e Vetme e Alokimit mund të zbatojë procedurën rezervë për shkëmbimin e të dhënave në përputhje me Nenin 50.

Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

2. Platforma e Vetme e Alokimit i publikon informacione në lidhje me mundësinë e përdorimit të procedurës rezervë për shkëmbimin e të dhënave në kohën e duhur përpara skadimit të afatit për kthimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit.
3. Në rast se procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave nuk mund të ekzekutohet sipas nevojës për të mundësuar regjistrimin e kthimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit, të gjitha kërkesat për kthimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit të dorëzuara tashmë që nuk mund të regjistrohen në Mjetin e Ankandit anulohen automatikisht.

Neni 54

Procedura rezervë për transferimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

1. Në rast dështimi në procesin standard për regjistrimin e transferimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit të organizuar nëpërmjet Mjetit të Ankandit, siç përcaktohet në TITULLIN 6, Platforma e Vetme e Alokimit mund të aplikojë procedurën rezervë për shkëmbimin e të dhënave në përputhje me Nenin 50.
2. Platforma e Vetme e Alokimit i publikon informacionet në lidhje me mundësinë e përdorimit të procedurës rezervë për shkëmbimin e të dhënave në kohën e duhur përpara skadimit të afatit për transferimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit.
3. Në rast se procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave nuk mund të ekzekutohet sipas nevojës për të mundësuar regjistrimin e transferimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit, të gjitha kërkesat për transferimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit të paraqitura tashmë, dhe të pa konfirmuara nga marrësi, anulohen automatikisht.

Neni 55

Procedura rezervë për njoftimin e personit të kualifikuar

1. Në rast dështimi në procesin standard të njoftimit të personave të kualifikuar në Platformën e Vetme të Alokimit nëpërmjet Mjetit të Ankandit, siç përcaktohet në TITULLIN 6, Platforma e Vetme e Alokimit mund të aplikojë procedurën rezervë për shkëmbimin e të dhënave në përputhje me Nenin 50.
2. Platforma e Vetme e Alokimit i publikon informacionet në lidhje me mundësinë e përdorimit të procedurës rezervë për shkëmbimin e të dhënave në kohën e duhur përpara skadimit të afatit për njoftimin e personave të kualifikuar.
3. Në rast se procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave nuk mund të ekzekutohet sipas nevojës për të mundësuar regjistrimin e personit të kualifikuar, personi i kualifikuar konsiderohet i njoftuar siç përcaktohet në Rregullat e Sistemit të Informacionit.

TITULLI 9
Shkurtimi

Neni 56

Ngjarjet nxitëse dhe pasojat e shkurtimit/kufizimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

1. Të Drejtat Afatgjate të Transmisionit, pa marrë parasysh periudhës së produkteve, mund të shkurtohen/kufizohen në rast të forcës madhore, ose për tu siguruar që operacioni të mbetet

Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

brenda kufijve të sigurisë operationale përpara ditës së afatit të qëndrueshmërisë.

2. Shkurtimi mund të zbatohet për të Drejtat e alokuara Afatgjate të Transmisionit, duke përfshirë, sipas rastit, për të Drejtat e nominuara Fizike të Transmisionit.
3. Të Drejtat Afatgjate të Transmisionit mund të shkurtohen pas afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara në rastin e forcës madhore ose situatave emergjente në përputhje me Nenin 72 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222. Për të shmangur dyshimet, kur shkurtohen të Drejtat Afatgjate të Transmisionit pas ditës së afatit të qëndrueshmërisë të ditës përpara do të shkurtohen në të njëjtën mënyrë si kapaciteti i ditës përpara dhe do të kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Në rastin e të Drejtave Fizike të Transmisionit, secili Pjesëmarrës i Regjistruar i prekur nga shkurtimi e humb të drejtën e tij për të transferuar, kthyer ose nominuar për përdorim fizik të Drejtat Fizike të Transmisionit, ose për t'u kompensuar bazuar në parimim përdore ose shite. Në rastin e të Drejtave Financiare të Transmisionit, secili Pjesëmarrës i Regjistruar i prekur nga shkurtimi humb të drejtën e e transferimit ose kthimit të të Drejtave Financiare përkatëse të Transmisionit ose për t'u kompensuar në përputhje me Nenin 48.
5. Në rastin e shkurtimeve, Pjesëmarrësi i Regjistruar i prekur ka të drejtë në rimbursim ose kompensim sipas Nenit 59 deri në Nenin 60, dhe sipas nevojës, Nenit 61.

Neni 57

Procesi dhe njoftimi për shkurtrimin

1. Në të gjitha rastet, shkurtimi kryhet nga Platforma e Vetme e Alokimit bazuar në kërkesën e një ose më shumë OST-ve në kufirin e Zonës Ofertuese ku janë alokuar të Drejtat Afatgjate të Transmisionit.
2. Platforma e Vetme e Alokimit i njofton bartësit e prekur të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit sa më shpejt që është e mundur për shkurtrimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit, duke përfshirë ngjarjen e shkaktuar nëpërmjet mjeteve elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në uebfaqen e saj dhe në faqen e internetit të Platformës së Vetme të Alokimit. Njoftimi duhet të identifikojë të Drejtat e prekura Afatgjate të Transmisionit, vëllimin e prekur në MW/h për secilën periudhë përkatëse, ngjarjet nxitëse për shkurtrim, siç përshkruhet në paragrafin 3, dhe shumën e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit që mbeten pas shkurtimeve.
3. Përshkrimi i ngjarjes nxitëse përfshin informacionet për kufijtë e saktë të sigurisë operationale që pritet të shkelen në mungesë të shkurtimeve, OST(-të) që kërkojnë shkurtrimin dhe se pse masat alternative nuk janë të mjaftueshme për të shmangur shkeljen e pritshme të kufirit(-jve) të sigurisë operationale. Nëse ky informacion nuk është i disponueshëm në të njëjtën kohë me informacionin e shkurtimeve në lidhje me të Drejtat e prekura Afatgjate të Transmisionit dhe vëllimin e prekur në MW/h për secilën periudhë në fjalë, OST-të duhet të paraqesin një njoftim të parë me informacionet në dispozicion, dhe të përditësojnë informacionet e shkurtimeve, duke përfshirë detajin e kërkuar në lidhje me ngjarjen nxitëse brenda 24 orëve pas njoftimit fillestar.
4. Platforma e Vetme e Alokimit i publikon ngjarjet që shkaktojnë shkurtrimin në përputhje me Nenin 56, duke përfshirë kohëzgjatjen e tyre të parashikuar në faqen e saj të internetit sa më shpejt të jetë e mundur.
5. Shkurtimi zbatohet për të Drejtat Afatgjate të Transmisionit të periudhave përkatëse në mënyrë proporcionale, që do të thotë në përpjesëtim me të Drejtat e mbajtura Afatgjate të Transmisionit, pavarësisht nga koha e alokimit.
6. Në rast të shkurtimeve të të Drejtave Fizike të Transmisionit pas afatit të nominimit, dhe për sa kohë që kapaciteti nuk është rialokuar në alokimin e ditës përpara, shkurtimi zbatohet në

mënyrë proporcionale për të Drejtat Fizike të Transmisionit të nominuara ashtu edhe për ato të panominuara.

7. Rregullat e kompensimit sipas Neneve 59 dhe 60, dhe sipas nevojës, edhe Nenit 61 zbatohen nëse kapacitetet e ofruara ndërzonale të ditës përpara janë më të ulëta se shuma e të Drejtave të panominuara Afatgjate të Transmisionit në rastin e të Drejtave Fizike të Transmisionit dhe shuma totale e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit në rastin e të Drejtave Financiare të Transmisionit.
8. Për secilin Pjesëmarrës të Regjistruar të prekur, të Drejtat e mbetura Afatgjate të Transmisionit të cilat nuk janë shkurtuar duhet të rrumbullakohen në MW më të afërt. I njëjti rrumbullakim vlen edhe për shkurtimin e të Drejtave Fizike të Transmisionit të nominuara dhe të panominuara sipas paragrafit 4 të këtij neni.
9. Në rastet e shkurtimit, çdo transferim i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit që do të shkurtohen, që ende nuk është pranuar nga transferuesi, anulohet automatikisht dhe transferuesi mbetet mbajtësi i të Drejtave Afatgjate të Transmisionit. Nëse transferimi është njoftuar tashmë në Platformën e Vetme të Alokimit, dhe është pranuar nga marrësi, marrësit i paguhet kompensimi ose rimbursimi për të Drejtat eshkurtoara Afatgja të Transmisionit.
10. Platforma e Vetme e Alokimit anulon të gjitha njoftimet për kthimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit që janë pranuar për një ankand të mëvonshëm afatgjatë, për të cilin është i nevojshëm shkurtimi, dhe për të cilin specifikimet përfundimtare të ankandit nuk janë publikuar ende. Me këtë anulim, të Drejtat Afatgjate të Transmisionit u kthehen mbajtësve të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit që kanë kërkuar kthimin. Nëse specifikimi përfundimtar i ankandit është publikuar tashmë, kthimi nuk anulohet, ndërsa kompensimi ose rimbursimi për të Drejtat e shkurtuara Afatgjate të Transmisionit i paguhet mbajtësit që ka kthyer të Drejtat Afatgjate të Transmisionit.

Neni 58

Afati i qëndrueshmërisë së një dite përpara

Platforma e Vetme e Alokimit publikon në faqen e saj të internetit dhe merr parasysh për llogaritjen e kompensimit për të Drejtat e shkurtuara Afatgjate të Transmisionit në afatin e qëndrueshmërisë së një dite përpara siç specifikohet në propozimin në përputhje me Nenin 69 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të miratuar në përputhje me Nenin 9 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222.

Neni 59

Kompensimi për shkurtimet për të siguruar që operimi të mbetet brenda kufijve të sigurisë operationale përpara afatit të qëndrueshmërisë së një dite përpara

1. Në rastet e shkurtimit për të siguruar që operimi të mbetet brenda kufijve të sigurisë operationale përpara Afatit të qëndrueshmërisë së një dite përpara, kompensimi për secilën orë të prekur dhe secilin Pjesëmarrës të Regjistruar do të llogaritet si e Drejtë Afatgjate e Transmisionit në MW/h, që korrespondon me diferencën midis të Drejtave Afatgjate të Transmisionit të alokuara nga Pjesëmarrësi i Regjistruar para dhe pas shkurtimit, shumëzuar me një çmim të llogaritur si më poshtë:
 - (a) shtrirja e tregut në kufirin e zonës përkatëse ofertuese vetëm për periudhën përkatëse në orë, në rast se diferenca e çmimit është pozitive në drejtim të shkurtimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit, dhe 0 €/MWh, përndryshe. Nëse specifikohet në shtojcat përkatëse të këtyre rregullave të alokimit, ky çmim mund të rregullohet për të pasqyruar kufizimet e alokimit në ndërlidhjet midis Zonave Ofertuese siç përcaktohet në Nenin 23, paragrafin 3 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, nëse këto kufizime të alokimit përfshihen në procesin e alokimit të kapacitetit ndërzonale të një dite përpara. Drejtimi i të Drejtave të shkurtuara Afatgjate të

Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

Transmisionit përcaktohet nga destinacioni dhe zonat ofertuese të origjinës, siç përcaktohet në specifikimet e ankandit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit në fjalë; ose

- (b) nëse çmimi i një dite përpara nuk llogaritet të paktën në njërin prej dy zonave përkatëse ofertuese, çmimi do të jetë çmimi marginal i ankandit në të cilin të Drejtat e Transmisionit janë alokuar në mekanizmin e kthimit të ditës përpara, për periudhën përkatëse për orë; ose
- (c) çmimi marginal i ankandit fillestar nëse nuk ka dalë çmim nga llogaritja sipas pikës (a) dhe (b).
2. Nëse specifikohet në shtojcat përkatëse të këtyre Rregullave të Alokimit, kufiri zbatohet për kompensimet në kufijtë e zonës specifike ofertuese. Kufiri përcaktohet si shuma totale e të ardhurave nga mbingarkesa e mbledhur nga OST-të përkatëse në kufirin përkatës të zonës ofertuese në vitin përkatës kalendarik, duke zbritur të gjitha shpërblimet e paguara sipas Neneve 40 dhe 48, dhe kompensimet e paguara sipas Nenit 60 dhe, aty ku është e zbatueshme, Nenit 61. Kufiri llogaritet sipas formulës:

$$\begin{aligned} & \text{Cap for compensation for network security} \\ & = (\text{Long term income} + \text{Daily income} + \text{Intraday income}) \\ & - (\text{UIOSI} + \text{Remuneration of FTRs} + \text{Return of LTTRs} \\ & + \text{Compensation for curtailment for emergency situation} \\ & + \text{Compensation for curtailment for force majeure}) \end{aligned}$$

3. Në rast të interkonektorëve të rrymës njëkahore, kufiri përcaktohet si shuma totale e të ardhurave nga ngarkesat e mbledhura nga OST-të përkatëse në kufirin e zonës ofertuese në muajin përkatës, duke zbritur të gjitha shpërblimet e paguara sipas Nenit 40 dhe Nenit 48, dhe kompensimet e paguara sipas Nenit 60 dhe, aty ku është e zbatueshme, Nenit 61 për muajin e shqyrtuar. Shuma totale e të ardhurave nga ngarkesat në një muaj përcaktohet si shuma e një të dymbëdhjetës së të ardhurave të mbledhura në ankand vjetor në kufirin përkatës të zonës ofertuese dhe të ardhurat e gjeneruara nga ankandi mujor dhe të ardhurat e ngarkesës nga periudha të tjera kohore që kanë ndodhur gjatë këtij muaji në kufirin e Zonës përkatëse Ofertuese. Kufiri llogaritet sipas formulës:

Cap for compensation for network security in case of Direct Current interconnectors

$$\begin{aligned} & = \left(\frac{\text{Yearly income}}{12} + \frac{\text{Seasonal income}}{6} + \frac{\text{Quarterly income}}{3} \right. \\ & \quad + \text{Any other long term income} + \text{Daily income} + \text{Intraday income} \\ & \quad \left. \text{income} \right) \\ & - (\text{UIOSI} + \text{Remuneration of FTRs} + \text{Return of LTTRs} \\ & + \text{Compensation for curtailment for emergency situation} \\ & + \text{Compensation for curtailment for force majeure}) \end{aligned}$$

4. Nëse, para aplikimit të kufirit përkatës të përshkruar në paragrafin 2 ose paragrafin 3 të këtij neni, kompensimet totale të llogaritura të të Drejtave të shkurtuara Afatgjate të Transmisionit tejkalojnë kufirin përkatës, kompensimet e të Drejtave të shkurtuara Afatgjate të Transmisionit do të reduktohen në mënyrë proporcionale. Kjo duhet të bazohet në përqindjen e kompensimit të pa kufizuar të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit të alokuara për secilin Pjesëmarrës të Regjistruar në periudhën përkatëse (muaj kalendarik ose vit kalendarik). Kompensimet për secilin Pjesëmarrës të Regjistruar do të llogariten si më poshtë:

$$\begin{aligned} & [(\text{Kompensimet e pakufizuara të të Drejtave të shkurtuara Afatgjate të Transmisionit për} \\ & \quad \text{shkak të Pjesëmarrësit të Regjistruar}) / (\text{Kompensimet totale të pakufizuara të të Drejtave} \\ & \quad \text{Afatgjate të Transmisionit të kufizuar për të gjithë Pjesëmarrësit e Regjistruar})] \times \\ & \quad (\text{Kufiri përkatës siç përshkruhet në paragrafin 2 dhe paragrafin 3 të këtij neni}) \end{aligned}$$

Rimbursimi për shkurtimet për shkak të Forcës Madhore përpara afatit të qëndrueshmërisë së një dite përpara

1. Në rastin e Forcës Madhore përpara afatit të qëndrueshmërisë së një dite përpara, mbajtësit e të Drejtave të shkurtuara Afatgjate të Transmisionit do të kenë të drejtë në rimbursim të barabartë me çmimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit të vendosura gjatë procesit të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit, i cili për çdo orë të prekur dhe pjesëmarrës të regjistruar do të llogariten si:
 - (a) çmimi marginal i ankandit fillestar; ose
 - (b) në rast se çmimi marginal i ankandit fillestar nuk mund të identifikohet, mesatarja e ponderuar e çmimeve marginale të të gjitha ankandeve për të cilat Pjesëmarrësi i Regjistruar ka të Drejtat Afatgjate të Transmisionit, ku pesha jepet nga të Drejtat Afatgjate të Transmisionit, të cilat Pjesëmarrësi i Regjistruar i mban përpara shkurtimit; shumëzuar me
 - (c) vëllimi në MW/h që korrespondon me diferencën midis të Drejtave Afatgjate të Transmisionit të mbajtura nga Pjesëmarrësi i Regjistruar para dhe pas shkurtimit.

Neni 61

Rimbursimi ose kompensimi për shkurtimet për shkak të Forcës Madhore ose situatës emergjente pas afatit të qëndrueshmërisë së një dite përpara

Në rast të Forcës Madhore ose situatave emergjente pas afatit të qëndrueshmërisë së një dite përpara, mbajtësit e të Drejtave të shkurtuara Afatgjate të Transmisionit kanë të drejtë në rimbursim në përputhje me Nenin 72 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222.

TITULLI 10

Faturimi dhe pagesa

Neni 62

Parimet e Përgjithshme

1. Pjesëmarrësi i Regjistruar paguan shumat e detyruara, të llogaritura në përputhje me Nenin 63, për të gjitha të Drejtat Afatgjate të Transmisionit që i janë alokuar atij. Ky detyrim duhet të përmbushet pa marrë parasysh kthimin ose transferimin ose shkurtimin e të gjitha ose disa prej këtyre të Drejtave Afatgjate të Transmisionit në përputhje me këto Rregulla Alokimi.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar, pas pagesës, mund të përdorë Kapacitetin Ndërzonal të lidhur me të Drejtat ditore të transmisionit të alokuara, vetë siç përshkruhet në këto Rregulla të Alokimit. Çdo e drejtë për përdorim fizik të sistemit të transmisionit mund t'i nënshtrohet marrëveshjeve të veçanta ndërmjet Pjesëmarrësit të Regjistruar dhe Operatorëve përkatës të Sistemit të Transmisionit.
3. Të gjitha informacionet financiare, çmimet dhe shumat e detyruara shprehen në euro (€), përveç nëse devijimet kërkohen me ligjin ose rregulloret në fuqi.
4. Pagesa shlyhet në datën në të cilën shuma e dhënë është kredituar në llogarinë e përfituesit. Çdo interes për pagesë të vonuar konsiderohet si i shlyer në datën kur pagesa është kredituar nga llogaria e paguesit.
5. Pagesat bëhen në Euro (€).

6. Platforma e Vetme e Alokimit merr në konsideratë taksat dhe ngarkesat në normën dhe në masën e zbatueshme kur vlerëson obligimet për pagesa dhe lëshon faturat sipas këtyre Rregullave të Alokimit që i nënshtrohen Nenit 64.
7. Pjesëmarrësi i Regjistruar i ofron Platformës së Vetme të Alokimit informacionin përkatës për të arsyetuar nëse taksat dhe ngarkesat përkatëse janë ose jo të zbatueshme gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, si dhe çdo ndryshim në këtë drejtim pa vonesa të panevojshme. Prandaj, Pjesëmarrësi i Regjistruar obligohet të informojë Platformën e Vetme të Alokimit për çdo taksë dhe ngarkesë lokale, brenda komunitetit ose jashtë komunitetit që është në përputhje me legjislacionin e vendit të themelimit të Pjesëmarrësit të Regjistruar.
8. Kur ekzistojnë detyrimet e të Drejtave Financiare të Transmisionit, Platforma e Vetme e Alokimit llogaritë përmes shtëpisë së kliringut shumat që do të kompensohen dhe do të merren nga mbajtësit e këtyre të Drejtave Afatgjate të Transmisionit. Të gjitha kostot e bëra nga Platforma e Vetme e Alokimit të lidhura me kliringun e detyrimeve të të Drejtave Financiare të Transmisionit u faturohen mbajtësve të këtyre të Drejtave Afatgjate të Transmisionit.

Neni 63

Llogaritja e shumave të detyruara

1. Pjesëmarrësit e Regjistruar paguajnë për secilën nga të Drejtat Afatgjate të Transmisionit që u alokohen atyre një shumë të barabartë me:
 - (a) Çmimin marginal (në MW/h); shumëzuar me
 - (b) Shumën e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit në MW të alokuara në orë individuale të periudhës së produktit, duke përfshirë çdo periudhë reduktimi, nëse është e përshtatshme, në përputhje me Nenin 35.
2. Shuma e detyrimit plus çdo tatim dhe ngarkesë, detyrime ose tarifa të tjera të zbatueshme që i nënshtrohen Nenit 64 rumbullakohen në dy numra pas presjes dhjetore.
3. Platforma e Vetme e Alokimit llogaritë pagesat e detyrueshme në këste mujore kur produkti i kapacitetit ndërzonat ka kohëzgjatje më shumë se një muaj.
4. Këstet mujore janë të barabarta për çdo muaj dhe përcaktohen duke pjesëtuar shumën e detyrimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni me kohëzgjatjen e produkteve të kapacitetit ndërzonat të shprehur në muaj, dhe të rumbullakuara në dy numra pas presjes dhjetore. Kësti i fundit duhet të përfshijë edhe bilancin për shkak të rumbullakimit të aplikuar në këstet e tjera mujore.
5. Nëse data e parë e pagesës së produktit të kapacitetit ndërzonat me kohëzgjatje prej më shumë se një (1) muaj ndodh pas fillimit të periudhës së produktit, atëherë pagesa e parë duhet të përfshijë dy (2) këste mujore.

Neni 64

Rritja e shumës për të fituar shumën bruto për qëllime tatimi

1. Çdo Pjesëmarrës i Regjistruar duhet t'i bëjë të gjitha pagesat në lidhje me Rregullat e Alokimit pa ndonjë zbritje tatimore, përveç nëse zbritja tatimore kërkohet me ligj.
2. Nëse me ligj kërkohet që zbritja tatimore të bëhet nga një Pjesëmarrës i Regjistruar, shuma e pagesës së detyruar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar për Platformën e Vetme të Alokimit rritet në një shumë e cila (pas kryerjes së zbritjes tatimore) e lë një shumë të barabartë me shumën e pagesës e cila do të ishte e detyruar nëse nuk do të kërkohet zbritja tatimore.

Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

3. Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet në lidhje me ndonjë tatim të vlerësuar në Platformën e Vetme të Alokimit për çdo pagesë të pranuar në lidhje me Rregullat e Alokimit sipas ligjeve të juridiksionit në të cilin është themeluar Platforma e Vetme e Alokimit ose, nëse është e ndryshme, juridiksionit (ose juridiksioneve) në të cilat Platforma e Vetme e Alokimit trajtohet si rezidente për qëllime tatimore ose ka apo konsiderohet të ketë për qëllime tatimore një seli të përhershme ose një vend fiks biznesi të cilit i atribuohet çdo pagesë sipas Rregullave të Alokimit. Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet për tatimin mbi vlerën e shtuar (siç parashikohet në Direktivën 2006/112/EC për TVSH-në ose, sipas rastit, çdo legjislacioni i ngjashëm kombëtar, i ndryshuar herë pas here) dhe çdo tatim tjetër të një natyre të ngjashme.

Neni 65

Kushtet e faturimit dhe pagesës

1. Pagesat duhet të shlyhen para fillimit të Periudhës së Produktit, nëse afati kohor i Ankandit e lejon këtë. Nëse produkti i kapacitetit ndërzonal ka kohëzgjatje prej më shumë se një (1) muaj, çdo këst mujor duhet të shlyhet përpara fillimit të secilit muaj përkatës, nëse afati kohor i Ankandit e lejon këtë. Nëse shlyerja e një shume të caktuar për të Drejtat e alokuara Afatgjate të Transmisionit nuk është e mundur para fillimit të periudhës së produktit, atëherë pagesa do të shlyhet në datën e ardhshme fikse të faturës.
2. Platforma e Vetme e Alokimit lëshon fatura për pagesa për të gjitha të Drejtat Afatgjate të Transmisionit në baza mujore dhe jo më vonë se Dita e Dhjetë (10) e Punës e secilit muaj.
3. Faturat lëshohen për pagesat e mëposhtme:
 - (a) shuma e këstit(-eve) mujore nëse të Drejtat Afatgjate të Transmisionit kanë një kohëzgjatje prej më shumë se një muaji, siç përcaktohet në Nenin 63(4) dhe (5);
 - (b) shuma e detyruar për pagesë e përcaktuar në Nenin 63(2) nëse e Dejta Afatgjate e Transmisionit ka një kohëzgjatje të barabartë me një muaj ose më pak;
 - (c) nëse kërkohet nga Pjesëmarrësi i Regjistruar, shumat për pagesën e paradhënies të kësteve mujore të cilat përndryshe do të shlyheshin me faturat e mëvonshme; dhe
 - (d) çfarëdo tatimi dhe ngarkese përkatëse që i nënshtrohet Nenit 64.
4. Platforma e Vetme e Alokimit dërgon faturën përmes mjeteve elektronike siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Vetme të Alokimit tek Pjesëmarrësi i Regjistruar në adresën e postës elektronike të personit të kontaktit financiar të paraqitur në përputhje me Nenin 9(i) ose duhet ta vëjë atë në dispozicion për Pjesëmarrësit e Regjistruar nëpërmjet Mjetit të Ankandit. Data e lëshimit të faturës duhet të jetë data në të cilën fatura është dërguar me mjete elektronike siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Vetme të Alokimit ose data kur fatura është vënë në dispozicion nëpërmjet Mjetit të Ankandit, nëse kjo bëhet gjatë orarit të punës ose ditën tjetër të punës nëse dërgohet pas orarit të punës.
5. Në rastet e shkurtimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit, kthimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit sipas Nenit 40 ose kompensimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit sipas Nenit 48, faturat duhet të marrin parasysh çdo pagesë që do t'i kreditohet Pjesëmarrësit të Regjistruar. Pagesat që do t'u kreditohen Pjesëmarrësve të Regjistruar duhet:
 - (a) të shlyhen përmes mekanizmit të vetëfaturimit, që do të lejojë Platformën e Vetme të Alokimit të lëshojë fatura në emër të dhe për Pjesëmarrësit e Regjistruar; dhe
 - (b) të njoftohet përmes faturës së njëjtë, si ajo e përdorur për pagesat e Pjesëmarrësit të Regjistruar, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.
6. Nëse kompensimet i detyrohen Pjesëmarrësit të Regjistruar në lidhje me shkurtimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit dhe i nënshtrohen një kufiri të përcaktuar në Nenin 59(2),

Rregullat e harmonizuara të alokimit të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

këto kompensime do të shlyhen me faturën e parë që do të lëshohet pas përfundimit të periudhës përkatëse të muajit dhe i nënshtrohet një kufiri të përcaktuar si shuma e përgjithshme e të ardhurave nga ngarkesa e mbledhur nga OST-të përkatëse në kufirin e Zonës Ofertuese në muajin përkatës, duke zbritur të gjitha detyrimet e paguara sipas Nenit 40 dhe Nenit 48, dhe kompensimet e paguara sipas Nenit 60 dhe, aty ku është e zbatueshme, Nenit 61 për muajin në fjalë. Shuma totale e të ardhurave nga ngarkesa në një muaj përcaktohet si shuma e një të dymbëdhjetës pjesë të të ardhurave të mbledhura në ankandin vjetor në kufirin përkatës të Zonës Ofertuese dhe të ardhurat e gjeneruara nga ankandet mujore dhe të ardhurat e ngarkesës nga periudha të tjera kohore që kanë ndodhur gjatë këtij muaji në kufirin përkatës të Zonës Ofertuese.

7. Një faturë do të lëshohet pas përfundimit të periudhës përkatëse mbi të cilën llogariten kufijtë e kompensimit në përputhje me Nenin 59(2), duke përmbushur çdo mospërputhje midis kompensimeve të paguara në baza mujore dhe kompensimeve që kërkohen të paguhet në përputhje me Nenin 59(2). Në rast mospërmbushjeje nga një pjesëmarrës në treg, rikthimi i kostos së OST-së do të sigurohet nga autoritetet rregullatore përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Pagesat e detyrueshme duhet të netohen nga Platforma e Vetme e Alokimit duke marrë parasysh shumën e përcaktuar në paragrafin 3 dhe 5 të këtij neni.
9. Nëse bilanci i pagesave të përcaktuara në paragrafin 3 dhe 5 të këtij neni rezulton në një pagesë neto nga Pjesëmarrësi i Regjistruar në Platformën e Vetme të Alokimit, Pjesëmarrësi i Regjistruar do ta shlyejë këtë bilanc brenda pesë (5) ditëve të punës pas datës së lëshimit të faturës.
10. Pagesat nga Pjesëmarrësi i Regjistruar sipas paragrafit 7 të këtij neni do të mblidhen si në vijim:
 - (a) bazuar në procedurën standarde, Platforma e Vetme e Alokimit do të mbledhë automatikisht pagesën nga llogaria e dedikuar e biznesit të Pjesëmarrësit të Regjistruar në datën përkatëse të pagesës së faturës; ose
 - (b) përndryshe, Pjesëmarrësi i Regjistruar do të sigurojë pagesën përmes një transaksioni jo të automatizuar në llogarinë e Platformës së Vetme të Alokimit të specifikuar në faturë duke treguar referencën e faturës.
11. Procedura alternative mund të përdoret me kërkesë të Pjesëmarrësit të Regjistruar dhe me pëlqimin e Platformës së Vetme të Alokimit. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të njoftojë Platformën e Vetme të Alokimit me mjete elektronike siç specifikohet në faqen internetit të Platformës së Vetme të Alokimit kërkesën për të përdorur procedurën alternative të paktën dy (2) ditë pune para datës së lëshimit të faturës së radhës siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni. Pasi që të dakordohet procedura alternative, ajo do të konsiderohet e vlefshme derisa të bien dakord ndryshe Pjesëmarrësit e Regjistruar dhe Platforma e Vetme e Alokimit.
12. Nëse bilanci i pagesave siç përcaktohet në paragrafin 3 dhe 5 të këtij neni rezulton në një pagesë neto nga Platforma e Vetme e Alokimit për Pjesëmarrësin e Regjistruar, Platforma e Vetme e Alokimit do ta paguajë këtë bilanc brenda shtatë (7) ditëve të punës pas datës së lëshimit të faturës në llogarinë bankare siç është shpallur gjatë procesit të pranimit në përputhje me 0 paragrafin 1(h) nga Pjesëmarrësi i Regjistruar i cili ka të drejtë për pagesat në datën e caktuar.
13. Pas mbledhjes së pagesës siç parashihet në paragrafin 8 të këtij neni, Platforma e Vetme e Alokimit do të përditësojë limitin e kredisë në përputhje me rrethanat.
14. Në rast të një fature të gabuar e cila rezulton në pagesë shtesë të Platformës së Vetme të Alokimit ose Pjesëmarrësit të Regjistruar, Platforma e Vetme e Alokimit do të korrigjojë faturën dhe çdo shumë e caktuar do të shlyhet sapo të jenë njoftuar Pjesëmarrësit të

15. Tarifat bankare të bankës së paguesit mbulohen nga paguesi. Tarifat bankare të bankës pranuese mbulohen nga përfituesi. Tarifat bankare të çdo banke ndërmjetëse mbulohen nga Pjesëmarrësi i Regjistruar.
16. Pjesëmarrësi i Regjistruar nuk ka të drejtë të kompensojë asnjë shumë, ose të mbajë në burim ndonjë borxh që lind në lidhje me detyrimet që rezultojnë nga një ankand, kundrejt çdo pretendimi ndaj Platformës së Vetme të Alokimit, pavarësisht nëse lindin apo jo nga një Ankand. Megjithatë, e drejta për kompensim dhe e drejta për të mbajtur në burim nuk përjashtohen në rast se pretendimi i Pjesëmarrësit të Regjistruar ndaj Platformës së Vetme të Alokimit përcaktohet nga një vendim ligjërishit i detyrueshëm ose është i pakontestueshëm.

Neni 66

Mosmarrëveshjet rreth pagesave

1. Pjesëmarrësi i Regjistruar mund të kundërshtojë shumën e një fature, duke përfshirë çdo shumë që duhet t'i kreditohet Pjesëmarrësit të Regjistruar. Në këtë rast, Pjesëmarrësi i Regjistruar do të njoftojë natyrën e mosmarrëveshjes dhe shumën e mosmarrëveshjes në Platformën e Vetme të Alokimit sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas datës së lëshimit të faturës ose notës së kreditit me postë të regjistruar dhe mjete elektronike siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Vetme të Alokimit. Përtej kësaj periudhe, fatura do të konsiderohet se është pranuar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar.
2. Nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar dhe Platforma e Vetme e Alokimit nuk janë në gjendje të zgjidhin dallimin brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas njoftimit, do të zbatohet procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në përputhje me Nenin 70.
3. Një mosmarrëveshje në asnjë mënyrë nuk e liron Palën nga detyrimi për të paguar shumat për pagesë siç përcaktohet në Nenin 65.
4. Nëse është rënë dakord ose përcaktohet në bazë të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve siç parashikohet në Nenin 70 që një shumë e paguar ose e pranuar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar nuk është paguar siç duhet, do të zbatohet procesi i mëposhtëm:
 - (a) Platforma e Vetme e Alokimit do t'i rimbursojë Pjesëmarrësit e Regjistruar çdo shumë, duke përfshirë interesin që do të llogaritet sipas Nenit 62(4) në rast se shuma e paguar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar, siç përcaktohet në Nenin 65(3) dhe (6), ka qenë më e lartë ose shuma e paguar nga Platforma e Vetme e Alokimit ka qenë më e ulët se shuma për pagesë. Platforma e Vetme e Alokimit do të bëjë pagesën në llogarinë bankare të treguar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar për këtë rimbursim në përputhje me 0 paragrafin 1 (h).
 - (b) Pjesëmarrësi i Regjistruar do të paguajë çdo shumë, duke përfshirë interesin që do të llogaritet sipas Nenit 62(4), në Platformën e Vetme të Alokimit në rast se shuma e paguar nga pala e regjistruar, siç përcaktohet në Nenin 65(3) dhe (6), ka qenë më e ulët ose shuma e paguar nga Platforma e Vetme e Alokimit ka qenë më e lartë se shuma e duhur. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të bëjë pagesën në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 65(8). Pas një pagese të tillë, Platforma e Vetme e Alokimit do të përditësojë limitin e kredisë së Pjesëmarrësit të Regjistruar siç përcaktohet në Nenin 65(10).
5. Interesi i paguar në rast të pagesës në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni do të aplikohet nga dita e parë (1) pas datës në të cilën pagesa duhej paguar deri në datën në të cilën është rimbursuar shuma e kontestuar dhe do të zbatohet gjithashtu për të gjitha tatimet dhe ngarkesat e kërkuara me ligj.

Pagesa e vonuar dhe incidenti i pagesës

1. Në rast se Pjesëmarrësi i Regjistruar nuk e ka paguar plotësisht një faturë deri në datën e specifikuar në faturë, Platforma e Vetme e Alokimit e njofton Pjesëmarrësin e Regjistruar se do të regjistrohet një incident pagese nëse shuma që përfshin interesin e aplikueshëm nuk merret brenda tre (3) ditëve të punës pas dërgimit të njoftimit. Në rast të mospagesës brenda afatit, Platforma e Vetme e Alokimit e njofton Pjesëmarrësin e Regjistruar se incidenti i pagesës është regjistruar.
2. Menjëherë pas regjistrimit të incidentit të pagesës, Platforma e Vetme e Alokimit mund të thirrë kolateralet.
3. Platforma e Vetme e Alokimit mund të pezullojë ose ndërprejë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në rast të incidentit të regjistruar të pagesës në përputhje me Nenet 71 dhe 72.
4. Në rast të pagesës ose rimbursimit të vonuar, Palët paguajnë interes mbi shumën e detyruar, duke përfshirë taksat dhe ngarkesat nga dita e parë (1) pas datës në të cilën pagesa duhej të kryhej deri në datën në të cilën është kryer pagesa. Interesi është i barabartë me cilëndo që është më e larta prej shumave në vijim:
 - (a) një tarifë të sheshtë prej 100 €; ose
 - (b) në përputhje me Nenin 5 të Direktivës 2011/7/BE, tetë (8) pikë përqindje në vit mbi normën e interesit të referencës siç publikohet zyrtarisht nga autoritetet kombëtare të vendit në të cilin ndodhet Platforma e Vetme e Alokimit dhe rumbullakohet deri në gjysëm pikë përqindjen më të afërt.

TITULLI 11

Të ndryshme

Neni 68

Kohëzgjatja dhe ndryshimi i rregullave të alokimit

1. Rregullat e alokimit janë me kohëzgjatje të pacaktuar dhe i nënshtrohet ndryshimit në përputhje me nenin 4, paragrafi 12 të Rregullores së FCA. Platforma e vetme e alokimit do të publikojë rregullat e ndryshuara të alokimit dhe do t'u dërgojë një njoftim ndryshimi pjesëmarrësve të regjistruar.
2. Ndryshimi hyn në fuqi në datën dhe kohën e specifikuar në njoftimin e ndryshimit, por jo më herët se tridhjetë (30) ditë kalendrike pasi njoftimi i ndryshimit t'u dërgohet pjesëmarrësve të regjistruar nga platforma e vetme e alokimit.
3. Përveç nëse përcaktohet shprehimisht ndryshe nga platforma e vetme e alokimit, rregullat e ndryshuara të alokimit do të rregullojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me këto rregulla të alokimit, duke përfshirë ato të fituara përpara datës së ndryshimit, por me datën e dorëzimit pas hyrjes në fuqi të ndryshimit. Në rast se të drejtat financiare të transmisionit prezantohen në kufirin përkatës të zonës së ofertimit duke zëvendësuar të drejtat fizike të transmisionit, mund të prezantohen aranzhime kalimtare në një shtojcë specifike rajonale ose kufitare në lidhje me kthimin e të drejtave fizike të transmisionit tashmë të fituara sipas Titullit 5 dhe në lidhje me të drejtën për të nominuar këto të drejta fizike të transmisionit sipas Titullit 7 pasi të hyj në fuqi ndryshimi.
4. Çdo ndryshim i këtyre rregullave të alokimit do të zbatohet automatikisht për marrëveshjen e pjesëmarrjes në fuqi ndërmjet platformës së vetme të alokimit dhe pjesëmarrësit të regjistruar, pa qenë nevoja që pjesëmarrësi i regjistruar të nënshkruajë një marrëveshje të re pjesëmarrjeje, por pa cenuar të drejtën e pjesëmarrësit të regjistruar për të kërkuar ndërprerjen e marrëveshjes së tij të pjesëmarrjes në përputhje me nenin 72(1). Duke marrë pjesë në ankand pasi pjesëmarrësi i regjistruar është informuar për ndryshimet dhe/ose përshtatjet e rregullave të alokimit dhe pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve dhe/ose përshtatjeve të rregullave të alokimit, konsiderohet se pjesëmarrësi i regjistruar ka pranuar versionin e ndryshuar, pra versionin e vlefshëm dhe efektiv të rregullave të alokimit.
5. Rregullat e alokimit dhe shtojcat specifike kufitare dhe/ose rajonale të përfshira në to do të rishikohen periodikisht nga platforma e vetme e alokimit dhe OST-të përkatëse të paktën çdo dy vjet që përfshijnë pjesëmarrësit e regjistruar. Ky rishikim dyvjeçar nuk cenon kompetencën e ACER për të kërkuar në çdo kohë ndryshime të rregullave të alokimit dhe kompetencën e autoriteteve rregullatore përkatëse për të kërkuar në çdo kohë ndryshime të shtojcave të përfshira në rregullat e alokimit, në përputhje me legjislacionin ekzistues.
6. Këto rregulla alokimi i nënshtrohen legjislacionit që mbizotëron në kohën kur ato hyjnë në fuqi. Në rast se ka një ndryshim në legjislacion ose ndonjë veprim nga autoritetet kompetente në nivel kombëtar ose të Bashkimit Evropian që ka një efekt në këto rregulla të alokimit dhe/ose shtojcat e tyre, atëherë, pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të këtyre rregullave të alokimit, rregullat e alokimit do të të ndryshohen në përputhje me rrethanat dhe në përputhje me nenin 4, paragrafi 12 i Rregullores së FCA.

Neni 69

Përgjegjësia

Rregullat e harmonizuara të alokimit të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

1. Platforma e vetme e alokimit dhe pjesëmarrësit e regjistruar janë të vetmit përgjegjës për përmbushjen e çdo detyrimi që ata marrin përsipër ose i nënshtrohen dhe që rrjedhin nga ose është në lidhje me rregullat e alokimit dhe marrëveshjen e pjesëmarrjes.
2. Në varësi të çdo dispozite tjetër të këtyre rregullave të alokimit, platforma e vetme e alokimit do të jetë përgjegjëse vetëm për dëmet e shkaktuara nga:
 - (a) mashtrimi, neglizhenca e rëndë ose sjellja e pahijshme me dashje.
 - (b) vdekja ose lëndimi personal që vjen nga neglizhenca e saj ose e punëtorëve, agjentëve ose nënkontraktorëve të saj.
3. Një Pjesëmarrës i Regjistruar dëmshpërblen dhe mban të dëmshpërblyer Platformën e Alokimit dhe zyrtarët e saj, punonjësit dhe agjentët për dhe kundër çdo humbjeje ose përgjegjësie (përfshirë kostot ligjore) në lidhje me një dëm që ai ka shkaktuar, të cilin cilido prej tyre mund të pësojë ose shkaktojë për shkak të ndonjë pretendimi nga ndonjë palë e tretë për shkak të ndonjë humbjeje (qoftë direkte apo indirekte) të pësuar nga pretenduesi ose ndonjë nga zyrtarët, agjentët, nënkontraktorët ose punonjësit e pretenduesit në lidhje me këto Rregulla të Alokimit.
4. Platforma e Vetme të Alokimit dhe çdo pjesëmarrës i regjistruar e pranon dhe pajtohet që përfitimin nga paragrafi 3 i këtij neni e mban për vete dhe si administrues i besuar dhe agjent për zyrtarët, punonjësit dhe agjentët e saj.
5. Pjesëmarrësi i regjistruar është i vetëm përgjegjës për pjesëmarrjen e tij në ankande duke përfshirë, por pa u kufizuar në rastet e mëposhtme:
 - (a) mbërritja në kohë e Ofertave dhe njoftimeve të transferimit dhe kthimit nga Pjesëmarrësi i regjistruar;
 - (b) dështimi teknik i sistemit të informacionit në anën e Pjesëmarrësit të Regjistruar që pengon komunikimin përmes kanaleve të parashikuara në përputhje me këto Rregulla të Alokimit.
6. Në rast shpërblimi në përputhje me nenin 48 ose kompensimit të shkurtimit për shkak të Forcës madhore ose për të siguruar që operimi të mbetet brenda Kufijve të Sigurisë Operacionale ose në Situata Emergjente në përputhje me nenin 59 dhe nenin 60 dhe nenin 61 ose në përputhje me ndonjë shtojcë specifike rajonale ose kufitare, Pjesëmarrësit e Regjistruar nuk do të kenë të drejtë për kompensim tjetër përveç kompensimit të përshkruar në këto Rregulla të Alokimit.
7. Pjesëmarrësi i Regjistruar është përgjegjës për sa i përket sanksioneve, gjobave ose ngarkesave që mund të vendosen nga autoritetet financiare në Platformën e Vetme të Alokimit për trajtim të pasaktë tatimor për shkak të informacionit të gabuar ose jo të plotë të dhënë nga Pjesëmarrësi i Regjistruar.
8. Ky nen vazhdon të jetë në fuqi edhe pas ndërprerjes së Marrëveshjes së Pjesëmarrjes të Pjesëmarrësit të Regjistruar.

Neni 70

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Pa cenuar paragrafët 6 dhe 8 të këtij neni, kur ka një mosmarrëveshje, Platforma e Vetme e Alokimit dhe Pjesëmarrësi i Regjistruar së pari do të kërkojnë zgjidhje miqësore përmes konsultimit të ndërsjellë në përputhje me paragrafin 2. Për këtë qëllim, Pala e cila ngre mosmarrëveshjen do t'i dërgojë një njoftim palës tjetër duke treguar:
 - (a) ekzistencën e një Marrëveshjeje Pjesëmarrjeje ndërmjet palëve;
 - (b) arsyen e mosmarrëveshjes; dhe

- (c) një propozim për një takim të ardhshëm, fizik ose jo, me synimin për të zgjidhur mosmarrëveshjen në mënyrë miqësore.
2. Palët do të takohen brenda njëzet (20) ditësh pune pasi çështja u është referuar atyre dhe kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nëse nuk arrihet marrëveshje ose nuk merret asnjë përgjigje brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh pune nga data e njoftimit të lartpërmendur, secila palë mund t'ia referojë çështjen menaxhmentit të lartë të Palëve për të zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me paragrafin 3.
 3. Përfaqësuesi i lartë i secilit prej të dyve, Platformës së Alokimit dhe Pjesëmarrësit të Regjistruar, me autorizim për të zgjidhur mosmarrëveshjen, takohen brenda njëzet (20) ditëve të punës nga kërkesa për takim dhe përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjen. Nëse përfaqësuesit nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen brenda njëzet (20) ditëve të punës nga takimi ose një kohe më të gjatë të dakorduar, atëherë mosmarrëveshja vendoset me arbitrazh në përputhje me paragrafin 4.
 4. Kur një mosmarrëveshje do t'i referohet arbitrazhit sipas paragrafit 3, qoftë Platforma e Vetme e Alokimit ose Pjesëmarrësi i Regjistruar mund t'i japin njoftim tjetrit duke cekur natyrën e mosmarrëveshjes dhe duke ia referuar mosmarrëveshjen arbitrazhit. Arbitrazhi kryhet në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Odës së Tregtisë (ICC). Arbitrazhi zhvillohet përpara një (1) arbitri që do të emërohet me marrëveshjen e Palëve përveç nëse një Palë kërkon emërimin e tre (3) arbitrave. Në rast të një (1) arbitri, Palët bien dakord mbi emërimin e arbitrit brenda dy (2) muajve pas dhënies së njoftimit nga Pala, duke e referuar mosmarrëveshjen në arbitrazh. Nëse nuk mund të gjendet ndonjë marrëveshje, arbitri emërohet nga Gjykata e ICC-së. Në rast të tre (3) arbitrave, paditësi emëron një (1) arbitër dhe i padituri emëron një (1) arbitër. Arbitrat e emëruar nga secila Palë emërojnë kryesuesin e gjykatës së arbitrazhit brenda tre (3) ditëve të punës nga konfirmimi i emërimit të arbitrit të dytë nga i padituri. Nëse arbitrat e emëruar nga secila palë nuk mund të bien dakord për emërimin e kryesuesit, kryesuesi emërohet nga Gjykata e ICC-së. Arbitrazhi zhvillohet në lokacionin e Platformës së Alokimit përveç nëse përcaktohet ndryshe në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes dhe në përputhje me ligjin rregullues të këtyre Rregullave të Alokimit ndërsa gjuha e procedurave të arbitrazhit është gjuha angleze. Dispozitat e arbitrit emergjent sipas Rregullave të Arbitrazhit të Odës së Tregtisë nuk zbatohen, por zbatohen masat e përkohshme ose të detyrueshme të ndihmës sipas ligjit rregullues.
 5. Vendimet e arbitrazhit janë përfundimtare dhe detyruese në Platformën e Vetme të Alokimit dhe Pjesëmarrësin përkatës të Regjistruar që nga data e marrjes së tyre. Platforma e Vetme e Alokimit dhe Pjesëmarrësi i Regjistruar kryejnë çdo vendim të një arbitrazhi në lidhje me çdo mosmarrëveshje pa vonesë dhe secili heq dorë nga e drejta e tij për çdo formë ankese ose rekursi në një gjykatë ose një autoriteti tjetër gjyqësor, për aq sa heqja dorë e tillë mund të bëhet në mënyrë të vlefshme.
 6. Pavarësisht nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, Palët mund të bien dakord bashkërisht të zbatojnë procedurat gjyqësore në vend të arbitrazhit për të zgjidhur një mosmarrëveshje të lindur në lidhje me këto Rregulla të Alokimit.
 7. Në rastet e pagesës së vonuar dhe pavarësisht nga neni 67 dhe paragrafët 1 deri 4 të këtij neni, një palë mund të fillojë procedime gjyqësore kundër palës tjetër për çdo shumë të detyruar sipas këtyre Rregullave të Alokimit ose në lidhje me to dhe të papaguar për më shumë se njëzet (20) ditë të punës pas datës kur shumat ishin të pagueshme.
 8. Palët bien dakord që procedurat e përmendura në paragrafët 6 ose 7 të këtij neni mund të ngriten në çdo gjykatë kompetente për të dëgjuar një pretendim të tillë. Pjesëmarrësi i Regjistruar heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose më pas në lidhje me vendin e zhvillimit të procedurave të tilla në ndonjë gjykatë kompetente dhe çdo pretendim se ndonjë procedurë e tillë është ngritur në një forum të papërshtatshëm.
 9. Pavarësisht nga çdo referencë ndaj zgjidhjes miqësore, zgjidhje eksperti ose arbitrazhi sipas këtij neni, Platforma e Vetme e Alokimit dhe Pjesëmarrësi i Regjistruar vazhdojnë të kryejnë

detyrimet e tyre përkatëse sipas këtyre Rregullave të Alokimit dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes së Pjesëmarrësit të Regjistruar.

10. Ky nen mbetet në fuqi edhe pas ndërprerjes së Marrëveshjes së Pjesëmarrjes të Pjesëmarrësit të Regjistruar.

Neni 71

Pezullimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes

1. Platforma e vetme e alokimit mund të pezullojë përkohësisht me njoftim për pjesëmarrësin e regjistruar të drejtat e pjesëmarrësit të regjistruar në lidhje me këto Rregulla të Alokimit me efekt të menjëhershëm nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar kryen një shkelje të rëndë të një detyrimi në lidhje me këto Rregulla të Alokimit të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në Platformën e Vetme të Alokimit si më poshtë:
 - (a) nëse një Pjesëmarrës i Regjistruar dështon të paguajë ndonjë shumë të papaguar dhe borxh ndaj Platformës së Vetme të Alokimit në përputhje me nenin 67;
 - (b) nëse një Pjesëmarrës i Regjistruar dështon të sigurojë dhe të mbajë kolaterale në përputhje me nenin 25;
 - (c) çdo shkelje që mund të ketë një ndikim të rëndësishëm financiar në Platformën e Vetme të Alokimit;
 - (d) Platforma e Vetme e Alokimit ka bazë të arsyeshme për të besuar se Pjesëmarrësi i Regjistruar nuk plotëson më një ose më shumë nga kushtet e tjera për të marrë pjesë në Ankande në përputhje me këto Rregulla të Alokimit përveç nëse ndërprerja zbatohet në përputhje me nenin 72.
 - (e) nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar është nën sanksione ekonomike dhe tregtare, të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në Platformën e Vetme të Alokimit.
2. Në çfarëdo rasti të një shkeljeje të vogël në lidhje me këto Rregulla të Alokimit si, por pa u kufizuar në dështimin e Pjesëmarrësit të Regjistruar për të njoftuar një ndryshim në informacionin e paraqitur në përputhje me nenin 9, Platforma e Vetme e Alokimit mund të informojë pjesëmarrësin e regjistruar me njoftim për Pjesëmarrësin e Regjistruar se të drejtat e tij në lidhje me këto Rregulla të Alokimit mund të pezullohen përveç rastit kur Pjesëmarrësi i Regjistruar korrigjon ngjarjen e pezullimit në periudhën kohore të specifikuar në njoftim. Pezullimi hyn në fuqi kur periudha e përcaktuar për korrigjim ka skaduar pa u realizuar korrigjimi i tillë.
3. Pas hyrjes në fuqi të pezullimit në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Pjesëmarrësi i Regjistruar i pezulluar nuk mund të marrë më pjesë në një Ankand ose në transferimin ose kthimin e të Drejtave Afatgjate të Transmisionit dhe përveç nëse pagesa e të Drejtës Afatgjatë të Transmisionit shlyhet plotësisht ose sigurohet plotësisht nga kolateralet nga Pjesëmarrësi i Regjistruar i pezulluar, Pjesëmarrësi i Regjistruar i pezulluar nuk do të ketë të drejtë të përdorë të Drejtat e Transmisionit Afatgjatë sipas Titullit 7. Për shmangien e dyshimit, të Drejtat e Transmisionit Afatgjatë, të cilat Pjesëmarrësit të Regjistruar i ndalohen t'i përdor si rezultat i një pezullimi të tillë, mund të ofrohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në ankandet e mëvonshme dhe Platforma e Vetme e Alokimit nuk do t'i kompensojë ato të drejta afatgjate të transmisionit në përputhje me nenin 48.
4. Platforma e Vetme e Alokimit mund të tërheqë njoftimin sipas paragrafëve 1 ose 2 të këtij neni në çdo kohë. Pasi ka dhënë njoftim sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, Platforma e Vetme e Alokimit mund të japë një njoftim të mëtejshëm ose tjetër në çdo kohë në lidhje me të njëjtën ose një ngjarje tjetër pezullimi.
5. Pasi Pjesëmarrësi i Regjistruar të ketë përmbushur ose korrigjuar ngjarjen e pezullimit siç i

Rregullat e harmonizuara të alokimit të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

është njoftuar në njoftimin e dërguar nga Platforma e Vetme e Alokimit, Platforma e Vetme e Alokimit do të rivendosë sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur të drejtat e Pjesëmarrësit të Regjistruar në lidhje me përdorimin e të Drejtave të tij Afatgjata të Transmisionit të alokuara dhe aftësinë e tij për të marrë pjesë në Ankande dhe/ose Transferimin dhe Kthimin e të Drejtave Afatgjata të Transmisionit me njoftim me shkrim Pjesëmarrësit të Regjistruar. Që nga data e hyrjes në fuqi të rivendosjes, të Drejtat Afatgjata të Transmisionit të alokuara para pezullimit dhe të cilat mbeten të papërdorura mund të nominohen në rastin e të Drejtave Fizike të Transmisionit dhe Pjesëmarrësi i Regjistruar mund të marrë pjesë në Ankande dhe/ose transferimin dhe kthimin e të Drejtave Afatgjata të Transmisionit dhe ka të drejtë të marrë kompensim për të Drejtat Afatgjata të Transmisionit në përputhje me nenin 48.

Nëse Platforma e Vetme e Alokimit i jep një njoftim një pjesëmarrësi të regjistruar sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, njoftimi i tillë i pezullimit nuk e liron Pjesëmarrësin e Regjistruar nga detyrimet e tij të pagesës sipas Titullit 10, duke përfshirë detyrimet e tij të pagesës në lidhje me të Drejtat Afatgjata të Transmisionit për të cilat pjesëmarrësi i regjistruar humb të drejtën e përdorimit sipas paragrafit 2. Për shmangien e dyshimit dhe vetëm në rast të pezullimit në përputhje me nenin 71 paragrafi 1 (e), Pjesëmarrësi i Regjistruar ka të drejtë të marrë të gjithë ose një pjesë të shumës së paguar të produktit origjinal. Platforma e Vetme e Alokimit do të kryejë kthimin e shumës së paguar për produktin origjinal pas miratimit të transferit nga partneri bankar i Platformës së Vetme të Alokimit.

Neni 72

Ndërprerja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes

1. Një Pjesëmarrës i Regjistruar në çdo kohë mund të kërkojë nga Platforma e Vetme e Alokimit të ndërpres Marrëveshjen e Pjesëmarrjes palë e së cilës është Pjesëmarrësi i Regjistruar. Ndërprerja do të hyjë në fuqi pas tridhjetë (30) Ditësh pune pas marrjes së kërkesës për ndërprerje nga Platforma e Vetme e Alokimit dhe nëse të gjitha detyrimet e papaguara të pagesës janë shlyer.
2. Një Pjesëmarrës i Regjistruar mund të ndërpresë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në të cilën Pjesëmarrësi i Regjistruar është palë për arsye të mira kur Platforma e Vetme e Alokimit ka kryer një shkelje të madhe të një detyrimi që lidhet me këto Rregulla të Alokimit ose Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në rastet e mëposhtme:
 - (a) kur Platforma e Vetme e Alokimit dështon në mënyrë të përsëritur t'i paguajë ndonjë shumë të detyruar dhe borxh Pjesëmarrësit të Regjistruar me një ndikim të konsiderueshëm financiar;
 - (b) kur ka një shkelje të konsiderueshme të detyrimeve të konfidencialitetit në përputhje me nenin 75.
3. Pjesëmarrësi i regjistruar i dërgon një njoftim Platformës së Vetme të Alokimit duke treguar arsyen e ndërprerjes dhe duke i dhënë Platformës së Vetme të Alokimit njëzet (20) Ditë pune për të korrigjuar shkeljen. Përveç rasteve kur Platforma e Vetme e Alokimit korrigjon shkeljen brenda afatit të lartpërmendur, ndërprerja do të hyjë në fuqi menjëherë pas skadimit të këtij afati. Një mbajtës i të Drejtave Afatgjata të Transmisionit, Marrëveshja e Pjesëmarrjes e të cilit ndërpritet sipas këtij paragrafi nuk ka asnjë detyrim për të paguar këstet e mbetura për të Drejtat Afatgjata të transmisionit dhe ka të drejtë për një rimbursim në masën që çdo këst përfshin një shumë në lidhje me përdorimin pas datës së ndërprerjes, që do të llogaritet proporcionalisht nga data kur ndërprerja hyn në fuqi.
4. Nëse ndonjë nga ngjarjet e ndërprerjes në paragrafin 4 ndodh në lidhje me një Pjesëmarrës të Regjistruar, Platforma e Vetme e Alokimit mundet nëpërmjet njoftimit të Pjesëmarrësit të Regjistruar të ndërprejë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes, përfshirë të drejtat e Pjesëmarrësit të Regjistruar që lidhen me këto Rregulla të Alokimit. Një ndërprerje sipas këtij paragrafi hyn në fuqi nga koha e njoftimit ose ndonjë kohë tjetër e specifikuar në të. Pjesëmarrësi i Regjistruar nuk mund të hyjë në një fazë të mëvonshme në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes me Platformën e

Rregullat e harmonizuara të alokimit të Drejtave Afatgjate të Transmisionit

Vetme të Alokimit derisa rrethanat e ndërprerjes vazhdojnë të ekzistojnë ose nuk është garantuar mjaftueshëm që shkelja nuk mund të ndodhë prapë.

5. Ngjarjet e ndërprerjes të referuara në paragrafin 3 do të jenë si më poshtë:
 - (a) nëse të drejtat e Pjesëmarrësit të Regjistruar janë pezulluar për më shumë se tridhjetë (30) Ditë pune;
 - (b) nëse një Pjesëmarrës i Regjistruar nuk kualifikohet për pjesëmarrje në Ankand siç parashikohet në nenin 10;
 - (c) nëse një Pjesëmarrës i Regjistruar i shkel në mënyrë të përsëritur këto Rregulla të Alokimit ose një Marrëveshje Pjesëmarrjeje, pavarësisht nëse shkelja mund të korrigojë apo jo;
 - (d) nëse një autoritet kompetent (i) konstaton se Pjesëmarrësi i Regjistruar ka kryer një keqpërdorim ose veprim mashtrues dhe (ii) kërkon nga Platforma e Vetme e Alokimit të ndërpresë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në të cilën ky Pjesëmarrës i Regjistruar është palë ose (iii) pajtohet që Platforma e Vetme e Alokimit ka bazë të arsyeshme për të besuar se Pjesëmarrësi i Regjistruar ka kryer një keqpërdorim ose veprim mashtrues në pjesëmarrjen në Ankande dhe transferimin/kthimin e të Drejtave Afatgjata të Transmisionit; ose
 - (e) nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar ka ndërmarrë ndonjë veprim që mund të çojë në dëmtimin ose uljen e efektivitetit të Mjetit të Ankandit (duke nënkuptuar që një veprim i tillë konsiderohet të ketë ndodhur në rast të ndonjë sjellje që mund të shndërrohet në një sulm ndaj sistemit të informacionit siç janë, por pa u kufizuar në, mohimi i shërbimit, spam, virus, forca brutale, sulmi i kalit të Trojës).
6. Pasi ndërprerja të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafët 1 deri në 3 të këtij neni dhe nga ajo kohë, Pjesëmarrësi i Regjistruar nuk mund të marrë më pjesë në një Ankand ose në transferimin ose kthimin e të Drejtave Afatgjata të Transmisionit që ka fituar. Titujt 5, 6 dhe 7 nuk do të zbatohen për të drejtat e fituara afatgjata të transmisionit. Për shmangien e dyshimit, të Drejtat Afatgjata të Transmisionit, të cilat Pjesëmarrësit të Regjistruar i ndalohen t'i përdorë si rezultat i ndërprerjes, mund të ofrohet nga Platforma e Vetme e Alokimit në Ankandet e mëvonshme dhe Platforma e Vetme e Alokimit nuk do t'i kompensojë ato të Drejta Afatgjata të Transmisionit në përputhje me nenin 48.
7. Ndërprerja e një Marrëveshjeje të Pjesëmarrjes nuk prek asnjë të drejtë dhe detyrim sipas Marrëveshjes së Pjesëmarrjes dhe këtyre Rregullave të Alokimit dhe në lidhje me to, që kanë lindur para kësaj ndërprerjeje, përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë nen. Prandaj, çdo Pjesëmarrës i Regjistruar, Marrëveshja e Pjesëmarrjes e të cilit është ndërprerë, do të mbetet përgjegjës, në varësi dhe në përputhje me Rregullat e Alokimit, në lidhje me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tilla. Ky paragraf zbatohet pa paragjykuar mjetet tjera juridike në dispozicion të Platformës së Alokimit sipas këtyre Rregullave të Alokimit.

Neni 73

Forca Madhore

1. Platforma e vetme e alokimit ose një pjesëmarrës i regjistruar, i cili thirret në forcën madhore, menjëherë do t'i dërgojë palës tjetër një njoftim që përshkruan natyrën e forces madhore dhe kohëzgjatjen e mundshme të saj dhe do të vazhdojë të japë raporte në lidhje me të me frekuencë të arsyeshme gjatë periudhës së forcës madhore. Pala që thirret në forcën madhore do të bëjë çdo përpjekje të mundshme për të kufizuar pasojat e forcës madhore.
2. Detyrimet, detyrat dhe të drejtat e prekura të një Pale, që i nënshtrohen forcës madhore, pezullohen që nga fillimi i forcës madhore, me përjashtim të dispozitave të konfidencialitetit në përputhje me nenin 75.

3. Pezullimi sipas paragrafit 2 i nënshtrohet sa vijon:
 - (a) Pezullimi nuk do të ketë një fushëveprim më të madh dhe nuk ka kohëzgjatje më të madhe se sa kërkohet nga forca madhore;
 - (b) Pezullimi zbatohet vetëm për sa kohë që pala që thirret në forcën madhore është duke përdorur përpjekje të arsyeshme për të korrigjuar paaftësinë e tyre për të performuar.
4. Pasojat e një ngjarjeje të forcës madhore, e cila nuk është objekt i ndonjë diskutimi ose procesi gjyqësor ndërmjet platformës së vetme të alokimit dhe pjesëmarrësit të regjistruar, janë:
 - (a) Pala që thirret në forcën madhore nuk mund të konsiderohet përgjegjëse për të paguar kompensimin e çdo dëmi të pësuar, për shkak të mosperformancës ose performancës së pjesshme të të gjitha ose ndonjë detyrimi të saj gjatë forcës madhore dhe kur kjo mosperformancë ose performancë e pjesshme është drejtpërdrejtë si pasojë e forcës madhore;
 - (b) Të drejtat afatgjate të transmisionit të fituara të cilat janë paguar plotësisht dhe bëhen objekt i forcës madhore rimbursohen për kohëzgjatjen e forcës madhore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këto rregulla të alokimit; dhe
 - (c) Nëse mbajtësi i të drejtave afatgjate të transmisionit është pala që pretendon ngjarjen e forcës madhore, platforma e alokimit mundet, për përfitimin e vet, të rialokojë të drejtat afatgjate të transmisionit të mbajtësit në ankandet e mëvonshme dhe për kohëzgjatjen e ngjarjes së forcës madhore.
5. Nëse forca madhore vazhdon për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj, platforma e vetme e alokimit ose secili pjesëmarrës i regjistruar mundet, nëpërmjet njoftimit të palës tjetër në çdo kohë gjersa forca madhore vazhdon përtej asaj periudhe, të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen e pjesëmarrjes. Ndërprerja do të hyjë në fuqi dhjetë (10) ditë pune pas njoftimit ose në ndonjë datë të mëvonshme të specifikuar në njoftim. Mbajtësi i të drejtave afatgjate të transmisionit, të cilit i është ndërprerë marrëveshja e pjesëmarrjes sipas këtij paragrafi nuk ka asnjë detyrim të paguajë pjesën e mbetur të kësteve për të drejtat afatgjate të transmisionit dhe ka të drejtën e një rimbursimi në masën që çdo këst përfshin një shumë në lidhje me përdorimin pas datës së ndërprerjes, që do të llogaritet proporcionalisht nga hyrja në fuqi e datës së ndërprerjes.
6. Për shmangien e dyshimit ky nen nuk cenon dispozitat e Titullit 9 në lidhje me shkurtimin e të drejtave afatgjate të transmisionit.

Neni 74 **Njoftimet**

1. Çdo njoftim ose komunikim tjetër që do të jepet nën ose në lidhje me këto rregulla alokimi do të jetë në anglisht.
2. Përveç nëse shprehimisht parashikohet ndryshe në këto rregulla të alokimit, të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera bëhen me shkrim dhe dërgohen me anë të mjeteve elektronike siç përcaktohet në faqen e internetit të platformës së vetme të alokimit dhe shënjuar për vëmendjen e përfaqësuesit të palës tjetër siç është përcaktuar në marrëveshjen e pjesëmarrjes ose siç njoftohet nga pjesëmarrësi i regjistruar herë pas here në përputhje me 0.
3. Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera jepen nëpërmjet letrës së dorëzuar me dorë kundrejt fletëpranimit ose të dërguara me postë rekomande ose korrier në rastet e mëposhtme:
 - (a) Lidhja e marrëveshjes së pjesëmarrjes në përputhje me nenin 6;

- (b) Pezullimi dhe ndërprerja sipas nenit 71 dhe neni 72; dhe
 - (c) Dorëzimi i garancisë bankare, në rast se Garancia Bankare përfshin nënshkrime të shkruara me dorë, në përputhje me nenin 21 paragrafi 3.
4. Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera konsiderohen se janë pranuar:
- (a) Në rastin e dorëzimit me dorë, kur dorëzohet kundrejt fletëpranimit; ose
 - (b) në rastin e postës së parapaguar të dorëzimit të regjistruar, në ditën që pason ditën e regjistruar të dorëzimit; ose
 - (c) në rastin e dërgimit me mjete elektronike siç specifikohet nga platforma e vetme e alokimit në faqen e saj të internetit, kur i dorëzohet palës tjetër, por vetëm nëse kërkohet dhe merret një konfirmim i marrjes nga pala që dërgon mjetet elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit.
5. Nëse një njoftim ose komunikim tjetër është pranuar jashtë orarit normal të punës në ditën e punës, konsiderohet se është pranuar në hapjen e biznesit në ditën e ardhshme të punës.

Neni 75

Konfidencialiteti

1. Marrëveshja e pjesëmarrjes dhe çdo informacion tjetër i shkëmbyer në lidhje me përgatitjen e saj dhe aplikimi nga një pjesëmarrës në treg do të konsiderohen konfidenciale.
2. Në varësi të paragrafit 3 të këtij neni, Platforma e Vetme e Alokimit dhe secili Pjesëmarrës i Regjistruar, i cili është marrës i informacionit konfidencial në lidhje me këto Rregulla të Alokimit ruan konfidencialitetin e këtij informacioni dhe nuk e zbulon, raporton, publikon, shpalosë, transferon ose përdorë direkt ose indirekt, ndonjë pjesë të informacionit konfidencial ndryshe nga qëllimi për të cilin është shpalosur.
3. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, platforma e vetme e alokimit ose një pjesëmarrës i regjistruar mund të zbulojë informacionin konfidencial të një pale të shpalosur tek një palë e tretë me pëlqimin paraprak të palës tjetër të shprehur me shkrim dhe me kusht që pala marrëse ka dhënë siguri se kjo palë e tretë është e detyruar nga detyrimet ekuivalente të konfidencialitetit siç përcaktohen në këto rregulla të alokimit direkt të zbatueshëm nga pala tjetër.
4. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, platforma e vetme e alokimit ose pjesëmarrësi i regjistruar mund të zbulojë informacionin konfidencial të një pale zbuluese:
 - (a) Në masën e lejuar ose të parashikuar shprehimisht nga rregullat e alokimit;
 - (b) Për çdo person i cili është një nga drejtorët, zyrtarët, punonjësit, agjentët, këshilltarët ose siguruesit e marrësit dhe i cili duhet të dijë informacionin konfidencial në lidhje me këto rregulla alokimi;

- (c) Aq sa kërkohet për të qenë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm kombëtar ose të BE-së, si Rregullorja (BE) Nr. 1227/2011 dhe Rregullorja (BE) Nr. 543/2013 ose ndonjë akt tjetër administrativ të brendshëm përkatës, siç janë kodet e rjetit;
 - (d) Aq sa kërkohet nga një gjykatë, arbitër ose gjykatë administrative ose një ekspert në rrjedhën e procedurave përpara tyre, në të cilën marrësi është palë;
 - (e) Siç mund të kërkohet nga OST-të përkatëse përmbushjen e duhur të misionit të tyre dhe detyrimeve të tyre në përputhje me ligjet në fuqi dhe këto Rregulla të Alokimit nga vetë ata ose përmes agjentëve ose këshilltarëve; ose
 - (f) për aq sa kërkohet për të marrë leje ose pëlqime nga një autoritet kompetent.
5. Gjithashtu, detyrimet që rrjedhin nga ky nen nuk do të zbatohen:
- (a) nëse Pala që merr informacionin mund të dëshmojë se në kohën e shpalosjes, informacioni i tillë ishte tashmë i disponueshëm publikisht;
 - (b) nëse Pala marrëse siguron prova që, që nga koha e shpalosjes, informacioni në fjalë është marrë në mënyrë ligjore nga një palë e tretë ose është bërë i disponueshëm për publikun;
 - (c) për informacionin konfidencial të komunikuar, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullatore, në një formë të inkorporuar nga e cila nuk mund të nxirret asnjë pjesë informacioni specifik për një pjesëmarrës në treg;
 - (d) për informacionin, publikimi i të cilit parashikohet shprehimisht nga këto Rregulla të Alokimit.
6. Detyrimet e konfidencialitetit në këtë nen mbeten të vlefshme për një periudhë prej pesë (5) vjetësh pas ndërprerjes së Marrëveshjes së Pjesëmarrjes të Pjesëmarrësit të Regjistruar.
7. Nënshkrimi i një Marrëveshjeje të Pjesëmarrjes dhe shkëmbimi i informacionit konfidencial nuk japin asnjë të drejtë për patentat, njohuritë ose ndonjë formë tjetër të pronës intelektuale në lidhje me informacionin ose mjetet e vëna në dispozicion ose të dërguara nga një Palë tek tjetra sipas kushteve të këtyre Rregullave të Alokimit.

Neni 76

Caktimi dhe nënkontraktimi

1. Platforma e vetme e alokimit mund të caktojë, rinovoje ose ndryshe të transferojë ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e saj sipas një marrëveshjeje të pjesëmarrjes ose këtyre rregullave të alokimit në një platformë tjetër të vetme alokimi. Platforma e vetme e alokimit do të njoftojë pjesëmarrësit e regjistruar për ndryshimin me anë të mjeteve elektronike siç përcaktohet në faqen e internetit të platformës së vetme të alokimit me me konfirmimin e pranimit sa më shpejt që është e mundur dhe në çdo rast të paktën dhjetë (10) ditë pune para datës në të cilën ndryshimi hyn në fuqi.
2. Pa cenuar nenin 41, një pjesëmarrës i regjistruar mund të mos caktojë, rinovojë ose ndryshe të transferojë ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e tij sipas marrëveshjes së pjesëmarrjes ose këtyre rregullave të alokimit pa pëlqimin paraprak me shkrim të platformës së alokimit.
3. Asgjë në këtë nen nuk do të parandalojë platformën e vetme të alokimit ose pjesëmarrësin e regjistruar për të hyrë në një marrëveshje nënkontraktimi në lidhje me këtë rregullore të alokimit. Hyrja në një marrëveshje nënkontraktimi nga një pjesëmarrës i regjistruar nuk e liron pjesëmarrësin e regjistruar nga asnjë detyrim ose përgjegjesi sipas marrëveshjes së

Rregullat e harmonizuara të alokimit të Drejtave Afatgjate të Transmisionit
pjesëmarrjes ose këtyre rregullave të alokimit. Hyrja në një marrëveshje nënkontraktimi nga platforma e vetme e alokimit nuk e liron platformën e vetme të alokimit nga detyrimi ose përgjegjësia sipas këtyre rregullave të alokimit.

Neni 77

Ligji rregullues

Këto rregulla të alokimit rregullohen dhe interpretohen në të gjitha aspektet në përputhje me ligjin e vendndodhjes së zyrës së regjistruar të platformës së vetme të alokimit përveç nëse përcaktohet ndryshe në marrëveshjen e pjesëmarrjes.

Neni 78

Gjuha

Gjuha referuese për këto rregulla alokimi është anglishtja. Për shmangien e dyshimit, aty ku OST-të duhet të përkthejnë këto rregulla të alokimit në gjuhën(t) e tyre kombëtare, në rast të mospërputhjeve midis versionit në gjuhën angleze të publikuar nga OST-të në pajtim me nenin 4(13) të Rregullores së FCA dhe çdo versioni në një gjuhë tjetër, OST-të përkatëse në pajtim me legjislacionin kombëtar sigurojnë një përkthim të përditësuar të HAR për autoritetet rregullatore kombëtare.

Neni 79

Prona intelektuale

Asnjë palë nuk do të fitojë asnjë të drejtë, titull, licencë ose interes në ose për ndonjë të drejtë të pronës intelektuale të palës tjetër në lidhje me këto rregulla të alokimit.

Neni 80

Marrëdhënia e Palëve

1. Marrëdhënia e platformës së vetme të alokimit dhe Pjesëmarrësit të Regjistruar është ajo e ofruesit të shërbimit përkatësisht e përdoruesit të shërbimit. Përveç siç parashikohet shprehimisht në këto Rregulla të Alokimit, asgjë që përfshihet ose nënkuptohet në këto Rregulla të Alokimit nuk përbën ose konsiderohet se përbën Platformën e Vetme të Alokimit ose një Pjesëmarrës të Regjistruar, partnerin, agjentin ose përfaqësuesin ligjor të tjetrit për çfarëdo qëllimi çfarëdo qoftë ai duke përfshirë transferimin e të Drejtave Afatgjata të Transmetimit ose krijon ose të konsiderohet se krijon ndonjë partneritet, agjenci ose besim midis Palëve.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar pranon që as Platforma e Vetme e Alokimit, as ndonjë person që vepron në emër ose të lidhur me Platformën e Vetme të Alokimit nuk bën asnjë përfaqësim, jep ndonjë këshillë ose jep ndonjë garanci ose marrje përsipër të çfarëdo lloji në lidhje me këto Rregulla të Alokimit, Marrëveshjet e Pjesëmarrjes ose informacionin e shpalosur ose ndryshe në raport me ose në lidhje me këto Rregulla të Alokimit, Marrëveshjet e Pjesëmarrjes dhe informacionin e shpalosur ose ndonjë transaksion ose rregullim të parashikuar nga këto Rregulla të Alokimit, Marrëveshjet e Pjesëmarrjes dhe Informacioni i shpalosur, përveç siç parashikohet në mënyrë specifike në këto Rregulla të Alokimit ose Marrëveshjen e Pjesëmarrjes.

Neni 81

Asnjë e drejtë e palës së tretë

Platforma e vetme e alokimit dhe secili pjesëmarrës i regjistruar pranojnë dhe bien dakord që një person i cili nuk është palë në marrëveshjen e pjesëmarrjes midis tyre, duke përfshirë çdo pjesëmarrës tjetër tregu, nuk ka të drejta për të zbatuar këto rregulla të alokimit ose marrëveshjen e pjesëmarrjes ndërmjet platformës së alokimit dhe pjesëmarrësit të regjistruar.

Neni 82

Heqja dorë

1. Asnjë dështim për të ushtruar ose vonesë në ushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti juridik të parashikuar me ligj ose në bazë të këtyre Rregullave të Alokimit nuk dëmton ose përbën heqje dorë nga një e drejtë e tillë ose e drejtë, kompetencë ose mjet juridik tjetër. Asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti juridik të tillë nuk përjashton ose dëmton ndonjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të saj ose ushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti juridik tjetër të parashikuar me ligj ose sipas këtyre Rregullave të Alokimit.
2. Çdo heqje dorë nga ndonjë e drejtë, kompetencë ose mjet juridik sipas këtyre Rregullave të Alokimit duhet të jetë me shkrim dhe mund të jepet në varësi të kushteve që mendohet se janë të përshtatshme nga dhënësi. Përveç nëse theksohet ndryshe shprehimisht, çdo heqje dorë është efektive vetëm në rastin dhe vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë.

Neni 83

Marrëveshje e plotë

Këto Rregulla të Alokimit dhe Marrëveshja e Pjesëmarrjes përmbajnë ose i referohen shprehimisht të tërë marrëveshjes midis Platformës së Vetme të Alokimit dhe secilit Pjesëmarrës të Regjistruar në lidhje me lëndën e saj dhe përjashtojnë shprehimisht çdo garanci, kusht ose marrje përsipër tjetër të nënkuptuar në ligj ose sipas zakonit dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe mirëkuptimet e mëhershme ndërmjet Platformës së Vetme të Alokimit dhe secilit Pjesëmarrës të Regjistruar në lidhje me to. Platforma e Vetme e Alokimit dhe secili Pjesëmarrës i Regjistruar pranojnë dhe konfirmojnë se asnjëri prej tyre nuk miratojnë këto Rregulla të Alokimit ose Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në mbështetje të ndonjë përfaqësimi, garancie ose marrjeje përsipër tjetër (përveç rasteve kur bëhet me mashtim) që nuk pasqyrohet plotësisht në kushtet e këtyre Rregullave të Alokimit ose Marrëveshjen e Pjesëmarrjes.

Neni 84

Mjetet ekskluzive juridike

Të drejtat dhe mjetet juridike të parashikuara nga këto Rregulla të Alokimit dhe Marrëveshja e Pjesëmarrjes për Platformën e Vetme të Alokimit dhe secilin Pjesëmarrës të Regjistruar janë ekskluzive dhe jo kumulative dhe, për aq sa lejohet me ligj, përjashtojnë dhe zëvendësojnë të gjitha të drejtat substantive (por jo procedurale) ose mjetet juridike të shprehura ose të nënkuptuara dhe të parashikuara me ligj ose statut në lidhje me lëndën e këtyre Rregullave të Alokimit dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes. Prandaj, Platforma e Vetme e Alokimit dhe secili Pjesëmarrës i Regjistruar heq dorë në masën më të plotë të mundshme nga të gjitha të drejtat dhe mjetet juridike të tilla të parashikuara me ligj ose statut dhe liron njëri-tjetrin prej tyre nëse i detyrohet ndonjëri prej tyre, zyrtarëve, punonjësve dhe agentëve të vet në të njëjtën masë nga të gjitha detyrat, detyrimet, përgjegjësitë ose obligimet e parashikuara me ligj ose statut në lidhje me çështjet e trajtuara në këto Rregulla të Alokimit dhe Marrëveshjen e Pjesëmarrjes dhe merr përsipër të mos zbatojë ndonjë nga të njëjtat përveç siç parashikohet shprehimisht

Neni 85

Vlefshmëria e pjeshme

Nëse ndonjë dispozitë e këtyre Rregullave të Alokimit ose një Marrëveshjeje të Pjesëmarrjes deklarohet e pavlefshme, e pazbatueshme ose e paligjshme nga gjykatat e cilitdo juridiksion të cilit i nënshtrohet ose në bazë të arbitrazhit ose me urdhër të ndonjë autoriteti kompetent, pavlefshmëria e tillë, pazbatueshmëria ose paligjshmëria nuk cenon ose ndikon në dispozitat e mbetura të këtyre Rregullave të Alokimit dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, të cilat vazhdojnë me fuqi dhe efekt të plotë, pavarësisht nga pavlefshmëria, pazbatueshmëria ose paligjshmëria e tillë. Çdo pjesë ose dispozitë(a) jovalide, e paligjshme, e pavlefshme dhe/ose e pazbatueshme zëvendësohet me pjesë ose dispozita të vlefshme, të ligjshme dhe/ose të zbatueshme në mënyrë që të arrihet efekti i synuar ekonomik dhe ligjor.